

MANUAL POLITIKASH

MBROJTJA E LIRISË SË MEDIAS NË EPOKËN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE DHE KOMPANIVE TË MËDHA TË PLATFORMAVE TË TEKNOLOGJISË

Botimi u krye si pjesë e projektit “Hapësira të shëndetshme informimi në rrjet - SAIFE Renewed”, në bashkëpunim me Forumin për Informacion dhe Demokraci.

Pikëpamjet, gjetjet, interpretimet, rekomandimet dhe përfundimet e paraqitura këtu janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë doemos qëndrimin zyrtar të OSBE-së dhe/ose shteteve pjesëmarrëse.

Përkthimi i këtij Doracakut në gjuhën shqipe u mbështet nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

© 2025, Zyra e Përfaqësuesit për Lirinë e Medias
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

6a Wallnerstrasse
1010 Vjenë, Austri
Telefon 43-1-514-36-68-00
Posta elektronike: pm-fom@osce.org
<https://www.osce.org/fom/ai-free-speech>

ISBN: 978-92-9234-734-5

E drejta e autorit: Creative Commons Attribution-Non Commercial-Share Alike 4.0
International (CC BY-NC-SA 4.0)
Tetor 2025



**TOWARDS HEALTHY
ONLINE INFORMATION
SPACES**

FID | FORUM
INFORMATION
DEMOCRACY

Autorët (në rend alfabetik)

Anya Schiffrin, Bojana Kostić, Iva Nenadić, Julia Haas, Natali Helberger dhe Max van Drunen.

Ky Manual Politikash u hartua në bashkëpunim me Bojana Kostić, në cilësinë e raportueses për vigjilencë/siguri mediatike, Iva Nenadić, në cilësinë e raportueses për stabilitetin financiar të mediave, dhe Max van Drunen si raportues për dallimin mediatik. Anya Schiffrin dhe Natali Helberger shërbyen si kryesuese të Nismës për mediat dhe platformat e mëdha të teknologjisë.

Redaktorë

Julia Haas dhe Katharina Zügel

Këshilli drejtues (sipas rendit alfabetik)

Amy Brouillette, Begaim Usenova, Damian Tambini, Hanna Möllers, Helle Sjøvaag, Mira Milosevic

Partner zbatues: Forumi për Informacion dhe Demokraci

Katharina Zügel dhe Camille Grenier

Asistent projekti nga OSBE-ja

Claire Haering

Ekspertët (në rend alfabetik)

Ali-Abbas Ali, Jeff Allen, Aizirek Almazbekova, Tetiana Avdieieva, Laura Becana Ball, Natalia Belikova, Rodney Benson, Blerjana Bino, Alexandra Borchardt, Tajana Broz, Pavlo Burdiak, Maja Čalović, Maja Cappello, Paolo Cavaliere, Rumman Chowdhury, Clare Cook, Lucina Di Meo, Maria Donde, Shushan Doydoyan, Maksym Dvorovyi, Tamara Filipović, Chloé Fiodiere, Melissa Fleming, Sarah Anne Ganter, Ricki-Lee Gerbrandt, Mariam Gersamia, Arzu Geybulla, Tom Gibson, Jodie Ginsberg, Natalya Gumenyuk, Paulina Gutiérrez, Ricardo Gutiérrez, Chantal Joris, Pierrick Judéaux, Timothy Karr, Alexander Kashumov, David Kaye, Emre Kızılkaya, David Klotsonis, Aleksandra Kuczerawy, Luboš Kukliš, Fedá Kulenović, Felipe Lauritzen, Sally Lehrman, David Levy, Tanja Maksić, Michael Markovitz, Eleonora Mazzoli, Quinn McKew, Joe McNamee, Marko Milosavljević, Laura Moore, Martin Moore, Nasir Muftić, Rasmus Kleis Nielsen, Michael J. Oghia, Diana Okremova, Morten Østervang, Artur Papyan, Pier Luigi Parcu, Jakub Parusinski, Jan Penfrat, Audrius Perkauskas, Gill Phillips, Eliška Pirková, Julie Posetti, Manuel Puppis, Courtney Radsch, Susan Ragheb, Victoire Rio, Krisztina Rozgonyi, Borka Rudić, Ahmet Alphan Sabancı, Benjamin Sabbah, Nina Santos, Ralph Schroeder, Renate Schroeder, Theresa Josephine Seipp, Nina Shengelia, Felix Simon, Anida Sokol, Anna Söder, Ela Stapley, Maria Luisa Stasi, Olaf Steenfadt, Katarzyna Szymielewicz, Ana Toskić, Elira Turdubaeva, Molder Utegenova, Elodie Vialle, Colette Wahlqvist, Mariëlle Wijermars, Sophia Wistehube, Pinar Yildirim, dhe shumë të tjerë.

Redaktor gjuhësor: Rodney Bolt

Skica dhe faqesja: Marianna Vardanyan dhe Peno Mishoyan

Përmbajtja

Parathënie	6
PËRMBLEDHJE	10
1. Përmbledhje Ekzekutive	12
2. Gjetjet dhe Rekomandimet Kryesore	15
2.1 Gjetjet kryesore	15
2.2 Rekomandimet kryesore	21
ANALIZË E THELLUAR	32
3. Hyrje	34
4. Hapësirat e Kapura të Informimit në Rrjet	38
4.1 Përqendrimi i pushtetit në ekosistemin bashkëkohor të informimit në rrjet	38
4.2 Sfidat ndaj lirisë së medias: Rreziqet e përqendrimit të pushtetit	44
4.3 Inteligjenca artificiale prodhuese shkakton çrregullime të mëtejme	55
5. Dallimi i Medias	64
5.1 Nismat për politika dhe rregullore për forcimin e dallimit të medias	64
5.2. Masat zbutëse që synojnë promovimin e dallimin e medias në periudhën afatshkurtër	85

6. Stabiliteti Financiar i Mediave	96
6.1 Nismat e politikave dhe rregullave për t'i detyruar platformat që të paguajnë kompensim për gazetarinë	96
6.2 Masat zbutëse që synojnë mbrojtjen e stabilitetit financiar mediatik në periudhën afatshkurtër	114
7. Vigjilenca (Siguria) e Mediave	122
7.1 Nismat e politikave dhe rregullave për forcimin e vigjilencës së mediave dhe sigurisë së gazetarëve	122
7.2 Masat zbutëse që synojnë rritjen e sigurisë së gazetarëve në periudhën afatshkurtër	136
8. Hapat Vijues: Vizioni për të Ardhmen	146
8.1 Mënyrë e re të menduari	146
8.2 Konsiderata për ndërhyrje nga shteti	151
8.3 Ndryshimet dhe investimet strukturore të nevojshme për të lëvizur përtej ekosistemit aktual të informacionit	158
Shtojcë	164

Parathënie

I nderuar lexues,

Bashkërisht po dëshmojmë ndryshimin rrënjësor në ekosistemin botëror të informacionit, ndërsa një shpurë platformash digjitale dominojnë dhe kompanitë e inteligjencës artificiale formojnë gjithnjë e më shumë mënyrën se si informacioni prodhohet, shpërndahet, qaset dhe vlerësohet. Këto zhvillime sjellin jo vetëm ndikime komplekse teknike e rregulluese, por edhe dilema të mëdha lidhur me rolin demokratik të medias dhe së drejtës për të kërkuar, pranuar dhe shpërndarë informacion.

Kjo nuk ka të bëjë me vetëm me ndryshimet teknologjike, por me lirinë e informimit dhe shprehjes, me qasjen në informacion, mënyrën se si algoritmet e trajtojnë diskursin publik dhe çështjen nëse gazetaria me interes publik do të vazhdojë t'i shërbejë vendimmarrjes demokratike. Mjedisi digjital bashkëkohor i informacionit, i karakterizuar nga transparenca e pamjaftueshme, asimetritë e pushtetit dhe kontrolli mbi informacionin, mbart sfida për lirinë e medias dhe pjesëmarrjen në demokraci. Në rrethana të tilla, rëndësi të veçantë merr përgjegjësia që kanë shtetet për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur zotimet e tyre për lirinë e medias. Kjo përgjegjësi ngërthen jo vetëm shmangien e kontrollit ose ndërhyrjes së pajustificuar shtetërore, por edhe krijimin e kushteve që pluralizmi, pavarësia dhe gazetaria me interes publik të mund të lulëzojnë. Në kontekstin e sotëm, për rivendosjen e ekuilibrit dhe mbrojtjen e integritetit të informacionit nevojiten masa ambicioze bazuar tek të drejtat.

Kur mora detyrën si Përfaqësues i OSBE-së për Lirinë e Medias u zotova të zhvilloj standarde të qarta dhe largpamëse në këtë fushë, të mbështetura në analizë të thelluar dhe angazhim me gamën e gjerë nga palët e interesuara. Pavarësisht vlerës së përpjekjeve të hershme për politika dhe vetërregullim, disa prej tyre kanë rezultuar të pamjaftueshme si pasojë e trysnive të lobimit, rezistencës politike dhe, në raste të caktuara, pasojave të paparashikuara. Analiza rigoroze e këtyre ndërhyrjeve, përfshirë edhe mangësitë, sukseset dhe rëndësinë e tyre në tablonë mediatike që zhvillohet vazhdimisht, shpalosi nevojën për ta ri menduar mënyrën ku duhet mbështetur ekosistemi demokratik i informimit. Shtetet pjesëmarrëse në OSBE më kanë mandatuar që ta mbroj dhe promovoj lirinë e medias. Përmes këtij Manuali Politikash ofrojmë udhëzime

për ndërtimin e një hapësire informimi të lirë nga kontrolli oligopolist, të qëndrueshme ndaj manipulimit dhe fuqizuese për mediat e pavarura dhe pluraliste.

Ky Manual Politikash propozon si reforma strukturore, ashtu edhe masa zbutëse konkrete, me fokus në dallimin, stabilitetin financiar dhe vigjilencën e mediave. Nëse gazetarët nuk mund të raportojnë në mënyrë të sigurt, nëse puna e tyre bëhet e padukshme ose ekonomikisht e paqëndrueshme, atëherë nuk mund të mbrohen as integriteti i diskursit publik, as liria e medias. Prandaj, nevojitet angazhim i kujdesshëm dhe parimor shtetëror për tu garantuar se informacioni, si dhe vetë hapësira e informimit, të mos kapen nga bizneset private, përfshirë këtu platformat dhe gjigantët e inteligjencës artificiale, as edhe nga qeveria e radhës. Ky është parakusht i domosdoshëm për të garantuar se media e përmbush rolin në shërbim të demokracisë.

Duke pasur parasysh larminë e sistemeve juridike dhe të konteksteve shoqërore në rajonin e OSBE-së, ky Manual Politikash nuk synon të imponojë zgjidhje universale, por ofron udhëzime parimore dhe të përshtatshme, sipas standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe zotimeve në OSBE, për t'u shërbyer shteteve pjesëmarrëse në formulimin e kuadrit që mbron pluralizmin e pavarësinë në media dhe interesin publik përballë shtrembërimit, mashtrimit dhe përçarjes. Ky Manual synon të shërbejë njëherazi si instrument praktik dhe nevojë për veprim. Ai u bën thirrje shteteve të shkojnë nga "arnimet" reaguese drejt vizionit për të ardhmen e ekosistemit tonë të informacionit, proaktiv e të bazuar në të drejta, vizion që ringjall pluralizmin dhe llogaridhënien.

Dëshiroj t'ju shpreh mirënjohjen time të sinqertë ekspertëve, raportuesve, kryesuesve, Këshillit Drejtues, partnerit zbatues dhe gjithë atyre që kontribuuan përmes dialogut dhe konsultimeve publike të fokusuar. Falënderim i veçantë i shkon edhe ekipit tim, falë angazhimit dhe bashkëpunimit u bë e mundur botimi i këtij Manuali. Besoj se ky Manual do të shërbejë si busull për të lundruar dallgëzimin e vullshëm teknologjik, qeverisë dhe lirisë së medias. Tani është koha që angazhimin ta shndërrojmë në veprim në mbrojtje të lirisë së medias në këtë epokë transformimesh teknologjike.



Jan Braathu
Përfaqësues i OSBE-së për Lirinë e Medias

Ky Manual Politikash dhe struktura e tij

Ky Manual Politikash është fryt i procesit për mbi një viti hulumtimesh të thelluara, tryezash të shumta diskutimi me ekspertë dhe konsultimesh të gjera. Ai konsolidon ekspertizën dhe përvojën e më se 150 studiuesve dhe profesionistëve të shquar në fushat e lirisë së medias, teknologjisë dhe të drejtave të njeriut, që përfaqësojnë gamën e gjerë nga palët e interesuara, përfshirë këtu edhe median, shoqërinë civile, qeverinë dhe institucionet akademike nga mbarë rajoni i OSBE-së dhe më gjerë. Hulumtimi përfshiu analizën e hollësishme të kuadrit përkatës ligjor dhe politikave në nivel botëror, çka u pasurua më tej me intervista me platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë dhe konsultim publik gjatë që pranoi mbi 30 parashtresa nga 16 shtete dhe pjesëmarrës ndërkombëtarë nga akademia, shoqëria civile, mediat, sindikatat e gazetarëve dhe transmetuesve, sektori privat dhe përfaqësues shtetesh, përfshirë edhe agjenci rregulluese.


Kreu I i këtij Manuali Politikash, i titulluar “Përmbledhje” (faqe 10-31), ofron pasqyrë të përmbledhur të gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore në tri fusha kyçe: dallimin, stabilitetin financiar dhe vigjilenca (siguria) e medias. Secila prej këtyre fushave shtjellohet në më shumë hollësi në pjesët vijuese. Referencat e ndërsjella në këtë pjesë e orientojnë lexuesin drejt pjesëve përkatëse në Kreun II.


Kreu II, i titulluar “Analizë e thelluar” (faqe 32-163), përvijon sfidat kryesore ndaj lirisë së medias në ekosistemin e sotëm të informimit në rrjet, të mbizotëruar nga një numër i vogël kompanish të mëdha teknologjike. Ai paraqet analizën e thelluar të ndërhyrjeve me politika që kryhen për t’i adresuar këto sfida. Në pjesën përmbyllëse jepen rekomandime teknike për shtetet se si të zbuten dëmet ekzistuese, si dhe udhëzime për ndërtimin e hapësirave të shëndetshme të informimit në rrjet mbi premisat e lirisë së medias dhe interesit publik.

Listë e përzgjedhur e shkurtesave

KAKK	Komisioni Australian i Konkurrencës dhe Konsumatorit
IA	Inteligjenca Artificiale
AVMSD	Direktiva e BE-së për shërbimet mediatike audio-vizuale
ODMKBSH	Organizata Daneze e Menaxhimit Kolektiv të Publikimeve të Shtypit
ASHD	Akti i BE-së për Shërbimet Digjitale
KSHD	Koordinatori i Shërbimeve Digjitale
TSHD	Taksa për Shërbime Digjitale
AELM	Akti Evropian për Lirinë e Mediave
BE	Bashkimi Evropian
NBG	Nisma për Besim në Gazetari
MMGJ	Model i Madh Gjuhësor
SHJKII	Shpërndarje Jo Konsensuale e Imazheve Intime
PNGJ	Përpunim Natyror i Gjuhës
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MP	Media Publike
RAG	Gjenerim I Asistuar nga Rikthimi I Informacionit
PLM	Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias
SLAPP	Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike
ASO MB	Akti i Sigurisë në Rrjet i Mbretërisë së Bashkuar
PSHMRR	Platformë Shumë e Madhe në Rrjet

PËRMBLEDHJE





1. Përmbledhje Ekzekutive

Ky Manual Politikash vë në dukje mënyrat ku ekosistemi digjital bashkëkohor i informacionit, i dominuar nga platformat e mëdha të teknologjisë (platformat shumë të mëdha të rrjeteve sociale dhe motorët e kërkimit, e kohëve të fundit edhe kompanitë e inteligjencës artificiale), po kapet gjithnjë e më shumë në forma që e cenojnë lirinë e medias. Ai thekson nevojën për ndërhyrje demokratike të shtetit, sipas parimeve të rendit ligjor, për të siguruar ekzistencën e mjedisit që mundëson gazetarinë e pavarur dhe pluraliste, paraqet vizion për hapësira të shëndetshme informimi në rrjet që garanton disponueshmëri dhe qasje në informacion me interes publik. Po ashtu, ai propozon masa zbutëse dhe rekomandime kyçe për shtetet që t'u shërbejë në zbatimin e reformave strukturore afatgjata, dhe në kryerjen e investimeve të qëndrueshme, për t'i adresuar shtrembërimet e ekosistemit të sotëm të informacionit në rrjet. Masat zbutëse të rekomanduara shtrihen në tri fusha kryesore:

- **Dallimin e gazetarisë dhe informacionit me interes publik në rrjet:** Manuali shqyrton mekanizmat për promovimin e gazetarisë së pavarur dhe informacionit me interes publik, përfshirë detyrimet për përmbajtje të detyrueshme për lajmet (shihni fq.66-67), të shoqëruar me garanci të fuqishme për lirinë e medias;

- **Stabiliteti financiar i mediave dhe modelet e financimit që mbështesin informacionin me interes publik:** Manuali trajton rëndësinë e platformave për ekosistemin mediatik, dhe shqyrton mundësitë për kompensim të drejtë, përfshirë edhe kode/skema negociimi në mirëbesim me mediat me fokus lajmin dhe tarifa digjitale;
- **Vigjencia, ose siguria në rrjet e gazetarëve:** Manuali thekson rëndësinë e rregullimit, ndryshimeve në skicën e platformave, dhe angazhimit për bashkëpunim kuptimplotë shumëpalësh për parandalimin dhe uljen e dëmeve nga dhuna në rrjet ndaj gazetarëve.

Në thelb të këtij Manuali Politikash qëndrojnë udhëzimet për krijimin e **hapësirave të shëndetshme të informimit në rrjet**, duke e çliruar ekosistemin nga përqendrimi i tepruar i pushtetit kontrollues mbi qasjen dhe dallimin e informacionit dhe, në vend të saj, kultivohet **mjedisi mundësues për lirinë e mediave në epokën e algoritmeve dhe inteligjencës artificiale (IA)**. Manuali arrin në përfundimin se, për ta mbrojtur lirinë e medias, nuk mjafton të adresohen vetëm sfidat që lidhen me platformat, por nevojiten **reforma strukturore më ambicioze** që shkojnë përtej zbutjes së varësisë nga platformat dhe synojnë ndërtimin e tablosë së informacionit dhe mediave në rrjet që janë të pavarura e pluraliste çka frymon debatin demokratik dhe qëndresën shoqërore.

Ky Manual Politikash përdor termin “platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë” për të përshkruar një numër të vogël kompanish teknologjike të fuqishme, sidomos platformat e rrjeteve sociale dhe motorët e kërkimit, e kohëve të fundit edhe kompani të IA, që mbizotërojnë hapësirën e informimit në rrjet. Ndonëse nuk ka përkufizim të unifikuar për “platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë”, botimet në fushën e rregullimit dhe të kërkimit shkencor japin udhëzime orientuese. Për shembull, përkufizimi i Aktit të Bashkimit Evropian për shërbimet digjitale për “platformat shumë të mëdha në rrjet” (PSHMO) bazohet në madhësinë e bazës së përdoruesve, ndërkohë që literatura akademike¹ propozon kategori

1 Për shembull, shihni R. Gorwa, R. Binns dhe C. Katzenbach, “Moderimi algoritmik i përmbajtjes: Sfidat teknike dhe politike në automatizimin e qeverisjes së platformave.” në “*Big Data & Society*”, Vëll.7, Nr.1 (2020), <https://journals.sagepub.com/doi/10.1177/2053951719897945>.

dhe tipologji të ndryshme platformash. Në këtë Manual, termi “platforma të kompanive të mëdha të teknologjisë” përdoret për të vënë në dukje rolin e disa kompanive të mëdha teknologjike që, në sajë të madhësisë dhe pushtetit të tyre, ushtrojnë kontroll të madh mbi mjedisin informues. Për informacion të mëtejshëm, shihni Pjesën e 4-t.

Kur u referohet hapësirave të “shëndetshme” të informimit në rrjet, Manuali nënkupton ekosistemin pluralist, të pavarur, gjithëpërfshirës dhe të sigurt për kërkimin, marrjen dhe dhënien e informacionit në fushën digjitale. Ky ekosistem mbron si dallimin e stabilitetit financiar e informacionit në shërbim të interesit publik dhe sipas standardeve profesionale të gazetarisë, ashtu edhe vigjilenca (siguria) e atyre që e prodhojnë dhe e ndajnë atë. Ekosistemi i shëndetshëm i informacionit digjital nuk dominohet nga një a më shumë fuqi vendimmarrëse që kontrollojnë qarkullimin e informacionit, përkundrazi ofron një sistem të balancuar ku nxitet pluralizmi, llogaridhënia dhe qëndrueshmëria.

Analiza dhe rekomandimet e paraqitura në këtë Manual mbështeten në **praktikat më të mira ndërkombëtare, në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut** dhe **angazhimet në OSBE**, si dhe në **analizën gjithëpërfshirëse** të legjislacionit të miratuar rishtas në hapësirën e OSBE-së dhe më gjerë, veçanërisht nga Bashkimi Evropian (BE) dhe shtetet anëtare, Mbretëria e Bashkuar, Australia, Kanadaja dhe shtete tjera që prijnë me zhvillimin e qasjeve rregulluese në këtë fushë.

Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) është promovimi i stabilitetit, sigurisë dhe demokracisë, vlera këto të ndërthurura ngushtë me mbrojtjen dhe promovimin e lirisë së medias. Ndaj me këtë parim, ky Manual Politikash nga Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias (PLM) ofron rekomandime për mënyrat ku shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së mund të promovojnë një ekosistem të shëndoshë, të qëndrueshëm dhe pluralist të informimit në rrjet mbi premisat e lirisë së medias dhe interesit publik.

2. Gjetjet dhe Rekomandimet Kryesore

Këtu paraqitet pasqyra e përmbledhur e gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore, që shtjellohen më tej në Kreun II, me referenca në analizën e thelluar dhe rekomandimet e detajuara në vijim.

2.1 Gjetjet kryesore

Pushteti kontrollues mbi informacionin e platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë përcakton se cilat lajme shihen dhe dëgjohe

Sot, mediat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mjedisin që bazohet në platforma. Shumë prej vështirësive me të cilat përballet gazetaria e ditëve të sotme janë rezultat i ndryshimeve në mënyrën e shpërndarjes dhe konsumit të përmbajtjes mediatike, si dhe rolit që teknologjitë e reja digjitale kanë si shtytëse të këtij transformimi, veçanërisht platformat e rrjeteve sociale, motorët e kërkimit dhe veglat e IA prodhuese. Platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë e kanë përqendruar pushtetin e tyre kontrollues mbi informacionin **jo vetëm duke vendosur se çfarë përmbajtje qaset, por edhe duke diktuar se cilës përmbajtje i duhet kushtuar vëmendje.**

Për informacion të mëtejshme mbi ekonominë e shkallës së platformave, shihni [Pjesën 4.1](#) të këtij Manuali Politikash.

Kontrolli i përqendruar krijon rreziqe sistemike për pluralizmin dhe demokracinë

Platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë ushtrojnë kontroll të gjerë mbi informacionin, gjerësisht mbi mënyrën se si ky i fundit prodhohet, shpërndahet, renditet, vlerësohet dhe qaset. Ato prodhojnë fitime të mëdha nga përmbajtja që shpërndajnë dhe shtyjnë fuqishëm kundër rregullimit në këtë fushë. Dominimi i tillë sjell **përqendrimin e pushtetit mbi informacionin në duart e një numri të vogël kompanish të teknologjisë** dhe krijon rreziqe sistemike për lirinë e medias, pluralizmin dhe demokracinë në përgjithësi. Marrëdhënia ndërmjet mediave dhe oligopoleve teknologjike karakterizohet nga **qasja e çekuilibruar në informacion**, fuqi të pabarabarta negociuese, modele biznesi konkurruese dhe mospërputhje vlerash e stimuljsh.

*Për informacion të mëtejshëm mbi varësinë e mediave, shihni **Pjesën 4.2** të këtij Manuali Politikash.*

Dallimi, stabiliteti financiar dhe vigjilenca (siguria) e medias janë qenësish të ndërthurura.

Mungesa e **dallimit** të lajmeve dhe gazetarisë së pavarur në interes publik lidhet me faktin se shpërndarja kontrollohet nga platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë, modelet e biznesit dhe algoritmet e të cilave u japin më shumë përparësi të ardhurave se cilësisë së informacionit. Kapja e tregut të reklamave nga platformat rezultojnë në shpërndarje të padrejtë të reklamave dhe forma të tjera të nxjerrjes së vlerës nga përmbajtja gazetareske pa **kompensim** të drejtë (**stabiliteti financiar**), ndërkohë që **dhuna** në rrjet ndaj gazetarëve mundësohet dhe përkeqësohet nga skicimi i platformave që orienton angazhimin e përdoruesve dhe sistemet e dobëta të drejtimit të përmbajtjes (**vigjilenca/siguria**).

Këto dinamika e përforcojnë njëra-tjetrën: kufizimi i dallimit të përmbajtjes nga kompanitë e mëdha të teknologjisë cenon stabilitetin financiar, ndërkohë që mungesa e qëndrueshmërisë dhe e mbrojtjes ul aftësinë e gazetarëve për të prodhuar informacion me interes publik dhe për të qenë të dukshëm në rrjet. Kështu, krijohen rrethe vicioze ku i gjithë ekosistemi i informacionit komprometohet.

Shtetet duhet ta respektojnë, mbrojnë dhe arrijnë lirinë e medias, përfshirë edhe me masa politikash proaktive.

Shtetet kanë detyrimin të garantojnë lirinë e medias dhe kanë përgjegjësinë parësore për krijimin e mjedisit të favorshëm ku liria e medias të mund të lulëzojë. Kjo përfshin edhe përgjegjësinë për të garantuar se tabloja e informacionit dhe media të mos kontrollohet ose bllokohet nga palë private, si korporatat e mëdha të teknologjisë, apo nga kombinimi privat-shtet. Ndaj, shtetet duhet të marrin masa për të siguruar stabilitetin, qasjen dhe pavarësinë e mediave në mjedisin e platformave. Në këtë drejtim, marrja e **masave zbutëse mund të ndihmojnë në zbutjen e sfidave të përshkruara** në periudhën afatshkurtër.

*Për rekomandimet e sugjeruara të politikave, shihni **Pjesën 5** mbi dallimin e mediave, **Pjesën 6** për stabilitetin financiar të mediave dhe **Pjesën 7** për vëgjilencën (sigurinë) e mediave.*

Megjithatë, në planin afatgjatë, mediave do t'u duhet të krijojnë modele të reja dhe financiarisht të qëndrueshme biznesi për të ulur varësinë nga platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë, veçanërisht nga rrjetet sociale ashtu siç i njohim sot. Për ta arritur këtë, nevojitet të krijohet ekosistemi mundësues, me modele alternative të shpërndarjes dhe financimit, që shtetet duhet ta mundësojnë dhe mbështesin.

*Për informacion të mëtejshëm rreth ndryshimeve strukturore, shihni **Pjesën 8**.*

Shtetet po miratojnë ndërhyrje me politika për të krijuar privilegje dhe mbrojtje të reja për mediat dhe gazetarët.

Gjatë dekadës së fundit është rritur ndërgjegjësimi për faktin se, në ekosistemin aktual digjital, **qëndrueshmëria financiare e medias lidhet drejtpërsëdrejti me dallimin e përmbajtjes së tyre**, dhe se gazetarët po shënjestrohen në rrjet, shpesh si rrjedhojë e algoritmeve të orientuara nga prodhimi i të ardhurave. Vëmendje e konsiderueshme i është kushtuar hartimit të strategjive dhe politikave që synojnë kapërcimin e këtyre sfidave. Janë bërë përpjekje rregulluese për të krijuar kode vullnetare sjelljeje në platforma, për transparencë të të dhënave, për taksim dhe miratim ligjesh. Ndonëse është bërë punë e madhe për të siguruar kompensim të drejtë për shpërndarjen e përmbajtjes gazetare,

asimetritë e pushtetit ndërmjet platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë dhe botuesve vazhdojnë të jenë problem madhor. **Platformat kanë rezistuar fuqishëm që të paguajnë për gazetari, kanë gjetur mënyra të reja për t'iu shmangur taksave dhe kanë lobuar fuqishëm kundër rregullimit.** Masat rregulluese të hartuara për ta mbrojtur gazetarinë shpesh nuk i përmbushin pritshmëritë, madje në disa raste kanë sjellë pasoja negative të padëshiruara. Në mënyrë gjithnjë e më të theksuar, autoritetet rregulluese po e kuptojnë se në thelb të problemit qëndron dominimi i platformave dhe asimetritë e pushtetit.

Për shembull, në Australi, ndërhyrjet rregulluese në fushën e konkurrencës sollën në fund pagesën ndaj botuesit nga *Google* dhe *Meta*, ndërkaq ligje të ngjashme në Kanada e shtynë *Meta* të tërhiqet nga shpërndarja e lajmeve. Gjithashtu, *Meta* ka refuzuar t'i ripërtërijë kontratat në Australi, ndërkohë që *Google* ka lobuar kundër ligjeve dhe rregulloreve të ngjashme edhe në shtete tjera, përfshirë këtu Brazilin, Afrikën e Jugut dhe Kaliforninë dhe ka ndërprerë shpërndarjen e lajmeve në disa pjesë të Evropës, si një lloj "testi". Këto veprime tregojnë se platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë janë të gatshme të **kufizojnë qasjen në gazetari, në vend që të pranojnë masa ku do u preken fitimet.** Rezistenca e tyre i ka shtyrë rregullatorët të shqyrtojnë **masa të reja.**

Australia ka propozuar **tarifë digjitale** për platformat që nuk janë të gatshme të negociojnë me botuesit. Shtete si Shqipëria, Austria, Gjermania, Afrika e Jugut dhe të tjera po shqyrtojnë (ose tashmë po zbatojnë) masa të ngjashme, të tilla si instrumente më të gjera fiskale ose taksa mbi shërbimet digjitale, që mund të ndihmojnë financimin e gazetarisë.

Nënvlerësimi nga platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë i vlerës ekonomike të lajmeve në suazat e shërbimeve të tyre dhe rezistenca ndaj kompensimit ka bërë që disa shtete të marrin në konsideratë edhe politika që e bëjnë të detyrueshme qasjen në gazetarinë në interes publik, përfshirë këtu edhe **politika për përmbajtje të detyrueshme ose politika për dallimin dhe**

privilegje për mediat, me qëllim sigurimin e disponueshmërisë dhe qasjes së gazetarisë në rrjet. Kjo shënon një pikë kthese të rëndësishme në qasjen e politikëbërësve, ndonëse efektiviteti dhe shtrirja e zbatimit të këtyre masave në nivel botëror vazhdojnë të ngelen çështje të hapura, veçanërisht për shkak të shqetësimeve lidhur me keqpërdorimin e mundshëm.

Për analizë të thelluar të ndërhyrjeve me politika, shihni [Pjesën 5.1](#) për ndërhyrjet që lidhen me dallimin e mediave, [Pjesën 6.1](#) për stabilitetin financiar të mediave dhe [Pjesën 7.1](#) për vigjilencën (sigurinë) e mediave.

Paradoksi i privilegjit: ndërhyrjet me politika mund të bartin rreziqe për lirinë e medias

Miratimi i politikave të dallimit për informacion “të cilësisë së lartë” dhe “në interes publik” mund të duket si zgjidhje joshëse për t’i kundër balancuar varësitë ekzistuese të mediave dhe promovuar qasje në informacion të besueshëm, duke e mbështetur njëkohësisht stabilitetin e mediave. Megjithatë, shtrohet pyetja se çfarë duhet të konsiderohet **“gazetari në interes publik” dhe kush duhet ta përcaktojë këtë**, çka sjell **shqetësime për keqpërdorim të mundshëm politik ose për thellimin e dinamikave ekzistuese të pushtetit**. Rreziqe të tilla bartin edhe ndërhyrjet e tjera të trajtuara në këtë Manual Politikash, si kapja rregulluese ose thellimi i asimetrive ekzistuese të pushtetit, veçanërisht në mjedise ku mungon mbikëqyrja e pavarur ose ku institucionet demokratike nuk janë të mirë konsoliduara.

Rreziqet dhe dinamikat e pushtetit trajtohen në pjesët tematike përkatëse dhe në [Pjesën 8.2](#). Shtojca përmban një pasqyrë të përmbledhur të qasjeve rregullatore, të analizuara sipas shteteve.

Ndërhyrjet me politika duhet të shoqërohen me garanci të fuqishme të rendit ligjor

Për ta mbrojtur lirinë e medias, në radhë të parë duhet të zbuten sfidat me të cilat përballen mediat dhe tejkalohe kapja strukturore e ekosistemit të informacionit digjital. Çdo ndërhyrje duhet të konceptohet me kujdes dhe të shoqërohet me garanci të fuqishme, **pajtim me të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe mekanizma institucionale të kontrollit dhe balancimit reciprok**. Ndërhyrjet duhet të reflektojnë edhe **ndërlidhjen ndërmjet politikave të dallimit e qëndrueshmërisë financiare** nga njëra anë dhe aspekteve **të vigjilencës** nga ana tjetër, qasje këto thelbësore për garantimin e sigurisë së gazetarëve.

*Ky Manual Politikash jep rekomandime për ndërhyrje politikash në **Pjesën 5.2** lidhur me dallimin e mediave, në **Pjesën 6.2** për stabilitetin financiar të medias dhe **Pjesën 7.2** për vigjilencën (sigurinë) e medias.*

Zbutja është e nevojshme urgjentisht, por për mbrojtjen e lirisë së medias nevojitet transformim në formën e ndryshimeve strukturore dhe investimeve të qëndrueshme në hapësira të shëndetshme informimi në rrjet.

Përveç adresimit të dëmeve ekzistuese dhe atyre të shpërfaqura rishtas, si dhe zbutjes së cenimeve të lirisë së mediave, shtetet duhet të investojnë edhe në të ardhmen ku liria e medias lulëzon në hapësira digjitale të informacionit të konceptuara që t'i shërbejnë interesit publik. Për të krijuar **hapësira të shëndetshme të informimit në rrjet** është e nevojshme që këto të fundit të çlirohen nga pushteti dominues mbi informacionin. Në këtë kontekst është thelbësor promovimi dhe investimi në **infrastrukturë të re digjitale në shërbim të interesit publik**.

*Për informacion të mëtejshëm rreth kësaj çështjeje, shihni **Pjesën 8.3**.*

REKOMANDIMET KRYESORE

2.2 Rekomandimet kryesore

Ky Manual Politikash ofron **paketë ndërhyrjesh të mundshme me politika** që synojnë sigurimin e disponueshmërisë dhe qasjes në **informacion në interes publik**, si edhe kultivimin e ekosistemit **më të shëndetshëm të informimit në rrjet**. Ai mbështetet tek analiza krahasuese e thelluar e ndërhyrjeve të ndërmarra deri më tani, konsultime me ekspertë dhe mësimet e nxjerra nga një sërë përvojash shtetërore e rajonale, si pikë orientim për rrugëtimin e mundshëm. Megjithatë, opsionet e politikave të paraqitura në këtë Manual **nuk** duhet të kuptohen si **receta universale**, duke qenë se efektiviteti dhe përshtatshmëria e çdo ndërhyrjeje **varet nga konteksti specifik politik, ligjor dhe institucional** në të cilin ajo zbatohet. Qasjet e shqyrtuara janë **të ndjeshme ndaj kontekstit, madje në disa raste edhe të kontestueshme**, ndërkaq ndikimi i tyre në pluralizmin dhe lirinë e medias nuk është kuptuar akoma tërësisht. Disa ndërhyrje trajtohen pikërisht sepse opsionet e mëhershme, në dukje më të përshtatshme ose më pak ndërhyrëse, kanë dështuar (p.sh. tarifa digjitale shqyrtohet si mundësi për shkak të suksesit të kufizuar të përpjekjeve për kompensim të drejtë, ndërkaq interesimi për rregulla të përmbajtjes së detyrueshme buron nga shqetësimi se platformat mund ta kufizojnë qasjen në lajme për t'iu shmangur detyrimeve për kompensim). Në thelb, çdo **ndërhyrje duhet të jetë e bazuar në parimet e rendit ligjor**, të jetë në pajtim me **standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut**, të kryhet përmes **proceseve gjithëpërfshirëse**,

transparente dhe shumëpalëshe të kujdesit të duhur, si dhe zbatohet nga **organe rregulluese e gjykata të pavarura.**

Për informacion të mëtejshëm për parimet kryesore të ndërhyrjeve shtetërore, shihni [Pjesën 8.2.](#)

Ndërkohë që ndërhyrje të caktuara me politika janë të domosdoshme për t'i adresuar sfidat aktuale të ekonomisë së platformave, për **mbrojtje afatgjatë të lirisë së medias nevojiten reforma strukturore, ulja e përqendrimit tek pushteti dhe zhvillimi i infrastrukturës digjitale e orientuar nga interesi publik.** Pjesa dërrmuese e masave zbutëse të paraqitura në këtë Manual adresojnë vetëm njërin prej problemeve strukturore me të cilat përballen mediat: faktin që marrëdhënia ndërmjet mediave dhe publikut ndërmjetësohet nga platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë, që i përmirësojnë algoritmet e tyre për qëllime të tjera dhe jo për t'u ofruar qytetarëve informacion të larmishëm dhe të besueshëm. Ajo çfarë nevojitet në periudhën në vijim është të ndërtohet **ekosistemi digjital i pavarur i informacionit**, ku mediat të mund ta realizojnë rolin demokratik të informimit të publikut pa qenë të varura nga kontrolli mbi infrastrukturën e informimit i centralizuar në duart e një shpure kompanish të teknologjisë. Për këtë arsye, qasjet e përshkruara në këtë Manual Politikash duhet të kuptohen si **pikënisje për analizë, diskutim dhe politikëbërje të përshtatur sipas kontekstit**, dhe si bazë për strategji afatgjata për rindërtimin e një hapësire të informimit në rrjet që garanton lirinë e shprehjes, pluralizmin e medias dhe qëndresën demokratike. Zyra e PLM të OSBE-së është e gatshme të ofrojë mbështetje për realizimin e këtij vizioni.

Masat zbutëse që synojnë promovimin e dallimin e mediave në periudhën afatshkurtër

Me **politika dallimi** mund të ndërhyhet, në shkallë të ndryshme, në kontrollin që platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë ushtrojnë mbi informacionin, duke filluar nga masat si etiketat e transparencës dhe “sinjalet e besimit” që u mundësojnë qytetarëve të identifikojnë dhe ndjekin përmbajtje mediatike të besueshme, e deri te trajtimi i veçantë në vendimet për largim të përmbajtjes, dhe detyrimet për theksim të duhur që synojnë renditjen e përmbajtjes mediatike.

Për informacion të mëtejshëm për format e ndryshme të politikave të dallimit, shihni Pjesën 5.

Pavarësisht nga shkalla e ndërhyrjes, shumica e politikave për dallimin duhet të shoqërohen me **kategorizim dhe përcaktim të qartë se cilat organizata (mediatike), ose çfarë “përmbajtje në interes publik”,** kualifikohet për politikën përkatëse. Kjo paraqet sfidë madhore, sepse prezumohet përkufizim juridikisht i pranueshëm i këtij koncepti, ndërkohë që tiparet përkatëse të gazetarisë me interes publik (p.sh., objektiviteti, drejtësia, larmia) është e vështirë të përkufizohen dhe maten me algoritëm,² si dhe një proces vlerësimi i besueshëm i zbatimit të standardeve të vendosura.

Përveç politikave për dallimin që synojnë drejtpërsëdrejti mbrojtjen e lirisë së medias, ekzistojnë edhe një sërë opsionesh të tjera për rritjen e dallimit të informacionit në interes publik si, për shembull, detyrimi për **ri përshtatjen e renditjes së përmbajtjes**, në mënyrë që renditja të mos jetë e bazuar në angazhim të **përdoruesve** por të jetë më e orientuar nga interesi publik, ose detyrimi për ndërveprueshmëri të sistemeve rekomanduese të ndryshme të palëve të treta në mënyrë që përdoruesit të kenë mundësi të zgjedhin nga algoritmet e ndryshëm për renditje të përmbajtjes.

Duke u nisur nga përgjegjësia që kanë shtetet për të siguruar qasje në informacion të besueshëm, për qasje tek përmbajtja gazetareske,³ ato duhet t’i hartojnë dhe zbatojnë politikat për dallimin në pajtim me konsideratat e mëposhtme:

- **Garanci të mjaftueshme** — çdo politikë dallimi duhet të ngërthejë garanci të forta për parandalimin e kapjes politike ose kapjes nga platformat. **Sa më e lartë të jetë shkalla e ndërhyrjes, aq më të forta dhe aq më shumë të mbështetura në historik të dëshmuar efektiviteti duhet të jenë garancitë. Garancitë kryesore përfshijnë:** sigurimi që

2 Shihni për shembull lidhur me larinë: S. Vrijenhoek dhe të tjerë, “RADio – Njësi matëse të divergjencës të ndjeshme ndaj renditjes për matjen e larmisë normative në rekomandimet e lajmeve,” tek *Punimet e Konferencës së 16-të të ACM për sistemet rekomanduese* (2022), fq.208-219, <https://dl.acm.org/doi/abs/10.1145/3523227.3546780>. Për shembull, përpjekje për përcaktimin sasior të gazetarisë nëpërmjet algoritmeve janë bërë mes tjerash nga Deepnews.AI dhe Newsguard.

3 Për shembull, AELM i detyron shtetet anëtare të BE-së të sigurojnë qasje në “shumëllojshmëri përmbajtjesh mediatike të pavarura në aspektin e redaksisë”. GJEDNJ e ka theksuar rregullisht këtë detyrim, p.sh., në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çështja NIT SRL kundër Republikës së Moldavisë, Strasburg (5 prill 2022), [https://hudoc.echr.coe.int/fre#{"itemid":\["001-216872"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/fre#{).

procesi i kualifikimit për privilegje mediatike të jetë i qasshëm për gamë të gjerë aktorësh mediatik; vendimet mbi atë se kush kualifikohet për politika dallimi të merren përmes proceseve të pavarura, transparente dhe të decentralizuara për vetërregullim të mediave; të siguroarit që politikat e dallimit të zbatohen nga autoritete të pavarura; detyrimi për platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë që t’i zbulojnë të dhënat rreth mediave që kualifikohen për politika dallimi dhe përfitimeve përkatëse. Politikat duhet të hartohen me kujdes në mënyrë që të mos thellojnë më tej varësinë e mediave nga platformat dhe as të krijojnë hapësirë për keqpërdorim për qëllime politike.

- **Politikat e dallimit** — Shtetet duhet që në radhë të parë të miratojnë politika dallimi që synojnë transparencën, ndërveprueshmërinë dhe fuqizimin e përdoruesve. Këtu përfshihen politikat që detyrojnë **platformat e mëdha të teknologjisë t’i publikojnë kriteret dhe algoritmet që i përdorin për përzgjedhjen dhe renditjen e përmbajtjes (autoritare ose në interes publik)**, si dhe t’u ofrojnë përdoruesve mundësinë e përdorimit të sistemeve rekomanduese që i ekspozojnë ndaj informacionit të larmishëm dhe gazetarisë së pavarur. Krahas kësaj, shtetet duhet t’u kërkojnë platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë të mundësojnë ofrimin nga palë të treta të sistemeve të ndërveprueshme rekomanduese, nga mesi i të cilave përdoruesit mund të zgjedhin të parapëlqyerin e tyre për t’iu qasur informacionit. Më tej, shtetet duhet të sigurojnë zbatimin e legjislacionit ekzistues që garanton të drejtat e gjithë përdoruesve për liri të shprehjes në platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë, si dhe ta vënë lirinë e medias dhe interesin publik në qendër të politikëbërjes së tyre.
- **Avancimi i mëtejshëm i politikave të dallimit me garanci të forta** — Aty ku sundimi i ligjit dhe kapacitetet institucionale janë të forta, shtetet duhet ta shqyrtojnë mundësinë që t’u **kërkojnë platformave të sigurojnë në mënyrë më proaktive disponueshmërinë dhe qasshmërinë e gazetarisë në interes publik**. Kjo mund të përfshijë detyrimin që platformat të krijojnë mekanizma transparentë përmes të cilëve mediat mund t’i ankimojnë në kohë vendimet e moderimit, detyrimin për të zbatuar në mënyrë të vazhdueshme politika moderimi dhe rekomandimi që parandalojnë diskriminimin ndaj mediave të caktuara, si dhe detyrimin për të siguar dallimin më të madh të përmbajtjes

gazetareske dhe autoritare, me qëllim rritjen e qasjes së përdoruesve në informacion të besueshëm. Për shembull, kjo mund të kryhet duke u kërkuar platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë që në renditjen algoritmike t'i japin prioritet më i madh përmbajtjes gazetareske, sidomos asaj vendore dhe rajonale.

- **Politikat e dallimit për IA prodhuese** — Shtetet duhet të vendosin detyrime që përmbajtja e prodhuar nga IA prodhuese **të shoqërohet me lidhje që e drejtojnë përdoruesin te burimet origjinale të lajmeve**. Po ashtu, duhen mandatuara standarde të pluralizmit mediatic për të inkurajuar ofrimin e lidhjeve drejt një game të larmishme burimesh për lajmet. Zhvilluesit e IA duhet të detyrohen që të ndërmarrin masa për mbrojtjen e reputacionit të mediave, si dhe të krijojnë mekanizma për trajtimin e ankesave dhe për kthim të shpejtë të përgjigjeve.

Për rekomandime më të hollësishme rreth dallimit të medias, shihni [Pjesën 5.2](#).

Masat zbutëse që synojnë promovimin e qëndrueshmërisë financiare të mediave në periudhën afatshkurtër

Për ta rritur stabilitetin financiar të mediave, shtetet duhet të:

- **Sigurojnë kompensim të drejtë** — Shtetet duhet të sigurojnë kompensim të drejtë për mediat dhe për përmbajtjen mediatike e gazetareske që përdoret nga platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë për të prodhuar të ardhura nga reklamat dhe për të krijuar vlera tjera për shërbimet e tyre. Instrumentet kryesore të politikëbërjes për këtë qëllim përfshijnë bashkë rregullimin, të drejtat e autorit, rregullat e konkurrencës dhe taksën për shërbime digjitale. Secili prej këtyre instrumenteve duhet të shoqërohet me garanci për pluralizëm, mbikëqyrje të pavarur dhe sanksione proporcionale për sigurim të pajtimit. **Kodet dhe kuadrot e negocimit në mirëbesim** duhet të mishërojnë parimet themelore të pjesëmarrjes, mbështetjes së negocimit kolektiv, mbrojtjes së pluralizmit të medias dhe garantimit të pavarësisë së medias, veçanërisht në kontekste të ndjeshme ndaj kapjes. Për ta menaxhuar rrezikun e hakmarrjes së platformave (p.sh., ndërprerja e shpërndarjes së lajmeve, siç është parë në Kanada dhe gjetkë), kodet dhe kuadrot e negocimit duhet të parashohin gjithashtu **garanci për dallimin** (që mund të përfshijnë theksimin dhe gjetjen e përmbajtjes).

- **Shqyrtojnë dispozita për përmbajtje të detyrueshme** — Për t’i adresuar reagimet e kompanive të mëdha të teknologjisë ndaj përpjekjeve për rregullim (p.sh. hakmarrje, bllokimi i plotë i lajmeve, lobim intensiv kundër legjislacionit etj.), në suazat e diskutimeve mbi politikën po shqyrtohen koncepte të tilla si dispozitat për përmbajtje të detyrueshme, deklarimi i shërbimeve ose funksioneve të caktuara të ofruara nga **kompanitë e mëdha të teknologjisë si shërbim publik** dhe vendosja e **detyrimeve të shërbimit universal**. Megjithëse qasjet e tilla janë kontestuar për sa i përket efektivitetit të tyre (përfshirë edhe përshtatjes për shtete të ndryshme), rrezikun për thellim të mëtejshëm të pushtetit kontrollues mbi informacionin dhe potencialit për keqpërdorim, shqyrtimi i tyre mund të kontribuojë në garantimin e dallimit dhe, rrjedhimisht, qëndrueshmërisë financiare të gazetarisë me interes publik.
- **Trajtojnë përqendrimin e tregut të reklamave** — Shtetet dhe organizatat ndërqeveritare duhet ta trajtojnë dominimin e shtuar të kompanive të mëdha të teknologjisë në tregun botëror të reklamave, sidomos të atyre që veprojnë njëherazi si ndërmjetës dhe si konkurrentë të drejtpërdrejtë të mediave në këtë treg. Për të siguruar kushte të barabarta konkurrence, shtetet duhet të:
 - sigurojnë **shpërndarje më të drejtë të të ardhurave nga reklammat** që platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë prodhojnë nga shpërndarja dhe vlerësimi financiar i përmbajtjes gazetareske;
 - shtojnë përpjekjet për **heqjen e vlerësimit financiar e keqinformimit dhe të aktorëve mashtrues;**
 - **krijojnë stimuj për reklamuesit që të investojnë në gazetarinë në interes publik.**
- **Vendosin taksë për shërbime digjitale për t’i mbështetur mediat me interes publik** — Shtetet duhet të zbatojnë një tarifë digjitale, të ardhurat nga e cila të jenë të destinuara për mbështetjen e mediave të pavarura dhe në shërbim të interesit publik. Shpërndarja e mjeteve duhet të bazohet në kritere të qarta dhe transparente dhe të menaxhohet nga trupa të pavarura, me garanci kundër ndikimit politik dhe çdo ndikimi tjetër të papërshtatshëm.

- **Trajojnë IA prodhuese** — Shtetet duhet ta rregullojnë IA prodhuese për të siguruar **kompensim të duhur** për krijuesit dhe botuesit e përmbajtjes në rastet kur përmbajtja e tyre përdoret për trajnim dhe aplikacione të inteligjencës artificiale,⁴ përfshirë edhe:
 - të drejtën për të ditur;
 - të drejtën për të zgjedhur të marrësh pjesë (dhe të çregjistrohesh në çdo fazë);
 - të drejtën për kompensim të drejtë.
- **Mbështesin ndryshimin e burimeve të të ardhurave për mediat** — Shtetet duhet të promovojnë modele të qëndrueshme financimi përmes një kombinimi të:
 - politikave të favorshme tatimore;
 - financimit publik transparent dhe të pavarur për gazetarinë me interes publik, me vëmendje të veçantë për mediat lokale dhe rajonale;
 - mekanizmave të financimit nga qytetarët (p.sh., abonimet, mikropagesat, platformat e donacioneve);
 - granteve për risi.

Për rekomandime të hollësishme mbi stabilitetin financiar të medias, shihni [Pjesën 6.2](#).

Për informacion të mëtejshëm për konceptin e përmbajtjes së detyrueshme, shihni [Pjesën 5.1](#).

Masat zbutëse që synojnë promovimin e sigurisë së gazetarëve në periudhën afatshkurtër

Si garantues përfundimtarë të sigurisë së gazetarëve, shtetet duhet të hartojnë ndërhyrje që pasqyrojnë natyrën dinamike të ndërveprimit ndërmjet kompanive të mëdha të teknologjisë dhe mediave, dhe që i adresojnë këto marrëdhënie përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të ndërthurur. Ato duhet t'i japin përparësi pjesëmarrjes aktive së të gjitha palëve të interesit, ndërveprueshmërisë së sistemeve të ndryshme teknologjike dhe standardeve teknologjike të qasjes së hapur.

⁴ Forumi për Informacion dhe Demokraci, *IA si e mirë publike: Sigurimi i kontrollit demokratik ndaj IA në hapësirëinformimit*. (shkurt2024), <https://informationdemocracy.org/wp-content/uploads/2024/03/ID-AI-as-a-Public-Good-Feb-2024.pdf>

- **Veçoritë e sigurisë dhe ndërhyrjet teknike** — Shtetet duhet të inkurajojnë dhe të krijojnë stimuj për platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë dhe zhvilluesit e IA që të skicojnë veçori të reja sigurie, dhe t'i avancojnë ato ekzistuese, që ofrojnë **masa parandaluese** (p.sh., instrumente për vlerësim të rrezikut, protokolle për situata krizash), **proaktive** (p.sh., kontroll më i madh nga përdoruesit dhe mënyra sigurie për gazetarët) dhe **reaktive** (p.sh., panele kontrolli për dokumentim dhe siguri, mbështetje nga palë të treta vëzhguese), duke i shoqëruar me garanci kundër keqpërdorimit për censurë dhe kundër dëmeve tjera digjitale.
- **Integrimi i sigurisë në skicim** – Shtetet duhet t'u kërkojnë platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë të dëshmojnë se zbatojnë qasje sigurie të integruar në skicim, ku **veçoritë e sigurisë zhvillohen** me pjesëmarrje kuptimplotë të gazetarëve, aktorëve mediatik dhe palëve të tjera të prekura nga dhuna në rrjet. Shtetet duhet ta bëjnë të detyrueshme kryerjen e kontrolleve të rregullta e të pavarura në skica, si dhe të vlerësimeve të ndikimit në të drejtat e njeriut, me fokus të veçantë te pasojat për lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve, përfshirë edhe rreziqet e veçanta të lidhura me gjininë.
- **Ndërhyrjet me legjislacion dhe politika** — Çdo ndërhyrje ligjore që synon adresimin e dhunës në rrjet ndaj gazetarëve duhet të jetë **në pajtim** të plotë me parimet e rendit ligjor dhe të shoqërohet me mekanizma të fuqishëm të **kontrollit dhe balancimit reciprok**, me qëllim parandalimin e keqpërdorimit. Shtetet duhet të shmangin miratimin e dispozitave penale që mund të keqpërdoren për ta kufizuar lirinë e shprehjes dhe duhet të garantojnë mekanizma ankimi të qasshëm dhe efektivë. Këto ndërhyrje duhet të hartohen **përmes konsultimit** me të gjitha palët përkatëse të interesit dhe po ashtu të:
 - sigurohet se **dispozitat penale** të zbatohen edhe në kontekstin në rrjet dhe ta mbulojnë dhunën në rrjet, përfshirë dhunën me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia;
 - kryhen vlerësime paraprake dhe të rregullta të **ndikimit në të drejtat e njeriut**, që adresojnë rreziqet specifike ndaj lirisë së medias, përfshirë dhunën me bazë gjinore;

- monitorohet **dhuna në rrjet** ndaj gazetarëve dhe platformave t'u kërkohet që të ofrojnë të dhëna rreth sigurisë, përfshirë të dhëna të grupuara sipas gjinisë, shtetit, epilogut të rastit, autorëve dhe elementeve të tjera përkatëse;
 - krijohet një **fond i posaçëm solidariteti** për t'i mbështetur gazetarët dhe punonjësit e mediave që janë shënjestër e dhunës në rrjet;
 - ofrohet **mbështetje financiare për** aktorët dhe organizatat media-tike që veprojnë si **vëzhgues**, si dhe ndihmë për gazetarët që përballen me dhunë në rrjet.
- **Modele shumëpalëshe, gjithëpërfshirëse dhe të mirëfillta të sigurisë** — Shtetet duhet t'i intensifikojnë përpjekjet dhe të shtojnë burimet për forcimin e sigurisë në rrjet në suazat e punës në forume shumëpalëshe në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Ato duhet të:
 - **krijojnë mekanizma sigurie, ose t'i zgjerojnë mekanizmat ekzistues**, që bashkojnë aktorë shtetërorë dhe organizata medi-atike, përfshirë mediat më të vogla dhe ato rajonale, gazetarët (përfshirë gazetarët) dhe përfaqësues nga radhët e komuniteteve të nën-përfaqësuar ose marginalizuara. Financimi, rregullat procedurale dhe kornizat e llogaridhënies duhet të jenë transparente dhe të mundësojnë bashkëhartim të protokolleve dhe strategjive të sigurisë.
 - **krijojnë mekanizma financiarë efektivë dhe të qëndrueshëm** për të mbështetur funksionimin afatgjatë të mekanizmave të sigurisë, veçanërisht për kanalet ekzistuese të përshkallëzimit dhe organizatat partnere të besueshme që angazhohen në mbrojtjen e gazetarëve.


Për rekomandime të hollësishme rreth vigjilencës (sigurinë) e medias, shihni [Pjesën 7.2](#).


Nga zbutja në transformim: Ndryshimet strukturore të nevojshme për ta rimarrë ekosistemin e informacionit

Krahas masave zbutëse të sipërpërmendura, për ta tejkaluar përqendrimin e tepruar të pushtetit dhe për të krijuar alternativa më të shëndosha e më të qëndrueshme nevojiten të bëhen **ndryshime strukturore**. Ndaj nevojitet krijimi i një **infrastrukture të re të informacionit, e udhëhequr** nga interesi publik dhe e bazuar në **decentralizimin e pushtetit** dhe në garantimin e **ndërveprueshmërisë**. Krahas adresimit të dëmeve ekzistuese, përfshirë përmes rregullimit, shtetet duhet po ashtu të investojnë në transformimin e mjedisit digjital të informacionit në ekosistem të konceptuar për t'i shërbyer interesit publik. Shtetet duhet ta forcojnë më tej llogaridhënien demokratike në hapësirat e informimit në rrjet dhe të parandalojnë përqendrimin e tepruar të pushtetit ekonomik, teknologjik ose politik. Mbi të gjitha, ato duhet të mundësojnë ekosistem mediatik të larmishëm dhe të pavarur, duke përdorur teknologjinë dhe mjete të tjera për të promovuar lirinë e medias, për t'i fuqizuar proceset demokratike dhe krijuar hapësira të shëndetshme informimi për debat publik të mirë informuar.

Për rekomandime më të hollësishme, shihni [Pjesën 8](#).

ANALIZË E THELLUAR





3. Hyrje

Ky kapitull shtjellon parimet kyçe ku mbështetet e drejta për liri të medias në kontekstin e ekonomisë së platformave bashkëkohore dhe shërben si hyrje në analizën e hollësishme të gjetjeve dhe rekomandimeve të paraqitura në Kreun I të këtij Manuali politikash.

Shtetet pjesëmarrëse në OSBE kanë deklaruar solemnisht se “të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë e drejtë e lindur e të gjitha qenieve njerëzore, janë të patjetërsueshme dhe garantohen me ligj”,⁵ dhe janë angazhuar që “të sigurojnë lirinë e medias si parakusht themelor për shoqëri pluraliste dhe demokratike”.⁶ Në Aktin final të Helsinkit të vitit 1975, ato u pajtuan që “të mundësojnë shpërndarjen më të lirë dhe më të gjerë të informacionit të të gjitha llojeve, të nxisin bashkëpunimin në fushën e informacionit dhe shkëmbimin e informacionit me shtetet tjera”.⁷ Duke riafirmuar rëndësinë e mediave të pavarura, qarkullimit të lirë të informacionit dhe së drejtës së publikut për qasje në informacion, shtetet pjesëmarrëse janë zotuar të ndërmarrin gjithë hapat e nevojshëm për të **siguruar kushtet bazë për media të lira dhe të pavarura**.⁸ Duke njohur se mediat e pavarura dhe pluraliste janë jetike për një shoqëri të lirë e të hapur dhe për sisteme qeverisjeje të përgjegjshme,⁹ shtetet pjesëmarrëse dalluan gjithashtu rreziqet e veçanta ndaj sigurisë së gazetarëve në epokën digjitale.¹⁰ Ato janë pajtuar të sigurojnë që personat të mund të zgjedhin lirshëm burimet e tyre të informacionit¹¹ dhe që **rrjeti të mbetet një forum i hapur dhe publik** për shprehje të lirë dhe mendim të lirë.¹²

5 Karta e Parisit për një Evropë të re (1990), <https://www.osce.org/mc/39516>

6 Dokumenti i Stambollit (1999), <https://www.osce.org/mc/39569>

7 Akti përfundimtar i Helsinkit (1975), <https://www.osce.org/helsinki-final-act>

8 Dokumenti i Stambollit (1999), <https://www.osce.org/mc/39569>

9 Dokumenti i Budapestit drejt një partneriteti të mirëfilltë në një epokë të re (1994), <https://www.osce.org/mc/39554>

10 Vendimi i Këshillit Ministror të OSBE-së Nr.3/18 mbi sigurinë e gazetarëve, MC.DEC/3/18, <https://www.osce.org/chairpersonship/406538>

11 Dokumenti përfundimtar nga takimi i tretë pasues, Dokumenti i Vjenës (1986), <https://www.osce.org/mc/40881>

12 Vendimi Nr.12/04 i Këshillit Ministror të OSBE-së mbi tolerancën dhe mos diskriminimin (2004), <https://www.osce.org/mc/23133>

Në këtë kontekst, **pluralizmi është gur themeli** jo vetëm i lirisë së medias, por edhe i vet shoqërive demokratike, ngaqë mundëson që një larmi idesh e perspektivash të mund të shprehen e të dëgohen. Diskursi publik i informuar, debati demokratik dhe fuqizimi i personave janë të mundshëm vetëm atëherë kur, brenda një hapësire të përbashkët informimi, bashkekzistojnë shumëllojshmëri zërash dhe interesash. Kur ekosistemi i informacionit dominohet, apo edhe kontrollohet, qoftë nga shteti apo nga monopole private, pluralizmi bëhet i pamundur.

Liria e medias varet nga pavarësia, pluralizmi dhe qëndrueshmëria e mediave të lajmeve. Kjo pavarësi po vihet gjithnjë e më shumë në rrezik nga varësitë e thella që janë krijuar në ekosistemin bashkëkohor të informacionit, e që po shpërfaqen në forma të shumta dhe të ndërthurura. Për t'u parë ose për t'u dëgjuar, aktorët mediatik detyrohen të operojnë brenda kornizave të politikave të platformave digjitale, mjedise këto shpesh të paqarta e të udhëhequra nga algoritmet ku vëmendja është shndërruar në kriter kryesor të dallimit, ndërkohë që interesit publik, saktësisë dhe larmisë i kushtohet pak, në mos aspak, vëmendje. Ngjashëm, edhe rrjedhat e të ardhurave janë të përqendruara në duart e kompanive të mëdha të teknologjisë, ngaqë të ardhurat nga reklamat kanalizohen përmes ndërmjetësve që nxjerrin përfitime jo-proporcionale nga përmbajtja e mediave të lajmeve që shpërndahe përmes shërbimeve të tyre, si dhe fakti se përmbajtja gazetareske shfrytëzohet për trajnimin e sistemeve të IA, pa pëlqim ose pa kompensim. Aftësia e gazetarëve për ta bërë punën në mënyrë të sigurt, të lirë nga dhuna në rrjet dhe paragjykimet sistemike, varet në masë të madhe nga sistemet e administrimit së përmbajtjes, të cilat rezultojnë shpesh të jenë të paqëndrueshme, të pamjaftueshme ose të mangëta. Këto dinamika nuk janë të rastësishme, por simptomë e një mjedisi informativ që formësohet dhe arbitrohet nga një numër i vogël kompanish botërore të teknologjisë. Në këtë kontekst, të drejtat e njeriut, vlerat demokratike dhe interesi publik kalojnë në plan të dytë përballë fitimeve, interesave private dhe ndikimit politik.

Termi **“kapje nga platformat”** përdoret për ta përshkruar varësinë e mediave nga oligopolet e mëdha teknologjike për të arritur te audienca e tyre, për të prodhuar të ardhura nga reklamat, për ta shpërndarë përmbajtjen, për infrastrukturë dhe për siguri.¹³

13 E. Nechushtai, “A mund t’i kapin platformat digjitale mediat përmes infrastrukturës?” Tek *Journalism*, Vëll. 19, Nr.8 (2018), fq.1043-1058, <https://journals.sagepub.com/doi/abs/10.1177/1464884917725163> and F.M. Simon, “Bashkudhëtare të përhershme: IA në lajme, kompanitë e platformave dhe çështja e autonomisë gazetareske.” Tek *Digital Journalism*, Vëll. 10, Nr.10 (2022), fq.1832-1854, <https://doi.org/10.1080/21670811.2022.2063150>

Ky Manual Politikash përdor termin “platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë” për të tërhequr vëmendjen te një grup kompanish të mëdha dhe me ndikim në sektorin e teknologjisë, kryesisht rrjete sociale dhe motorë kërkimi, e gjithnjë e më shpesh edhe kompani të IA, që dominojnë ekosistemin tonë botëror të informacionit dhe komunikimit. Këto kompani dominuese të teknologjisë konsiderohen “të mëdha” jo vetëm në kuptimin e përmasave të tyre, por edhe të pushtetit të tyre sistemik mbi prodhimin, shpërndarjen dhe vlerësimin financiar të informacionit, që i thellon *de facto* varësitë strukturore të të gjithë krijuesve të përmbajtjes, përfshirë mediat.

Implikimet e këtyre dinamikave janë vërejtur në **nivel botëror në kontekst të zgjedhjeve, fatkeqësive natyrore, konflikteve të armatosura, emergjencave të shëndetit publik dhe krizave të tjera**. Kapja gjithnjë e më shumë e pushtetit korporativ të këtyre aktorëve nga kontrolli demokratik ka bërë që viteve të fundit hapësirat e informimit në rrjet të shndërrohen në mënyrë të përsëritur në arena të luftës informative dhe përplasjesh politike, ku pushteti shtetëror dhe IA i platformave përplasen, e me raste dhe përforcojnë njëri-tjetrin, në dëm të pluralizmit dhe integritetit të diskursit publik. Ekosistemi i informacionit është aq i komprometuar në aspektin strukturor, sa që shumë prej sfidave aktuale nuk mund të adresohen më me kornizat ekzistuese. Thirrjet dhe ndërhyrjet e mëparshme me politika për t’i “sanuar” sfidat e shkaktuara nga shpërndarja e informacionit përmes platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë kanë qenë kryesisht të pasuksesshme. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se duhet larguar fokusin rregullator nga platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë, por se çdo përpjekje serioze për ta rikthyer lirinë e medias dhe për ta forcuar qëndresën demokratike duhet të ketë si pikënisje ballafaqimin me dinamikën e rrënjësive të pushtetit dhe tendencat monopoliste, në mënyrë që të **rindërtohet një ekosistem informativ ku zërat pluralistë dhe gazetaria e pavarur mund të lulëzojnë**, dhe ku **qasja e informacionit me interes publik** garantohej.

Ky Manual Politikash u ofron shteteve udhëzime mbi mënyrat e mbrojtjes së lirisë së medias në këtë epokë të kompanive të mëdha të teknologjisë, përqendrimit të pushtetit dhe IA.



INFORMATION

INFORMATION

INFORMATION

INFORMATION

INFORMATION

INFORMATION

INFORMATION

INFORMATION

4. Hapësirat e Kapura të Informimit në Rrjet

Kjo pjesë i përvijon sfidat kryesore me të cilat përballen gazetaria dhe liria e medias në ekosistemin digjital të informimit, i dominuar nga platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë që formojnë mënyrën e prodhimit, renditjes, shpërndarjes dhe të ardhurave të informacionit. Ajo shqyrton varësitë e mediave, përqendrimin e pushtetit, kontrollin mbi infrastrukturën dhe përhapjen e IA prodhuese.

4.1 Përqendrimi i pushtetit në ekosistemin bashkëkohor të informimit në rrjet

Në dy dekadat e fundit platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë kanë fituar, e me raste dhe u është dhënë, **kontroll mbi infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për pjesëmarrjen në debatin publik** dhe, rrjedhimisht, mbi vetë ekosistemin e informacionit. Ky pozicionim qendror nuk ndodhi brenda natës, por u mundësua dhe u përforcua nga **vendime të mëhershme rregulluese**, siç janë kornizat e përgjegjësisë së kufizuar që lehtësuan përmirësimin për shkallë dhe shtrirje, si dhe nga mungesa e përgjithshme e rregullimit për dekada të tëra. Këto zhvillime u ndikuan pjesërisht edhe nga perceptimi se autoritetet kishin kompetencë të kufizuar zbatimi në raport me korporatat shumëkombëshe. Pozita dominuese e platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë u forcua më tej nga **vendimet strategjike të organizatave mediatike** për t'u mbështetur në mekanizma të jashtëm shpërndarjeje, nga mungesa e investimeve të qeverive në infrastrukturë të informacionit në shërbim të interesit publik, si dhe preferencat e përdoruesve për të kaluar gjithnjë e më shumë kohë në këto platforma në rrjet.¹⁴

¹⁴ Një sërë studimesh dëshmojnë se rrjetet sociale janë skicuar për të shkaktuar varësi. Për përmbledhje të këtyre studimeve, shihni <https://petrieflom.law.harvard.edu/2024/10/14/addictive-design-and-social-media-legal-opinions-and-research-roundup/>.

Si rezultat, një grusht kompanish private janë shndërruar në **arbitra botërorë të fjalës së lirë**. Ky realitet manifestohet në mënyra të ndryshme, përfshirë ndikimin në rritje të platformave në shpërndarjen e lajmeve, aftësinë e tyre për të prodhuar të ardhura nga lajmet dhe rolin e tyre në formësimin e marrëdhënies ndërmjet mediave dhe audiencës. Ndërkohë që **funksioni demokratik i mediave në shoqëri është të lehtësojnë pjesëmarrjen publike dhe politike** përmes ofrimit të informacionit të besueshëm dhe të verifikuar, sot **oligopolet e rrjeteve sociale dhe motorëve të kërkimit kanë marrë rolin e filtruesve dominues** të informacionit. Duke analizuar mënyrën e qasjes së njerëzve anembanë globit në informacion¹⁵, *Raporti mbi lajmet digjitale* i Reuters për vitin 2025 evidenton se rrjetet sociale përbëjnë portën kryesore të qasjes në lajme në rrjet për më shumë se një të tretën e të anketuarve, vijuar nga motorët e kërkimit, ndërkohë që përdorimi i platformave dhe *chatbot* të IA është në rritje.¹⁶

Kontrolli mbi dallimin

Platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë caktojnë rregullat për llojin e përmbajtjes (lajmeve) që qasjet në shërbimet e tyre përmes kushteve të shërbimit, politikave për përdoruesit dhe Skicat algoritmik. Këto norma pësojnë ndryshime të vazhdueshme, ndërsa zbatimi i tyre është shpeshherë jo i qëndrueshëm dhe kryesisht jo-transparent.¹⁷ Qeverisja e përmbajtjes nga platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë dirigjon disponueshmërinë e informacionit, qasjen në përmbajtje në interes publik dhe administrimin e informacionit përtej kufijve shtetërorë.¹⁸

¹⁵ Për hollësi të mëtejshme, shihni N. Newman dhe të tjerë, *Raport i Institutit Reuters mbi lajmet digjitale 2025*. Institutit Reuters për Studimin e Gazetarisë (2025), https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/sites/default/files/2025-06/Digital_News-Report_2025.pdf.

¹⁶ N. Newman dhe të tjerë, *Raport i Institutit Reuters mbi lajmet digjitale 2024*. Institutit Reuters për Studimin e Gazetarisë (2024), https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/sites/default/files/2024-06/RISJ_DNR_2024_Digital_v10_lr.pdf. Raporti evidenton format në vijim të qasjes në lajme: 29% e të anketuarve qasën në lajme përmes rrjeteve sociale, 25% përmes kërkimit, 22% përmes qasjes direkte në faqet e rrjetit/aplikacioneve dhe 8% përmes agregateve.

¹⁷ R. Gorwa, R. Binns, dhe C. Katzenbach, "Moderimi algoritmik i përmbajtjes: Sfidat teknike dhe politike në automatizimin e qeverisjes së platformave." Tek *Big Data & Society*, Vëll.7, Nr.1 (2020), <https://journals.sagepub.com/doi/10.1177/2053951719897945>.

¹⁸ Gjykatat kanë hedhur poshtë argumentin e kompanive të mëdha të teknologjisë se ato janë thjesht platforma neutrale. Shihni, për shembull, GJDBE, 13 maj 2014, Google Spain SL dhe Google Inc. kundër Agencia Española de Protección de Datos (AEPD) dhe Mario Costeja Gonzalez, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:62012CJ0131>.

Përmbajtja që nuk është në pajtim me rregullat e brendshme të platformave ndaj moderohet, pavarësisht faktit se është e ligjshme sipas standardeve ndërkombëtare¹⁹ apo u është nënshtruar proceseve rigorozë redaktuese të vetë mediave. Si pasojë, përmbajtje të caktuara mund të largohen, të ulen në renditje, të mos vlerësohen ose të rezultojnë me pezullimin e llogarive përkatëse. Shpeshherë, vendimet për moderim të përmbajtjes zbatohen në mënyrë arbitrare ose shënjestrojnë zëra kritikë. Për shembull, pas blerjes së *Twitter* (tani X) në vitin 2022, u pezulluan llogaritë e disa gazetarëve që kishin postuar ose shpërndarë lidhje drejt artikujve mbi përdorimin e avionit privat nga pronari i platformës.²⁰ Sipas një sinjalizuesi të brendshëm, kompania *Meta* ka mbyllur llogari të disidentëve në *Facebook* nën presionin e qeverisë kineze.²¹ Për më tepër, përdorimi i veglave të automatizuara për të marrë vendime për moderim të përmbajtjes rezulton shpesh me shkallë të lartë gabimesh, që prekin në mënyrë joproporcionale persona dhe grupe të marginalizuara.²²

Modelet aktuale të biznesit të platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë favorizojnë shfaqjen e përmbajtjes sa më angazhuese me qëllim përmirësimin e të ardhurave nga reklamat, edhe kur kjo bie ndesh me interesin publik, dhe prirjen ta moderojnë vetëm përmbajtjen që ua dëmton markën.²³ Problematikë edhe më e theksuar se moderimi i përmbajtjes janë mënyrat jo-transparente dhe vazhdimisht të ndryshueshme të kurimit dhe rekomandimit të përmbajtjes nga platformat. Për shembull, *Meta* kishte njoftuar se do ta rriste renditjen e përmbajtjes nga miqtë dhe familjarët në

19 Në vitin 2018, Raportuesi i Posaçëm i OKB-së mbi Promovimin dhe Mbrojtjen e së drejtës së Lirisë së Mendimit dhe Shprehjes theksoi se kompanitë duhet ta marrin në konsideratë ligjin e të drejtave të njeriut dhe jo interesat e tyre private ose ligjet e tjera kombëtare si standard autoritar global për sigurimin e lirisë së shprehjes në platformat e tyre, shihni A/HRC/38/35, <https://docs.un.org/en/A/HRC/38/35>.

20 Shihni përmbledhjen e shembujve dhe analizën e përgjigjeve të gazetarëve, A. Claesson, "Twitter: E keqe e domosdoshme?" Tek *Journalism*, Vëll.25, Nr.12 (2023), fq.2604-2621, <https://doi.org/10.1177/14648849231221616>.

21 The Washington Post, "Meta e Zuckerbergut ka shqyrtuar ndarjen e të dhënave të përdorura me Kinën, pretendon sinjalizuesi" (9 mars 2025), <https://www.washingtonpost.com/technology/2025/03/09/meta-china-censorship-facebook-mark-zuckerberg>

22 Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, *Fokus mbi inteligjencën artificiale dhe lirinë e shprehjes - Manual politikash*. (2021), https://www.osce.org/files/f/documents/8/f/510332_1.pdf

23 Të Drejtat Digjitale Evropiane, *Shënjestrimi në rrjet: Një industri e thyer nga Skica dhe paracaktimet*. (2021), <https://edri.org/wp-content/uploads/2021/03/Targeted-online-An-industry-broken-by-design-and-by-default.pdf>

raport me lajmet, por hoqi dorë nga këto ndryshime në fillim të vitit 2025.²⁴ *Telegram*, si shembull ndryshe, është kritikuar për promovim sistematik të përmbajtjes ekstremiste dhe për mosveprim kundrejt materialeve të kundërligjshme,²⁵ megjithatë nën presionin e agjencive të zbatimit të ligjit i ka rishikuar praktikat e renditjes së përmbajtjes. Në përgjithësi, si politikatat e platformave ashtu edhe gjetjet e hulumtimeve sugjerojnë se **platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë e rendisin përmbajtjen kryesisht mbi bazën e angazhimit**, duke e baras vlerësuar nocionin e “angazhimit” me atë të “duhur”.²⁶ Në praktikë, “renditja” duhet kuptuar si përmbajtje që u përgjigjet interesave të atypëratyshme të përdoruesve, dhe matet përmes asaj çfarë përdoruesit klikojnë, sa kohë kalojnë duke e parë përmbajtjen, çfarë “pëlqejnë” ose shpërndajnë, vlerësim ky që shpesh është i paqartë dhe pa llogaridhënie publike. Vetë përdoruesit kanë zakonisht shumë pak mundësi për të ndikuar në rekomandimin e përmbajtjes, përtej pëlqimit ose shpërndarjes së saj, ose çaktivizimit të plotë të rekomandimeve të personalizuara.²⁷

Përrjashtimet e tjera të gjera nga përgjegjësia ligjore, ndonëse fillimisht mund të kenë qenë të justifikuara në një periudhë kur platformat ofronin kryesisht infrastrukturë dhe nuk ushtronin kontroll kaq të madh mbi përmbajtjen, kanë kontribuar në zhvillimin e

24 J. Hendrix, “Transkriptë: Mark Zuckerberg paratajmëron ndryshime të mëdha në politikatat dhe operacionet e moderimit të përmbajtjes së Meta-s.” *Tech Policy Press* (7 janar 2025), <https://www.techpolicy.press/transcript-mark-zuckerberg-announces-major-changes-to-metas-content-moderation-policies-and-operations/>

25 Alliance4Europe dhe Science Feedback, “Të sanksionuara, por në lulëzim” (dhjetor 2024), <https://science.feedback.org/wp-content/uploads/2024/12/Sanctioned-but-Thriving-How-Online-Platforms-Fail-To-Address-the-Widespread-Presence-of-Entities-Under-EU-Sanctions.pdf> dhe Southern Poverty Law Center “Raport mbi kërcënimet digjitale: Rekomandimet toksike të Telegram e ushqejnë ekstremizmin” (dhjetor 2024), <https://www.splcenter.org/resources/hatewatch/telegram-toxic-recommendations-perpetuate-extremism>

26 Komisioni Evropian, Studim mbi pluralizmin dhe diversitetin e medias në rrjet: Raport përfundimtar. Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian (2022), <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/475bacb6-34a2-11ed-8b77-01aa75ed71a1/language-en>; K. Rozgonyi, “Llogaridhënia dhe qeverisja e platformave: Rasti i theksimit të duhur në rrjet të përmbajtjes së mediave të shërbimit publik”. Tek Rrjet Policy Review, Vëll. 12, Nr.4 (2023), fq.75, <https://policyreview.info/articles/analysis/accountability-and-platforms-governance-public-service-media>

27 Mundësia e çaktivizimit të rekomandimeve të personalizuara është detyrim i paraparë me Aktin e BE-së për shërbimet digjitale. Për informacion të mëtejshëm, shihni U. Reviglio dhe M. Fabbri, “*Navigimi i Aktit për shërbimet digjitale: Skenarë të transparencës dhe të kontrollit të përdoruesit mbi sistemet rekomanduese të PSHMO-ve*”. NORMALIZE '24: Seminari i dytë për hartimin normativ dhe vlerësimin e sistemeve të rekomandimit (18 tetor 2024), https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=5040307.

praktikave jo-transparente të moderimit të përmbajtjes, llogaridhënie të kufizuar, madje përfitime të mëdha financiare, ndërkohë që i kanë dekurajuar mediat me kontroll nga redaksia të investojnë në zhvillimin e infrastrukturave alternative të shpërndarjes sociale.

Kontrolli mbi të ardhurat

Fokusi i platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë **në rekomandimin e përmbajtjeve që nxisin angazhim përkthehet në përfitime të mëdha ekonomike për to**, pasi modeli i tyre i biznesit bazohet në reklama dhe angazhimi më i madh nënkupton më shumë të ardhura nga reklamata. Për më tepër, shumica e kornizave ligjore ekzistuese i lirojnë platformat nga përgjegjësia për lejimin, madje edhe për promovimin, e përmbajtjeve të kundërligjshme dhe të dëmshme në shërbimet e tyre, duke ulur motivimin e tyre për t'i dhënë përparësi përmbajtjes që respekton kodet e etikës profesionale në krahasim me përmbajtjen që maksimizon vëmendjen apo tërheq përdoruesit. Algoritmet që u japin përparësi informacioneve tronditëse ose sensacionaliste, pra viralitetit dhe vëmendjes afatshkurtër, në dëm të lajmeve dhe/ose informacionit cilësor që mund të nxisë debat publik të informuar, bien ndesh me interesin publik. Ky model biznesi i platformave, i përshkruar me raste edhe si “nxitje e zemërimit”, është kritikuar gjerësisht. Megjithatë, **është e rëndësishme të theksohet se në rrethana të caktuara, si për shembull gjatë zgjedhjeve ose krizave, platformat e ndryshojnë këtë qasje duke modifikuar matjen algoritmike për t'u dhënë më shumë peshë sinjaleve të “vlerës së lajmit”, cilësisë dhe autoritetit (shihni Pjesën 5.1), praktikë kjo që sjell në shprehje një pyetje kyçe: nëse platformat janë në gjendje të promovojnë përmbajtje në interes publik, përse nuk e bëjnë këtë më shpesh?**

Platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë janë shndërruar në **oligopole jashtëzakonisht të pasura** që ushtrojnë ndikim në proceset politike në mbarë globin. Krahas lobimit për vendime në favor të tyre, disa prej drejtuesve të këtyre kompanive kanë ndërhyrë edhe në zgjedhje dhe debate anëmbanë botës, madje kanë përshtatur procedurat e moderimit dhe rekomandimit të përmbajtjes së platformave sipas vullnetit të tyre individual, veçanërisht pas zgjedhjeve të caktuara. Rreziku që ky pushtet të përdoret për qëllime politike, qoftë për

hakmarrje ndaj organizatave të caktuara mediatike, qoftë për ndërhyrje në procese demokratike duke favorizuar këndvështrime apo tema të caktuara, i thellon më tej shqetësimet ekzistuese. Studiuesit kanë paralajmëruar prej kohësh për rrezikun që paraqesin këto **“përqendrimet të pushtetit mbi opinionin”**, edhe në rrethanat kur ky pushtet nuk ushtrohet drejtpërdrejt²⁸, dhe zhvillimet politike të fundit tregojnë se këto paralajmërimet janë larg të qenit thjesht hipotetike.

28 N. Helberger, “Fuqia politike e platformave: Si përpjekjet aktuale për ta rregulluar dezinformimin po e fuqizojnë pushtetin mbi opinionin.” Tek *Digital Journalism*, Vëll 8, Nr.6 (2020), fq.842-854, <https://doi.org/10.1080/21670811.2020.1773888> dhe T. Seipp, “Ligji mbi përqendrimin e medias: Boshllëqe dhe premtime në epokën digjitale.” Tek *A Datafied Society: Data Power, Infrastructures, and Regulations*, Vëll.11, Nr.2 (2023), <https://www.cogitatiopress.com/mediaandcommunication/article/view/6393>

4.2 Sfidat ndaj lirisë së medias: Rreziqet e përqendrimit të pushtetit

Gjatë dekadës së fundit mediat kanë krijuar varësi nga **platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë** për të arritur te audiencat dhe për të ndërvepruar me to.²⁹ **Përqendrimi i pushtetit mbi tregun dhe opinionin publik** në duart e një numri të kufizuar aktorësh që kontrollojnë infrastrukturën kyçe të hapësirave bashkëkohore të informimit paraqet rreziqe serioze për lirinë e medias, lirinë e shprehjes dhe qasjen e publikut në informacion të besueshëm.

Çështje kyçe që lidhen me përqendrimin e pushtetit

Kontrolli që platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë ushtrojnë mbi hapësirat e informimit u mundëson të largojnë përmbajtje të gazetareve dhe organizatave mediatike

Moderimi i përmbajtjes ngërthen rreziqe të veçanta kur, me anë të veglave jo-transparente të IA, kufizohet **përmbajtja e ligjshme**, qoftë qëllimisht, qoftë sepse këto vegla nuk arrijnë të bëjnë dallimin mes përmbajtjes së ligjshme dhe asaj të kundërligjshme.³⁰ Shembuj konkretë përbëjnë rastet kur platformat moderojnë përmbajtje mediatike që është në interes publik, është e ligjshme dhe që ka kaluar tashmë nëpër

29 J. Meese dhe E. Hurcombe, "Facebook, mediat e lajmeve dhe varësia nga platformat: Ndikimet institucionale të shpërndarjes së lajmeve në platforma sociale." tek *News Media & Society*, Vëll.23, Nr.8 (2021), fq.2367-2384, <https://journals.sagepub.com/doi/full/10.1177/1461444820926472>

30 Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, *Fokus mbi inteligjencën artificiale dhe lirinë e shprehjes - Manual Politikash*. (2021)

procese rigorozë redaktimi e verifikimi sipas standardeve profesionale të gazetarisë - si rasti kur platforma të rrjeteve sociale larguan postime të BBC-së me pamje që dokumentonin sulme ndaj civilëve në Ukrainë.³¹ Në raste të tjera, platformat kanë larguar përmbajtje të mediave lokale për shkak të mungesës së burimeve gjuhësore, ose si pasojë e fokusit përzgjedhës te disa kontekste në dëm të të tjerave.³² Ndonëse, në përgjithësi, sasia e përmbajtjes që platformat largojnë është relativisht e vogël, vetë fakti që ato mund të largojnë ose mos vlerësojnë me të ardhura lloje të caktuara përmbajtjeje mund të shpie në **vetë censurë** dhe të ndikojë në mënyrën si gazetarët e prodhojnë ose shpërndajnë informacion në interes publik.³³

Përmbajtjes angazhuese i jepet më shumë përparësi se cilësisë dhe larmisë

Ndërkohë që studimet tregojnë se droja nga fluskat e filtrimit dhe dhomat e jehonës, që konsiderohen se e reduktojnë larminë, është mbas gjase e ekzagjeruar,³⁴ **problemi kryesor vazhdon të jetë mungesa e qasjes në gazetari dhe lajme në interes publik.** Mediat lokale përballen me vështirësi edhe më të theksuara, meqë algoritmet e rekomandimit mund të kenë **efekt homogjen** dhe të priren të promovojnë vetëm disa media më të mëdha kombëtare.³⁵

31 J. Goodman dhe M. Korenyuk, "IA: Dëshmitë për krime lufte po fshihen nga platformat e rrjeteve sociale." *BBC* (1 qershor 2023), <https://www.bbc.com/news/technology-65755517>

32 Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, *Luftimi i keqinformimit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut*. A/77/287 (Gusht 2022), par. 53, <https://docs.un.org/en/A/77/287>; S. Balendra, "Moderimi i IA nga Meta dhe liria e fjalës: Sfida e vazhdueshme në Jugun Global." *Tek Cambridge Forum on AI: Law and Governance*, Vëll. 1, Nr.21 (Maj 2025), fq.1-19, <https://www.cambridge.org/core/services/aop-cambridge-core/content/view/2DB952F896DB5744A43CD3E6C1A6DCB4/S3033373325000055a.pdf/metas-AI-moderation-and-free-speech-ongoing-challenges-in-the-global-south.pdf>

33 T. Dodds dhe të tjerë, "Metrika të nxitura nga popullariteti: Analiza e audiencës dhe zhvendosi e fuqisë së ndikimit të opinionit drejt platformave digjitale." *Tek Journalism Studies*, Vëll.24, Nr.3 (2023), fq.403-421, <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/1461670X.2023.2167104>

34 A. Ross Arguedas dhe të tjerë, Dhomat e jehonës, fluskat e filtrimit dhe polarizimi: *Shqyrtim i literaturës*. Instituti Reuters për Studimin e Gazetarisë(2022), <https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/echo-chambers-filter-bubbles-and-polarisation-literature-review>; Shihni edhe Ofcom, *Raport mbi studimin cilësor të lajmeve në rrjet*. (8 dhjetor 2023), <https://www.ofcom.org.uk/siteassets/resources/documents/research-and-data/multi-sector/media-plurality/2024/annex-3-online-news-qual-research.pdf?v=356800>.

35 B. Toff dhe N. Mathews, "A po i vrasin rrjetet sociale mediat lokale? Shqyrtim i modeleve të angazhimit dhe pronësisë në lajmet komunitare në SHBA NË Facebook." *Tek Digital Journalism*, Vëll. 12, Nr.9 (Tetor 2024), fq.1397-1416, <https://doi.org/10.1080/21670811.2021.197766>; E. Nechushtai dhe të tjerë, "E njëjta gjë, sërish? Homogjenizimi në rekomandimet e lajmeve kur përdoruesit kërkojnë në Google, YouTube, Facebook, dhe Twitter." *Tek Mass Communication and Society*, Vëll.27, Nr.6 (Nëntor 2024), fq.1309-1335, <https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/15205436.2023.2173609>

Këto ndikime janë edhe më të shprehura në shtetet e vogla dhe jo-anglofone. Studime tjera shpalosin se ndryshimet algoritmike në sistemin e *News Feed* të *Facebook* gjatë një dekade kanë rezultuar në ulje të angazhimit të përdoruesve me “lajmet serioze” (p.sh. politikë ose lajme botërore), ndikim që nuk është vërejtur në të njëjtën masë te angazhimi me “lajmet e lehta” (p.sh. stil jete dhe sport).³⁶ Si pasojë, burime të caktuara të lajmeve serioze që prodhojnë më shumë angazhim mund të renditen, ndërsa të tjerat të vendosen në plan të dytë, ose disa opinione dhe burime të caktuara informacioni të favorizohen në dëm të të tjerave. Një studim simulues i realizuar së fundmi shpalosë se *TikTok* rekomandon shumë pak lajme, pavarësisht se përdoruesit shprehin interes për to. Ngjashëm, edhe platformat më të vogla si *Vkontakte* (*VK*, platforma më e përdorur e rrjeteve sociale në Federatën Ruse) i japin përparësi përmbajtjes argëtuese në dëm të lajmeve.³⁷ Qasja në lajme në *Facebook* ka shënuar rënie si pasojë e ndryshimeve algoritmike që kishin për synim mos renditjen e tyre.³⁸ Fakti që ndryshimet algoritmike mund t’i bëjnë lajmet më pak të dukshme bën që pozita e mediave në platforma të jetë e pasigurt.³⁹ Për më tepër, **renditja algoritmike e përmbajtjes angazhuese** mund të ndikojë edhe në vetë praktikat e raportimit të mediave: në studiot e lajmeve shfaqen shpesh ekrane të mëdha ku paraqiten lajmet që tërheqin më shumë vëmendje, të vlerësuara ose sipas sistemeve të matjes së audiencës që ofrojnë platformat, ose në bazë të të dhënave që platformat ua vënë në dispozicion mediave. Informacione të tilla

36 N. McNally dhe M. Bastos, “Seksioni i lajmeve nuk është kuti e zezë: Studim longitudinal i trajtimit algoritmik të lajmeve nga Facebook.” Tek *Digital Journalism*, Vëll.0, Nr.0 (p.d.), fq.1-20, <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/21670811.2025.2450623>

37 J. Kling dhe të tjerë, “2024), “Argëtim i ndërthurur me propagandë: si llogaritë jashtë mediave tradicionale shpërndajnë përmbajtje haptazi politike te audiencia masive në rrjetin social më të përdorur të Rusisë.” Tek *Information, Communication & Society*, 28(7), 1252-1269, <https://doi.org/10.1080/1369118X.2024.2420029> dhe A. Urman, “Konsumi i lajmeve te përdoruesit rusë të *Vkontakte*: polarizimi dhe shmangia e lajmeve.” (2019) tek *International Journal of Communication*, <https://ijoc.org/index.php/ijoc/article/view/11161>

38 N. Hagar dhe N. Diakopoulos, “Indiferenca algoritmike: Vdekja e rekomandimeve të lajmeve në *TikTok*.” Tek *New Media & Society*, Vëll.27, Nr.6 (gusht 2023) <http://dx.doi.org/10.1177/14614448231192964>;

N. Newman dhe të tjerë, Raport mbi lajmet digjitale i *Reuters Institute* 2024. Instituti Reuters për Studimin e Gazetarisë (2024), fq.21.

39 A. Cornia dhe të tjerë, “Lajmet e sektorit privat, shpërndarja përmes rrjeteve sociale dhe ndryshimet algoritmike.” Instituti Reuters për Studimin e Gazetarisë (2018), <https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/our-research/private-sector-news-social-media-distribution-and-algorithm-change>; J. Meese dhe E. Hurcombe, “Facebook, mediat e lajmeve dhe varësia nga platformat: Ndikimet institucionale të shpërndarjes së lajmeve në platforma sociale.” Tek *News Media & Society*, Vëll.23, Nr.8 (2021), fq.2367-2384.

ndikojnë në ecurinë e punës gazetareske dhe në vendimmarrjen nëpër redaksi, meqë mund të kenë efektin e favorizimit të përmbajtjes së orientuar drejt klikimeve në dëm të cilësisë.⁴⁰ Për ta ndërlikuar edhe më tej situatën, studimet sugjerojnë se, në disa kontekste, algoritmet e rrjeteve sociale kanë promovuar dhe renditur media pro-qeveritare në kurriz të lajmeve të pavarura dhe të larmishme, edhe atëherë kur përmbajtja e mediave të pavarura ka prodhuar më shumë angazhim.⁴¹ Në mjedise mediatike më kufizuese dhe në kontekste të filtrimit dhe bllokimit të rrjetit të imponuar nga shteti, si platformat botërore ashtu edhe ato lokale janë përdorur për të censuruar përmbajtje gazetareske ose për të cenuar sigurinë e gazetarëve. Si shembull ilustrues, *Yandex*⁴² dhe *Baidu*⁴³ operojnë nën ndikim të gjerë shtetëror, gjë që ngre shqetësime serioze lidhur me garantimin e të drejtave të njeriut.⁴⁴

Dominimi nga oligopolet i tregut të reklamimit dhe vlerësimit të përmbajtjes

Platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë kanë fituar **kontroll mbi tregun e reklamave**, veçanërisht reklamimin programor (blerje dhe shitje e automatizuar e hapësirës reklamuese), me raste edhe në mënyra të kundërligjshme.⁴⁵ Pozicionimi i tyre si ndërmjetës, si ndërmjet mediave dhe audiencave të tyre, ashtu dhe ndërmjet mediave dhe reklamuesve, ka rezultuar në tkurrje të burimeve tradicionale të të ardhurave për mediat dhe, si rrjedhim, ulje të investimeve në gazetari

40 T. Dodds dhe të tjerë, “Metrika të nxitura nga popullariteti: Analiza e audiencës dhe zhvendosi e fuqisë së ndikimit të opinionit drejt platformave digjitale.” Tek *Journalism Studies*, Vëll.24, Nr.3 (2023), fq.403–421, <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/1461670X.2023.2167104>

41 International Press Institute, “Rryma e re kryesore” është në rritje (dhe kërkon mbështetje). Raporti i IPI mbi median digjitale në Turqi (2021), <https://freeturkeyjournalists.ipi.media/wp-content/uploads/2021/03/ENG-IPI-Turkey-Digital-Media-Report-01032021-final-.pdf> dhe <https://www.duvarenglish.com/media/2020/02/21/google-news-initiative-chooses-to-fund-pro-govt-demiroren-media-group-in-turkey>

42 Yandex është motori kërkues më i përdorur në Rusi.

43 Baidu është motori kërkues më i përdorur në Kinë.

44 T. Lokot, “Autoritarizmi i rrjetëzuar i Rusisë në territoret e okupuara të Ukrainës gjatë pushtimit në shkallë të plotë: kontroll dhe qëndresë.” Tek *LSE Public Policy Review*, Vëll.3, Nr.1 (2023), fq.7, <https://ppr.lse.ac.uk/articles/10.31389/lseppr.85> dhe J. Knockel dhe të tjerë, *Vegëzat e pagjetura: Krahsim i censurës së kërkimit në Kinë*. Raport Nr.166 i Citizen Lab, 66, Universiteti i Torontos (2023), <https://citizenlab.ca/2023/04/a-comparison-of-search-censorship-in-china>

45 The New York Times, “Google theu ligjin për të mbajtur monopolin e reklamave, vendos një gjykatës” (17 prill 2025), <https://www.nytimes.com/2025/04/17/technology/google-ad-tech-antitrust-ruling.html>

dhe raportime të kushtueshme hulumtuese, veçanërisht për mediat e vogla, lokale dhe jofitimprurëse.⁴⁶ Ndonëse reklammat vazhdojnë të jenë burim kryesor i të ardhurave për mediat, në dy dekadat e fundit të ardhurat nga to kanë rënë për më se pesëdhjetë për qind.⁴⁷ Shembujt e fundit dëshmojnë se edhe **ndryshimet më të vogla algoritmike mund ta devijojnë trafikun** larg mediave të lajmeve në mënyra që rrezikojnë mbijetesën e tyre financiare, duke kontribuar më tej në përhapjen e dukurisë së ashtuquajtur të **“shkretëtirave të lajmeve”**.⁴⁸

Platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë u ofrojnë **botuesve të përmbajtjes mundësi për vlerësim financiar** të drejtpërdrejtë në platformë,⁴⁹ përmes abonimeve, këshillave dhe hapësirave të tregtimit për krijues, si dhe përmes programeve të rishpërndarjes së të ardhurave. Këto programe u japin botuesve të kualifikuar një përçindje të vogël të të ardhurave nga reklammat e prodhuara nga përmbajtja e tyre.⁵⁰ Megjithatë, kornizat ekzistuese të vlerësimit i ndëshkojnë në mënyrë jo proporcionale mediat **përmbajtja e të cilave shpesh etiketohet si “politike”**, ngaqë shumë platforma vendosin kufizime në vlerësimin financiar për përmbajtje që trajton çështje politike (përmes kufizimit të reklamimit politik) ose “çështje sociale të diskutueshme”.⁵¹ Pas hyrjes në fuqi të rregulloreve të reja në BE mbi transparencën dhe shenjëstrimin e reklamimit politik, *Meta* njoftoi në korrik 2025 se do ta ndalë krejtësisht reklamimin për çështje

46 B. Martens dhe të tjerë, “Transformimi digjital i mediave të lajmeve dhe rritja e keqinformimit dhe lajmeve të rreme.” Tek *Joint Research Centre Technical Reports*, Digital Economy Working Paper 2018-02 (20 prill 2018), https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3164170

47 Komisioni Evropian, Perspektiva e industrisë evropiane të mediave. Raport (maj 2023), <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/european-media-industry-outlook>

48 Bianet, “Portali i pavarur i lajmeve *Gazete Duvar* po mbyllet për shkak të vështirësive financiare” (12 mars 2025), <https://bianet.org/haber/independent-news-outlet-gazete-duvar-shutting-down-due-to-financial-difficulties-305365>

49 What to Fix, *Nga përmbajtja te pagesa: rritja dhe implikimet e ndarjes së të ardhurave nga reklammat me rrjetet sociale*. (Prill 2024), <https://www.whattofix.tech/publications/content-to-payment/>

50 What to Fix, *Raport i ri: Vlerësimi financiar i rrjeteve sociale 2025*. (Shkurt 2025), <https://www.whattofix.tech/publications/monetization2025/>

51 Për shembull, politikat e *Meta* për vlerësimin e përmbajtjes, kufizojnë vlerësimin e përmbajtjes që paraqet ose trajton “çështje sociale të diskutueshme”, si debatet mbi të drejtat personale, civile ose politike, si dhe përmbajtje që lidhen me tragjedi dhe konflikte. Për rrjedhojë, edhe raportimi për konfliktet është prekur nga këto politika. Shihni, *Meta*, Politikat e vlerësimit të përmbajtjes, <https://www.facebook.com/business/help/1348682518563619?id=2520940424820218>. Ngjashëm, politikat e vlerësimit të *Google Ads* përjashtojnë tema të caktuara, si përmbajtje politike dhe përmbajtje të klasifikuar si e ndjeshme apo e lidhur me ngjarje të fundit, kur trajtohen çështje potencialisht kontraverse. Këto qasje shkojnë përtej kufizimeve të reklamimit politik që njihen nga sektori i transmetuesve të licencuar.

politike, zgjedhore dhe sociale në BE, duke i ndjekur hapat e *Google*.⁵²

Meta dhe *Google* u kanë ofruar organizatave mediatike **marrëveshje të veçanta**, përmes nismave si *Google News Showcase*⁵³ (në suazat e së cilës raportohet të jenë lidhur mbi 2.800 marrëveshje me botues në 31 shtete), *Meta's News Pages* dhe skemave të regjistrimit të gazetarëve, për t'u kualifikuar për përjashtime nga kufizimet e vlerësimit të lajmeve.⁵⁴ Mirëpo, këto marrëveshje ndryshojnë ndjeshëm nga një rajon në tjetrin dhe karakterizohen me mungesë të theksuar transparence. **Nuk ka të dhëna publike** se cilët botues janë bërë pjesë e këtyre nismave, çfarë kushtesh u janë ofruar dhe çfarë ndikimi kanë marrëveshjet e tilla te mediat, veçanërisht ato të vogla dhe lokale.⁵⁵ Në kuadër të këtyre marrëveshjeve të vlerësimit, gazetarëve dhe mediave u kërkohet shpesh të nënshkruajnë **klauzola konfidencialiteti**.⁵⁶

Në disa raste, krijuesit dhe botuesit e përmbajtjes nuk e gëzojnë më autonominë për të vendosur nëse do ta vlerësojnë përmbajtjen e tyre në platforma, meqë platformat si *YouTube* i kanë atribuar vetes të ashtuquajturën **“të drejtë për vlerësim financiar”**, duke i riklasifikuar pagesat e rishpërndarjes së të ardhurave si **kompensime autoriale**.⁵⁷ Praktika të tilla u japin platformave kontroll edhe më të madh mbi llogaritjen dhe shpërndarjen e pagesave, pa asnjë formë mbikëqyrjeje

52 Rregullorja e BE-së për reklamimin politik parasheh përjashtime për përmbajtjen nga redaksia të pakompensuar ose të ngarkuar nga përdoruesit (nenet 1(2) dhe 3(5)). Për njoftimet e platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë, shihni *Meta*, “Dhënia fund reklamimit politik, zgjedhor dhe social si përgjigje ndaj rregullores evropiane që pritet të hyjë në fuqi.” (25 korrik 2025), <https://about.fb.com/news/2025/07/ending-political-electoral-and-social-issue-advertising-in-the-eu/> dhe *Google*, “Përditësim rreth reklamimit politik në Bashkimin Evropian.” (14 nëntor 2024), <https://blog.google/around-the-globe/google-europe/political-advertising-in-eu/>

53 *Google*, “News Showcase po nis në Kroaci.” <https://blog.google/around-the-globe/google-europe/news-showcase-is-launching-in-croatia/>

54 *Meta*, About News Page Index, <https://www.facebook.com/business/help/377680816096171?id=644465919618833>

55 C. Papaevangelou, “Ndërmjetësit e financimit: Strategjia e *Google* dhe *Facebook* për kapjen e gazetarisë.” Tek *Digital Journalism*, Vëll.12, Nr.2 (2023), fq.234-255, <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/21670811.2022.2155206>

56 *Meta*, Kushtet e vlerësimit të përmbajtjes, https://www.facebook.com/legal/content_monetization_terms

57 *Youtube*, Kushtet e përditësuar të shërbimit, pyetjet më shpeshta, <https://support.google.com/youtube/answer/10090902?hl=en#zippy=%2Cwhy-did-you-change-the-terms-of-service%2Cwhat-are-the-main-changes%2Cchow-will-this-affect-my-ypp-monetization%2Cdoes-this-have-to-do-with-the-european-union-copyright-directive-or-gdpr%2Cwhat-does-this-mean-for-my-privacy-or-data>

të pavarur, gjë që cenon autonominë e mediave dhe ka implikime tatimore të rëndësishme.⁵⁸ Aktualisht, nuk ka kërkesa rregulluese detyruese që përcaktojnë qartë mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave, ose kritere sipas të cilave duhet të vlerësohet dhe kompensohet vlera e përmbajtjes,⁵⁹ duke krijuar rrezikun që platformat të veprojnë kryesisht në interesin e tyre financiar, në dëm të një ekosistemi digjital të drejtë dhe pluralist.⁶⁰

Në të njëjtën kohë, platformat e kompanive mëdha të teknologjisë e vlerësojnë, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, përmbajtjen gazetareske që shpërndahet përmes shërbimeve të tyre. Vlera e përmbajtjes gazetareske për bizneset e platformave (e vlerësuar përmes metodologjive të ndryshme)⁶¹ është e konsiderueshme, ndonëse minimizohet nga përfaqësuesit e kompanive të mëdha të teknologjisë.⁶²

Infrastruktura, politika⁶³ dhe modelet e biznesit të platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë kanë ndikim negativ në sigurinë e gazetarëve

Renditja e përmbajtjes që prodhon angazhim jo vetëm që nënkupton më pak dallimin për lajmet e bazuara në fakte, por edhe amplifikim të **përmbajtjes sensacionale, polarizuese dhe emocionalisht të ngarkuar**. Si pasojë, përhapen forma të ndryshme të përmbajtjes diskriminuese, përfshirë përmbajtje raciste, seksiste, ksenofobike dhe homofobike, si dhe dhunë në rrjet dhe

⁵⁸ Pagesat e kompensimeve autoriale po lidhen gjithnjë e më shumë me matjet e shikueshmërisë, siç janë klikimet dhe reagimet, në vend se me statusin ligjor ose profesional të krijuesit të përmbajtjes.

⁵⁹ V. Rio, "Përtej përmbajtjes: Pse qeverisja e vlerësimit është prioriteti i radhës i politikave në fushën e teknologjisë." Tek *Tech Policy Press* (28 prill 2025), <https://www.techpolicy.press/beyond-content-why-monetization-governance-is-the-next-frontier-of-tech-policy/>

⁶⁰ J. Van Natta dhe të tjerë, "Analizë e ndikimeve të politikave për përmbajtjen të Youtube në gazetari dhe diskursin publik." Tek *ACM Digital Library Proceedings of the ACM on Human-Computer Interaction* Vëll.7, Nr.CSCW1 (2023), fq.1-28, <https://dl.acm.org/doi/10.1145/3579499>

⁶¹ Shihni, për shembull: P. Holder dhe të tjerë, *Pagesa për lajmet: Sa u detyrohen Google dhe Meta botuesve amerikanë*. (tetor, 2023). <https://s3.documentcloud.org/documents/24129986/paying-for-news.pdf>; News Media Alliance, *Google përfiton nga përmbajtja e lajmeve* (qershor 2019), <https://www.newsmediaalliance.org/wp-content/uploads/2019/06/Google-Benefit-from-News-Content.pdf>; A. Johann dhe të tjerë, *Vlera e përmbajtjes gazetareske për motorin e kërkimit të Google në Zvicër - Një qasje e ekonomisë së sjelljes mbi të drejtat autoriale të përafërta*, Consultancy Group Zurich (mars 2023), <https://fehradvice.com/insights/studien/value-of-news-study/>.

⁶² Geneva Rrjet Platform, "Një studim në SHBA konfirmon që kompanitë e mëdha të teknologjisë u kanë borxh miliarda të ardhura vjetore botuesve të lajmeve." *Dig Watch* (nëntor 2023), <https://dig.watch/updates/a-study-in-the-us-confirms-big-tech-owes-news-publishers-billions-in-annual-revenue>

⁶³ R. Gorwa, *Politika e rregullimit të platformave: Në ç'mënyrë qeveritë e formësojnë moderimin e përmbajtjes*. Oxford University Press(2024), <https://doi.org/10.1093/oso/9780197692851.001.0001>

përmbajtje që cenon reputacionin e gazetarëve dhe mediave të lajmeve. Parametrat e Skicat dhe funksionimit të platformave, që i japin përparësi maksimizimit të angazhimit dhe vëmendjes në vend se sigurisë, kanë mundësuar, përforcuar dhe përshpejtuar dhunën në rrjet.⁶⁴ Provat sugjerojnë se platformat e rrjeteve sociale përfitojnë nga ngacmimi në rrjet, meqë IA nxit angazhimin dhe për këtë arsye nuk kanë interes që të zbatojnë masa mbrojtëse efektive kundër dhunës në rrjet. Ato janë vlerësuar si të ngadalta edhe në zbatimin e veçorive bazike për adresimin e ngacmimit në rrjet.⁶⁵ Për rrjedhojë, **mbrojtja është e mangët ose mungon tërësisht**.⁶⁶ Një studim i vitit 2021 në kuadër të të cilit u analizuan politikat dhe praktikat e moderimit të përmbajtjes arriti në përfundimin se, pavarësisht pretendimeve për fokus në siguri, asnjëra nga platformat nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme.⁶⁷ Disa forma të dhunës në rrjet, si mbikëqyrja e fshehtë përmes programeve “spyware”,⁶⁸ fushatat e orkestruara të keqinformimit dhe shpifjes,⁶⁹ apo agresionet tejkombëtare të sponsorizuara nga shtetet⁷⁰ është e vështirë, në mos e pamundur, të adresohen përmes elementëve ekzistues të sigurisë. Sfidat janë veçanërisht të theksuara në situata konflikti, ku ekziston një ndërlidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet luftës digjitale dhe dhunës fizike.⁷¹

64 L. Slachmijlder dhe S. Bonilla, *Parandalimi i integruar në dizajn: Udhërrëfyes për luftimin e TFGBV në burim*. Council on Tech and Social Cohesion (mars 2025), <https://techandsocialcohesion.org/wp-content/uploads/2025/03/Prevention-by-Design-A-Roadmap-for-Tackling-TFGBV-at-the-Source.pdf>

65 V. Vilck dhe E. Vialle, *Nuk ka justifikim për keqpërdorim*. PEN American (2021), <https://pen.org/report/no-excuse-for-abuse/>; shihni edhe S. Dunn dhe të tjerë, *Mbështetja për hapësira digjitale më të sigurta*. Qendra për Risi në Qeverisje Ndërkombëtare (2023), fq.62, <https://www.cigionline.org/publications/supporting-safer-digital-spaces/>.

66 UNESCO, *Klima e frikësimit: Tendencat botërore të dhunës në rrjet ndaj gazetarëve*. Punim hulumtues për diskutim (2021), fq.8, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000377223>

67 Ultraviolet, *Rrjetet sociale po dështojnë në mbrojtjen e grave - transformimi i politikave të rrjeteve sociale për një të ardhme feministe*. (2021), <https://weareultraviolet.org/pressrel/new-report-card-grades-social-media-platforms-on-handling-of-harassment-hate-speech-misogyny-disinformation/>, shihni edhe: K. Wilfore, *Pako instrumentesh për qëndresë digjitale për gratë në politikë*. ShePersisted (2022), fq.12, <https://she-persisted.org/our-work/supporting-women-leaders/>.

68 Access Now, “NSO Group detyrohet t’i paguajë WhatsApp-it 168 milionë dollarë dëmshpërbim për hakimin me Pegasus” (6 maj 2025), <https://www.accessnow.org/press-release/whatsapp-v-nso-case-damages-decision/>

69 Shihni Observatori i narrativëve keqinformues kundër mediave, International Press Institute, <https://observatory.ipi.media/narratives/>.

70 N. Aljizawi dhe të tjerë, *Pa rrugëdalje: Instrumentalizimi i gjinisë për qëllime të represionit digjital transnacional*. Raport hulumtues, The Citizen Lab (dhjetor 2024), fq.3-6, <https://citizenlab.ca/wp-content/uploads/2024/12/Report180-noescape112924.pdf>

71 Access Now, “Armëpushimi në Gazë: Është koha që t’u jepet fund dëmeve digjitale dhe të vendoset drejtësia” (20 janar 2025), <https://www.accessnow.org/press-release/ceasefire-in-gaza-end-digital-harms-deliver-justice/>

Për më tepër, ndonëse gazetarët përballen me rrezikshmëri të shtuar për të qenë shënjestër e dhunës në rrjet, shumica e platformave nuk i diferencojnë nga përdoruesit e tjerë sa i përket veçorive të sigurisë apo veglave mbrojtëse,⁷² madje në disa raste gazetarët mund të klasifikohen si figura publike, çka e rrit pragun e ndërhyrjes në situata kur është e paqartë nëse përmbajtja përbën kritikë legjitime apo kalon në ngacmim.⁷³

Platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë mund të ushtrojnë presion infrastrukturor

Ndikimi mbi mediat nuk kufizohet vetëm te shpërndarja e lajmeve përmes rrjeteve sociale dhe motorëve të kërkimit, por shtrihet edhe te **infrastruktura teknologjike mbi të cilën mbështetet funksionimi i mediave**. Kjo infrastrukturë, shpeshherë e padukshme për publikun, është themeli mbi të cilin mediat zhvillojnë veprimtarinë, financojnë redaksitë dhe arrijnë te audienat. Përdorimi nga mediat i infrastrukturës teknologjike të ofruar nga palë të jashtme në vetvete nuk është domosdoshmërisht problematik, por është **varësia nga kjo infrastrukturë ajo çfarë i bën ato të cenueshme** ndaj presioneve ose rritjeve të çmimeve dhe u jep aktorëve të jashtëm kontroll mbi teknologjitë që përdoren për vendimmarrje nga redaksia.⁷⁴ Në të kaluarën, varësi të ngjashme kanë çuar në pabarazi që janë shfrytëzuar për t'i ekspozuar dobësitë ose janë keqpërdorur si pika presioni.⁷⁵ Për

⁷² Shihni, për shembull, X Help Center, <https://help.x.com/en/using-x/x-premium>, përveç për përdorues prioritarë.

⁷³ Statusi "figura publike të pavullnetshme" u krijua nga Meta në vitin 2021 me synimin për t'i rritur masat e sigurisë për personat që e gjejnë veten në qendër të vëmendjes publike për shkak të punës së tyre, e jo si rezultat i një zgjedhjeje të qëllimshme për t'u bërë figura publike. Kjo kategori mund të zbatohet edhe për gazetarët, shihni <https://about.fb.com/news/2021/10/advancing-online-bullying-harassment-policies>. Megjithatë, hulumtimet kanë treguar se etiketimi si "figurë publike" mund të rezultojë me prag më të lartë të ndërhyrjes për adresimin e abuzimit në rrjet, që do të thotë se gazetarët mund të përballen me mbrojtje më të ulët, ndonëse u ekspozohen niveleve më të lartë të dhunës në rrjet, shihni R. Cover dhe të tjerë, "Mbrojtja e figurave publike në rrjet: Si i përkufizojnë platformat dhe rregullatorët figurat publike?" *Media International Australia*, Vëll.196, Nr.1 (2025), fq.156-170, <https://doi.org/10.1177/1329878X231225745>.

⁷⁴ M. van Drunen, "Mbrojtja e lirisë së medias nga varësia infrastrukturorë ndaj kompanive të IA: Roli i së drejtës së BE." Tek *Telecommunications Policy* (korrik 2025), <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0308596125000874>

⁷⁵ L. Kristensen dhe J. Hartley, "Infrastruktura e lajmeve: Negocimi i kapjes dhe autonomisë infrastrukturorë në shpërndarjen e lajmeve të udhëhequr nga të dhënat." Tek *Media and Communication*, Vëll.11, Nr.2 (2023), fq.307-318, <https://doi.org/10.17645/mac.v11i2.6388> dhe E. Nechushtai, "A mund platformat digjitale t'i kapin mediat përmes infrastrukturës?" Tek *Journalism*, Vëll.19, Nr.8 (2017), fq.1043-1058, <https://doi.org/10.1177/1464884917725163>

më tepër, falë kontrollit mbi infrastrukturën informative, platformat mund të sigurojnë qasje në informacione të ndjeshme (si në rastin e mbikëqyrjes nga *TikTok* së lokacionit të një gazetareje përmes telefonit të saj⁷⁶), të ushtrojnë presion për të shmangur hulumtime të pavarura të praktikave të dëmshme, ose të kërcënojnë me ndërprerje të qasjes në burime apo financimit pas raportimeve me ton kritik.⁷⁷

Mbështetja te kompanitë dominuese të jashtme për ruajtje në infrastrukturë dhe shërbime kompjuterike “cloud” sjell rreziqe

Varësia infrastrukturore e mediave nga platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë shpesh mundësohet përmes programeve të partneritetit.⁷⁸ Ndonëse këto programe mund të ofrojnë zgjidhje të lehta dhe fleksibile për përdorimin e teknologjisë, **ruajtja e të dhënave në shërbime të jashtme sjell rreziqe për privatësinë, sigurinë dhe bllokimin e të dhënave.** Kontrolli që platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë ushtrojnë mbi infrastrukturën “cloud”, ku dhe i kanë të vendosura teknologjitë e tyre, u mundëson të ushtrojnë ndikim edhe mbi mënyrën se si këto teknologji dhe vegla dizajnohen që në fillim, duke orientuar kahun e risive në sektorin e medias.⁷⁹

76 H. Murphy, “TikTok pranon mbikëqyrjen e gazetares së Financial Times gjatë hetimit për rrjedhje të informacioneve.” *Financial Times* (22 dhjetor 2022), <https://www.ft.com/content/e873b98a-9623-45b3-b97c-444a2fde5874>

77 C. Criddle, “TikTok më ka spiunuar. Pse?” *Financial Times* (5 maj 2023), <https://www.ft.com/content/0c0f9670-2e3a-4af8-bcd5-85e314f6ac5e>. Për shembull, në vitin 2025 një gjykatë amerikane shqiptoi gjobë kundër Grupit NSO për përdorim të paligjshëm të infrastrukturës së WhatsApp në pronësi të Meta për t’i shënjestruar mijëra persona me programin e saj spiun Pegasus. Pegasus është përdorur për të infiltruar në pajisjet e shumë gazetarëve kritikë ndaj qeverive të tyre anembanë botës. Për informacion të mëtejshëm, shihni: <https://www.amnesty.org/en/latest/news/2025/05/ruling-against-nso-group-in-whatsapp-case-a-momentous-win/>.

78 F.van der Vlist dhe të tjerë, “Kompanitë e mëdha të IA: Varësia nga infrastruktura cloud dhe industrializimi i inteligjencës artificiale.” Tek *Big Data & Society*, Vëll.11, Nr.1 (2024), <https://doi.org/10.1177/20539517241232630>

79 Shihni ndër të tjera punën e Aleancës për Gazetari në Cloud, <https://gfmfd.info/cloud-alliance/>. Shihni edhe M. von Thun dhe C. Lavin, *Inxhinieringu i Cloud Commons: Plan për infrastrukturë digjitale të qëndrueshme, të sigurt dhe të hapur*. Open Markets Institute (maj 2025), <https://static1.squarespace.com/static/5e449c8c3ef68d752f3e70dc/t/6821f7382ff99f2baf2e8212/1747056440491/Engineering+the+Cloud+Commons+FINAL+2.pdf>; F.M. Simon, “Shpëto prej meje po munde: Si po e riformëson IA varësinë e organizatave të lajmeve nga kompanitë e platformave.” Tek *Digital Journalism*, Vëll.12, Nr.2 (nëntor 2023), fq.149-170, <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/21670811.2023.2287464>; C. Beckett dhe M. Yaseen, *Gjenerimi i ndryshimit: A Anketë botërore mbi atë çfarë po bëjnë organizatat e lajmeve me IA*. LSE Londër (2023), <https://www.journalismAI.info/research/2023-generating-change>; F.Wu dhe të tjerë, “MIND: Një grup i madh të dhënash për rekomandimin e lajmeve.” Tek *Punimet e takimit të 58-të vjetor të Shoqatës për Gjuhësi Kompjuterike* (2020), fq.3597-3606, <https://aclanthology.org/2020.acl-main.331/>

Kompanitë e mëdha të teknologjisë po fitojnë gjithnjë e më shumë kontroll mbi burimet e nevojshme për zhvillimin e teknologjive që përdoren nëpër studio lajmesh.

Ky kontroll mund të shfaqet në forma të ndryshme, si **ofrimi i seteve të të dhënave për Skicimin dhe kontrollin e rendimentit** të sistemeve të rekomandimit të lajmeve ose të modeleve bazë, apo **ofrimi i hulumtimeve** rreth krijimit të veglave të IA.⁸⁰ Kompanitë e mëdha të teknologjisë furnizojnë edhe teknologjitë mbi bazën e të cilave merren vendimet nëpër redaksi si, për shembull, vegla për identifikimin e tendencave, motorë rekomandimi (të lajmeve) dhe sisteme për matjen e audiencës. Kur këto **teknologji nuk janë transparente**, siç edhe ndodh shpesh, mediat nuk arrijnë ta kuptojnë se si veglat nga të cilat varen po e formojnë vendimmarrjen e tyre nëpër redaksi.⁸¹ Në disa raste, janë ngritur shqetësime se mbështetja financiare për programe risi mediatic nga kompanitë e mëdha të teknologjisë mund të prodhojë efekt të frenimit të raportimit kritik për to.⁸²

Për shkak të dinamikave të pushtetit dhe dominimit botëror të kompanive të mëdha të teknologjisë - me zanafillë kryesisht në një pjesë të caktuar të globit - **sfidat ndaj lirisë së medias janë edhe më të theksuara në rajonet me tregje më të vogla dhe me profil më të ulët gjeopolitik.**⁸³

80 F.M. Simon, "Shpëto prej meje po munde: Si po e riformëson IA varësinë e organizatave të lajmeve nga kompanitë e platformave." Tek *Digital Journalism*, Vëll.12, nr. 2 (nëntor 2023), fq.149-170; C. Beckett dhe M. Yaseen, *Gjenerimi i ndryshimit: A Anketë botërore mbi atë çfarë po bëjnë organizatat e lajmeve me IA*. (LSE Londër, 2023); F.Wu dhe të tjerë, "MIND: Një grup i madh të dhënash për rekomandimin e lajmeve." Tek *Punimet e takimit të 58-të vjetor të Shoqatës për Gjuhësi Kompjuterike* (2020), fq.3597-3606.

81 B. Jones dhe të tjerë, "IA kudo dhe askund: trajtimi i problemit të kuptueshmërisë së inteligjencës artificiale në gazetarinë publike." Tek *Digital Journalism*, Vëll.10, Nr.10 (2022), fq.1736, <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/21670811.2022.2145328>; F.M. Simon, "Shpëto prej meje po munde: Si po e riformëson IA varësinë e organizatave të lajmeve nga kompanitë e platformave." Tek *Digital Journalism*, Vëll.12, Nr.2 (nëntor 2023), fq.149-170; F.M. Simon, "Bashkëudhëtarë të paretshëm: IA në lajme, kompanitë e platformave dhe çështja e autonomisë gazetareske." Tek *Digital Journalism*, Vëll.10, Nr.10 (2022), fq.1843, <https://doi.org/10.1080/21670811.2022.2063150>

82 M. F.de Lima Santos dhe të tjerë, "Ndikimi i Google News Initiative në risiin teknologjik të mediave në Afrikë dhe Lindjen e Mesme." Tek *Media and Communication*, Vëll.11, Nr.2 (2023), <https://doi.org/10.17645/mac.v11i2.6400>; A. Fanta dhe I. Dachwitz, *Google, patroni i mediave: Si e zë në grackë gazetarinë gjiganti digjital*. Fondacioni Otto Brenner (nëntor 2020), https://www.otto-brenner-stiftung.de/fileadmin/user_data/stiftung/02_Wissenschaftsportal/03_Publikationen/AH103_Google_EN.pdf; C. Papaevangelou, "Financimi i ndërmjetësve: Strategjia e Google dhe Facebook për kapjen e gazetarisë." Tek *Digital Journalism*, Vëll.12, Nr.2 (2023), fq.234-255.

83 Seminar i OSBE-së mbi kompanitë e mëdha të teknologjisë dhe lirinë e medias (2024), <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/578485> dhe M. Tonneau dhe të tjerë, *Pabarazitë gjuhësore në shpërndarjen e fuqisë punëtore për moderim nga platformat e rrjeteve sociale*. Instituti i Oksfordit për Rrjet (gusht 2025), https://doi.org/10.31235/osfn.io/amfws_v1

Kjo situatë rëndohet edhe më tej nga **investimet e pamjaftueshme në gjuhët lokale, kulturat dhe kuptimin e kontekstit**, sidomos në zhvillimin e IA.

Këto dinamika janë në thelb në kundërshtim me parimin se hapësirat në dukje publike bartin përgjegjësi të posaçme shoqërore për mbrojtjen e interesit publik.⁸⁴ Ato bien po ashtu ndesh me përgjegjësitë korporative për respektimin e të drejtave të njeriut, siç përcaktohen me korniza ndërkombëtare si *Parimet udhëzuese të OKB-së për biznesin dhe të drejtat e njeriut*, si dhe parimet më të gjera të përgjegjësive shoqërore të korporatave. Sipas këtyre kornizave, platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë kanë detyrimin që t'i identifikojnë, parandalojnë, zbusin dhe adresojnë shkeljet e të drejtave të njeriut të lidhura me shërbimet dhe teknologjitë e tyre digjitale.⁸⁵

4.3 Inteligenca artificiale prodhuese shkakton çrregullime të mëtejme

IA prodhuese rrezikon të thellojë më tej varësinë nga një grupsh aktorësh dhe paraqet sfida të reja për sektorin e medias. Ndonëse kapaciteti i kompanive të mëdha të teknologjisë për të ushtruar pushtet kontrollues mbi informacionin përmes IA prodhuese është ende në faza relativisht të hershme, **kjo teknologji krijon mundësi për të ndikuar në dallim në debatin publik, duke përcaktuar se cilat informacione dhe cilat organizata mediatike janë të dukshme e cilat jo**, çfarë lloj lajmesh prodhohen nga sistemet e tyre të IA-së prodhuese dhe cilat lidhje të burimeve të lajmeve ofrohen.

Shtrirja dhe ndikimi i IA prodhuese

IA prodhuese u mundëson kompanive të mëdha të teknologjisë të **prodhojnë përmbajtje të veten**. Në vend se t'i orientojnë përdoruesit drejt burimeve të mediave të lajmeve përmes platformave dhe

⁸⁴ Forumi për Informacion dhe Demokraci, Partneriteti ndërkombëtar për informacion dhe demokraci (2019), <https://informationdemocracy.org/an-international-partnership/>

⁸⁵ Për Parimet udhëzuese të OKB-së mbi biznesin dhe të drejtat e njeriut (UNGP, 2011), shihni https://www.ohchr.org/sites/default/files/documents/publications/guidingprinciplesbusinesshr_en.pdf, për zbatimin e parimeve udhëzuese të OKB-së në zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive digjitale, shihni projektin B-Tech te <https://www.ohchr.org/en/b-tech>.

motorëve të kërkimit, kompanitë e IA e përdorin përmbajtjen e mediave të lajmeve për të **krijuar përmbledhje të gatshme**. Këto përmbledhje të krijuara nga IA, edhe atëherë kur përmbajnë lidhje të burimeve origjinale të lajmeve, i ulin ndjeshëm gjasat që përdoruesit ta vizitojnë burimin fillestar, duke e mbajtur vëmendjen e tyre brenda ekosistemit të IA.⁸⁶ Si rrjedhojë, trafiku drejt faqeve në rrjet të lajmeve ulet ndjeshëm – deri në 50 për qind sipas një hulumtimi të vitit 2025 — pasi përdoruesit nuk ndiejnë më nevojë që ta klikojnë burimin fillestar të informacionit.⁸⁷ Ky kalim nga motorët tradicionalë të kërkimit drejt motorëve të përgjigjeve të bazuar në IA, nëse vazhdon kështu, pritet të shkaktojë çrregullime **të mëtejme në të ardhurat** që mediat e lajmeve (dhe “faqet fundore në rrjet”) sigurojnë nga vizitorët.⁸⁸

Duke e zbehur shtrirjen e mediave dhe duke e shkëputur përmbajtjen nga brendi i medias, **rritja e kërkimit të bazuar në IA cenon kapacitetin e mediave për të komunikuar drejtpërdrejt me audiencat**. Kjo shkëputje e marrëdhënies së drejtpërdrejtë me publikun ua kufizon ndjeshëm mediave mundësitë për vlerësim të përshtatur, për menaxhim të marrëdhënieve me audiencat/abonentët, për zhvillim të vizionit strategjik dhe për ndërtimin e besimit me audiencat. Për më tepër, përmbledhjet e prodhuara nga IA mund ta **dëmtojnë drejtpërsëdrejti reputacionin e organizatave mediatike**, veçanërisht kur u atribuojnë mediave të lajmeve raportime të pasakta (si p.sh. ankesa e vitit 2024 e *BBC* ndaj *Apple* për një titull të rremë të prodhuar nga IA),⁸⁹ ose kur sistemet prodhuese “halucinojnë” infomaciontë pasaktë.⁹⁰

86 Një studim i vitit 2025 nga Qendra Kërkimore Pew tregon se përdoruesit e *Google* që hasin në përmbledhje të IA kanë më pak të ngjarë që të klikojnë në vegëza të faqeve të tjera të rrjetit krahasuar me përdoruesit që nuk u shfaqen përmbledhje të tilla, dhe ka më shumë të ngjarë që ta përfundojnë seancën e tyre të shfletimit me kaq. Shihni <https://www.pewresearch.org/short-reads/2025/07/22/google-users-are-less-likely-to-click-on-links-when-an-IA-summary-appears-in-the-results/>.

87 I. Simonetti dhe K. Blunt, “Faqet e lajmeve po goditen rëndë nga veglat e reja të IA të *Google*.” Në *The Wall Street Journal* (10 qershor 2025), <https://www.wsj.com/tech/AI/google-AI-news-publishers-7e687141>

88 Në korrik 2025, një grup botuesish të pavarur ushtruan ankesë *antitrust* në BE kundër *Google* për përmbledhjet e saj të IA, shihni <https://www.reuters.com/legal/litigation/googles-ai-overviews-hit-by-eu-antitrust-complaint-independent-publishers-2025-07-04/>

89 G. Fraser, “*BBC* paraqet ankesë ndaj *Apple* për një titull lajthitës për një rast të shtënash.” *BBC* (13 dhjetor 2024), <https://www.bbc.com/news/articles/cd0elzk24dno>

90 Termi “halucinacioni” i referohet rezultateve nga mjetet gjeneruese të IA që janë faktikisht të pasakta ose mashtruese, edhe pse përdoruesit mund t’i duken të besueshme.

Shfrytëzimi i përmbajtjes nga IA prodhuese

Për të prodhuar rezultate cilësore, IA prodhuese i duhen vëllime të mëdha përmbajtjeje të cilësisë së lartë. Këtu përfshihen jo vetëm të dhënat e nevojshme për trajnimin e sistemeve të IA, por edhe qasja në burime të besueshme informacioni për gjenerim të rezultateve (*chatbot*, përmbledhje lajmesh në motorë kërkimi etj.), që do duhej të shoqëroheshin me referenca të qarta të burimeve. Shfrytëzimi i kësaj përmbajtjeje nga ana e IA do të **mund të shërbente si burim i rëndësishëm të ardhurash për gazetarinë**, por sektori i mediave nuk ka qëndrim të unifikuar për sa i përket qasjes më të përshtatshme për të siguruar kompensim të drejtë për përdorim të përmbajtjes mediatike, dhe mungon koordinimi mes botuesve.

Për më tepër, platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë **licencojnë përmbajtjen mediatike sipas diskrecionit të tyre.** Pushteti është i përqendruar në masë të madhe në vendburim, pra në nivelin ku vendoset se cilat përmbajtje mediatike do të licencohen për trajnimin e IA dhe cilat jo (dhe, rrjedhimisht, nuk do të kompensohen, siç ndodh, për shembull, me përmbajtjen në gjuhë më pak të përdorura ose nga kontekste të caktuara kulturore). Krahas kësaj, IA prodhuese trajnohet mbi bazën e sasive të mëdha përmbajtjeje të qasshme publikisht, përfshirë këtu materiale të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe përmbajtje të tjera mediatike, shpesh pa pëlqimin eksplisit të bartësve të të drejtave dhe pa kompensim. Çështja nëse rezultatet e prodhuara nga IA mund të përbëjnë shkelje të të drejtave autoriale të krijuesve origjinalë, ose eksploatim të përmbajtjes mediatike për qëllime të krijimit të produkteve komerciale, është kthyer në temë qendrore debati ligjor. Në dhjetor 2023, *The New York Times* paditi *OpenAI* dhe kompani tjera të IA për përdorim të padrejtë të përmbajtjes së mbrojtur nga e drejta e autorit për trajnimin e modeleve të IA. Procese të ngjashme gjyqësore kanë iniciuar edhe kompani të tjera mediatike dhe industri kreative. Që nga gushti 2025, sipas detyrimeve të parapara me Aktin e BE-së për inteligjencën artificiale, ofruesit e modeleve të IA për

përdorim të përgjithshëm në BE duhet të paraqesin përmbledhje të të dhënave të përdorura për trajnimin e modeleve të tyre.⁹¹

Marrëveshjet me mediat

Disa organizata mediatike kanë zgjedhur të **negociojnë dhe të lidhin marrëveshje** me kompanitë e IA-së. Në kohën e hartimit të këtij Manuali, *OpenAI* kishte lidhur marrëveshje me vetëm 34 botues, mirëpo transparenca lidhur me kriteret e vendimmarrjes ka qenë e kufizuar.

Ndër **marrëveshjet më të rëndësishme** janë ato ndërmjet *Axel Springer SE* (Gjermani) dhe *OpenAI*,⁹² *Prisa Media* (Spanjë) dhe *OpenAI*,⁹³ *Le Monde* (Francë) dhe *OpenAI*,⁹⁴ *Associated Press* dhe *Google*,⁹⁵ kryesisht për përdorimin e përmbajtjes së tyre për trajnim të modeleve të mëdha gjuhësore (LLM), si dhe ndërmjet *Agence France-Presse* (AFP) dhe *Mistral AI*⁹⁶ për përdorimin e përmbajtjes së AFP-së për nxjerrje të drejtpërdrejtë të informacionit në përgjigje të kërkesave të përdoruesve.

Megjithëse numri i marrëveshjeve është në rritje, ato **lidhen kryesisht me botues të mëdhenj** ose me organizata mediatike nga tregje të mëdha dhe nuk janë transparente për sa i përket kohëzgjatjes, kushteve financiare apo kushteve të tjera kontraktuale. Kjo mungesë koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet botuesve, dhe në industrinë e mediave në

91 Komisioni Evropian, "Komisioni prezanton formën për ofruesit e modeleve të IA-së për Qëllime të Përgjithshme për t'i përmbledhur të dhënat e përdorura për të trajnuar modelin e tyre." Komunikatë për shtyp (24 korrik 2025), <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/news/commission-presents-template-general-purpose-ai-model-providers-summarise-data-used-train-their>

92 OpenAI, "Partneriteti me Axel Springer pritet ta avancojë përdorimin për qëllime të dobishme e IA-së në gazetari" (13 dhjetor 2023), <https://openai.com/index/axel-springer-partnership/>

93 OpenAI, "Partneritete botërore me mediat e lajmeve: Le Monde dhe Prisa Media" (13 mars 2024), <https://openai.com/index/global-news-partnerships-le-monde-and-prisa-media/>

94 OpenAI, "Partneritete botërore me mediat e lajmeve: Le Monde dhe Prisa Media" (13 mars 2024), <https://openai.com/index/global-news-partnerships-le-monde-and-prisa-media/>

95 M. O'Brien, "Google lidh marrëveshje me për ofrimin e lajmeve të përditësuara përmes përmes chabot-it të tij të IA "Gemini AI chatbot" AP (16 janar 2025), <https://apnews.com/article/google-gemini-ai-associated-press-ap-0b57bcf8c80dd406daa9ba916adacaf>

96 AFP, "AFP dhe Mistral AI njoftojnë partneritet global" (16 janar 2025), <https://www.afp.com/fr/lagence/notre-actualite/communiqués-de-presse/lafp-et-mistral-ai-annoncent-un-partenariat-mondial>

përgjithësi, bart **rreziqe shtesë për pluralizmin mediatik**, veçanërisht në tregjet e vogla dhe në aspektin e përfaqësimit gjuhësor e kulturor.

Në Danimarkë, industria e medias ka themeluar një organizatë të menaxhimit kolektiv, *Organizata për Menaxhim Kolektiv të Botimeve Daneze të Shtypit* (OMKBDSH), për të lidhur marrëveshje mbi të drejtat e botuesve të shtypit në emër të tyrin. Si përgjigje ndaj shqetësimeve se shtetet ose mediat më të vogla po rrezikojnë të lihen mënjanë, kjo organizatë hapi negociata për një marrëveshje kolektive me *OpenIA*, megjithatë kjo qasje nuk dha ndonjë rezultat konkret. Si rrjedhim, OMKBDSH inicioi një proces ndërmjetësimi sipas Ligjit danez për të drejtën e autorit.⁹⁷ Procese të ngjashme ndërmjetësimi ishin iniciuar edhe më parë me platformat e rrjeteve sociale. Negociatat kanë rezultuar në një marrëveshje të përkohshme licencimi me *Google* dhe një memorandum mirëkuptimi me *Microsoft*, ndërkohë që *Meta* dhe *TikTok* kanë refuzuar të marrin pjesë në proceset e ndërmjetësimit që synonin njohjen e vlerës së të drejtës së autorit dhe të lajmeve. Ky refuzim është adresuar më tej te ministri danez i Kulturës, me synim fillimin e një procesi arbitrazhi.⁹⁸

Kontrolli, manipulimi dhe fragmentimi

IA prodhuese rrezikon ta zgjerojë kontrollin e kompanive të mëdha të teknologjisë mbi redaksitë e lajmeve, duke u shtrirë edhe te teknologjitë që përdoren për prodhimin e përmbajtjes. Duke qenë se këto kompani e dirigjojnë zhvillimin e IA, organizatat mediatike e kanë shpesh të vështirë ta përdorin IA pa u mbështetur në shërbimet kompjuterike dhe të ruajtjes së të dhënave në “cloud”, në modele bazë, sete të të dhënave, hulumtim apo financim të kontrolluar nga kompanitë teknologjike me bazë në SHBA.⁹⁹

⁹⁷ Deklaratë e OMKBDSH -së, 2024, <https://dpcmo.dk/dpcmo-demands-mediation-with-openAI-from-the-minister-of-culture/>

⁹⁸ Deklaratë e OMKBDSH -së, 2024, <https://dpcmo.dk/dpcmo-starts-arbitration-cases-against-meta-and-tiktok/>

⁹⁹ Për udhëzime mbi zbatimin e përgjegjshëm të sistemeve të inteligjencës artificiale në gazetari, shihni Udhëzimet CDMSI të Këshillit të Evropës nga viti 2023, <https://rm.coe.int/cdmsi-2023-014-guidelines-on-the-responsible-implementation-of-artific/1680adb4c6>.

Nga ana tjetër, IA prodhuese mund të paraqesë edhe një mundësi për kufizimin e këtyre varësive. Disa organizata mediatike kanë krijuar tashmë modele të mëdha gjuhësore (si *BloombergGPT*, *ChatDPG ose Spinoza*) të vetat, mirëpo edhe këto modele vazhdojnë të mbështeten në burimet bazë të ofruara nga kompanitë e mëdha të teknologjisë. Për më tepër, zhvillimi i modeleve të mëdha gjuhësore është realisht i arritshëm vetëm për mediat me kapacitete të mëdha teknologjike dhe financiare. Madje edhe për organizatat më të mëdha mediatike, konkurrimi me burimet financiare të kompanive të IA dhe me modele të trajnuara mbi sasi shumë të mëdha të dhënash të mbledhura nga oqeani i pafund i rrjetit, përfshirë përmbajtje gazetareske të përdorur pa pëlqim ose kompensim, është sfidë e madhe. Sidoqoftë, qasja e modeleve me burim të hapur të trajnuara paraprakisht po rritet ditaditës dhe tani ekzistojnë iniciativa të shumta për trajnimin e modeleve alternative dhe lokale. Këto zhvillime mund të krijojnë alternativa financiarisht më të qëndrueshme, nëse kompanitë mediatike kanë stimuj të mjaftueshëm për të mbështetur dhe për të punuar me modele të tilla.

Krahas varësive infrastrukture, **zhvillimi i hovshëm i veglave të IA prodhuese rrezikon jo vetëm ta cenojë besimin e përgjithshëm në media¹⁰⁰ dhe ta lehtësojë manipulimin mediatik**, por edhe të nxisë përhapjen e përmbajtjes ndërvepruese “deepfake” dhe formave tjera të ashtuquajtura “deepfake kompozicionale”.¹⁰¹ Materiali i prodhuar artificialisht mund të çojë në forma të imitimeve dhe shtrembërimeve bindëse të realitetit, si dhe në forma të dhunës së shënjestruar tejet invazive. Vëllimi i madh i përmbajtjes që mund të prodhohet brenda pak çasteve me anën e teknologjive të IA mund të përdoret për sulme ndaj gazetarëve dhe për shtrembërim të perceptimit publik mbi gazetarinë,¹⁰² me pasoja të mëdha për mediat si në aspektin financiar ashtu edhe atë të sigurisë dhe besueshmërisë.

100 Përfshirë rastet kur përmbajtja mediatike etiketohet gabimisht si e prodhuar artificialisht, shihni, për shembull, <https://techcrunch.com/2024/06/21/meta-tagging-real-photos-made-with-ai/>

101 UNESCO, *Mendimi yt s'çon peshë - Ekspozimi ndaj dhunës me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia në epokën e IA gjeneruese*. (2024), fq.19, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000387483>; Shihni edhe: NPR, “Si u shndërrua Gamergate në model për veprime keqdashëse në rrjet” (30 gusht 2019), fq.13, <https://www.npr.org/2019/08/30/756034720/how-gamergate-became-a-template-for-malicious-action-online>.

102 N. Lubin, “Si t’ia bëjmë me përmbajtjen e rrjetit me përmbajtje të pavlerë.” *The Atlantic* (12 mars 2024), <https://www.theatlantic.com/technology/archive/2024/03/generative-AI-social-media-moderation/677730/>

Në dekadën e fundit diskutimet mbi politikat kanë qenë të përqendruara kryesisht në dhomat e jehonës, flluskat e filtrimit dhe ndikimin e tyre në polarizim e radikalizim. Rritja eksponenciale e **personalizimit të përmbajtjes përmes IA prodhuese rrezikon ta minojë edhe më tej ekosistemin e përbashkët të informimit**. Shpërndarja e personalizuar e lajmeve mund t’u ofrojë mediave mundësi për t’u shërbyer më mirë audiencave të tyre dhe për t’u angazhuar me grupe të ndryshme shoqërore në mënyrë më të personalizuar, por bart njëkohësisht edhe rreziqe fragmentimi dhe lehtësimi të polarizimit, dezinformimit hipertargetues, madje edhe shtrembërimit të debatit demokratik. Për shembull, megjithëse rrjedhat e përmbajtjes në rrjete sociale janë tashmë tejet të personalizuara, ato megjithatë vazhdojnë të shfaqin edhe përmbajtje të tjera, ndonëse të ngjashme, për përdorues me preferenca dhe karakteristika të përbashkëta. Ndryshe nga to, **IA prodhuese e çon personalizimin e komunikimit dhe informimit në ekstrem, duke prodhuar nivele të paprecedenta fragmentimi dhe individualizimi**, shpesh në mënyrë tejet jotransparente. Aplikacione si chatbot (p.sh., *ChatGPT*) u mundësojnë përdoruesve të ndërveprojnë me përmbajtje informative (dhe politike) në mënyrë të izoluar, meqë përgjigjet e prodhuara nga IA përshtaten për secilin person dhe kështu mund të krijohen “publiku me vetëm një person”. Hulumtimet mbi efektin e IA prodhuese dhe chatbot në qasjen në lajme¹⁰³ janë akoma të kufizuara, por mund të supozohet se **Skica aktual dhe mënyra e zbatimit të kësaj teknologjie nuk i shërben një nevojë themelore demokratike: ruajtjes së një hapësirë të përbashkët informimi, pra të një realiteti të përbashkët, si bazë për debatin publik**.

¹⁰³ Megjithatë, studimet e para tregojnë se rëndësia e saj po rritet. Sipas Raportit të Institutit Reuters mbi lajmet digjitale për vitin 2025, 5% përdorin aplikacione të inteligjencës artificiale gjeneruese për t’u qasur lajmeve. Ky numër rritet në 15% për moshat nën 25 vjeç. Shihni N. Newman dhe të tjerë, *Raport i Institutit të Reuters mbi lajmet digjitale 2025*, Instituti Reuters për Studimin e Gazetarisë (2025).



VISIBILITY

VISIBILITY

VISIBILITY

VISIBILITY

VISIBILITY

VISIBILITY

5. Dallimi i Medias

Në këtë pjesë paraqitet një pasqyrë e instrumenteve të politikave që synojnë rritjen e dallimit të gazetarisë në interes publik në hapësirën digjitale. Në nënpjesën e parë shqyrtohen qasjet dhe nismat rregulluese të deritanishme, me qëllim nxjerrjen e mësimave dhe përcaktimin e konsideratave kryesore për qeverisjen e ardhshme. Nën pjesa e dytë paraqet rekomandime mbi mënyrat në të cilat shtetet mund ta promovojnë disponueshmërinë, dallimin dhe theksimin e gazetarisë që respekton kodet e etikës profesionale dhe prodhon informacion në interes publik.

5.1 Nismat për politika dhe rregullore për forcimin e dallimit të medias

Instrumente politikash për adresimin e mënyrave ku platformat ushtrojnë kontroll mbi përmbajtjen

Një sërë instrumentesh të politikave për **mbrojtjen e lirisë së medias** synojnë të adresojnë drejtpërdrejt mënyrën në të cilën kompanitë e mëdha të teknologjisë ushtrojnë kontroll mbi qasjen në informacion. Në këtë

drejtim, miratimi i politikave për dallimin të informacionit “cilësor” ose “në interes publik” është parë si zgjidhje joshëse për t’iu kundërvënë varësive ekzistuese të mediave dhe asimetrive të pushtetit, me qëllim nxitjen e debatit demokratik. Duke e adresuar drejtpërsëdrejti një aspekt të rëndësishëm të pushtetit të platformave mbi mediat, atë të aftësisë së tyre për të përcaktuar se cilat lajme marrin përparësi në shërbimet e tyre, këto politika mund ta rrisin ekspozimin e publikut ndaj gazetarisë së larmishme, lokale dhe në interes publik.¹⁰⁴ Promovimi i dallimit të përmbajtjes që respekton standardet profesionale të gazetarisë mund të kontribuojë edhe në stabilitetin financiar të mediave¹⁰⁵ dhe të krijojë stimuj që mediat të prodhojnë përmbajtje më cilësore në vend të përmbajtjes “së denjë për klikime” që synon kryesisht përmirësimin e vëmendjes dhe të ardhurave nga reklamat.

Politika të tilla mund të zbatohen duke përcaktuar që platformat t’u ofrojnë organizatave mediatike ose përmbajtjes në interes publik mbrojtje të veçantë. Megjithatë debati mbi meritat e këtyre politikave është kompleks dhe politikisht i ndjeshëm, dhe ndërlikohet më tej nga termat e shumtë, shpesh të paqartë dhe me domethënie të mbivendosur, që përdoren për përshkrimin e tyre, si “privilegje mediatike”, “theksim i duhur”, “përmbajtje e detyrueshme” dhe “rregulla të trajtimit të posaçëm”. Ky Manual Politikash përdor termin “politika për dallimin” për t’iu referuar përgjithësisht politikës, si dhe formave të (vetë)rregullimit,

¹⁰⁴ Këshilli i Evropës, *Shënim udhëzues mbi prioritizimin e përmbajtjes në interes publik në rrjet*. (2021), <https://rm.coe.int/cdmsi-2021-009-guidance-note-on-the-prioritisation-of-pi-content-ado/1680a524c4>; K. Bleyer-Simon dhe E. Brogi, *Rritja e besueshmërisë së përmbajtjes përmes theksimit: Tregues të burimeve të besueshme në rrjet*. European Digital Media Observatory (2021), <https://cadmus.eui.eu/bitstream/handle/1814/74327/Enhancing-Content-Reliability-by-Prominence-Indicators-for-Trustworthy-Online-Sources-Report.pdf?sequence=1>; K. Rozgonyi, “Llogaridhënia dhe qeverisja e platformave: Rasti i theksimit të duhur në rrjet të përmbajtjes së mediave të shërbimit publik.” *Tek Rrjet Policy Review*, Vëll.12, Nr.4 (2023)

¹⁰⁵ ERGA, *Sigurimi i theksimit dhe qasjes së përmbajtjes së mediave audio-vizuale në të gjitha platformat (gjetshmëria): Rezultati 1: Dokument përmbledhës lidhur me Nenin 7a të Direktivës për shërbimet e mediave audio-vizuale* (2021), fq.5, https://erga-online.eu/wp-content/uploads/2021/01/ERGA_SG3_2020_Report_Art.7a_final.pdf; ERGA, *Zbatimi i qëndrueshëm i kuadrit të AVMSD-së: Rezultati 3 - Shqyrtimi i mënyrave në të cilat algoritmet dhe sistemet e rekomandimit mund të sigurojnë theksimin e duhur të shërbimeve të mediave audio-vizuale në interes të përgjithshëm (Neni 7a) si edhe theksimin e produkteve evropiane (Neni 13(1))* (2022), fq.127, https://erga-online.eu/wp-content/uploads/2022/12/2022-12-ERGA-SG1-Report-Prominence_Art.7a-and-Art.-13.pdf; Studim mbi pluralizmin dhe diversitetin e medias në rrjet: Raport përfundimtar. Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian (2022).

që u ofron mediave trajtim të posaçëm me synim përmirësimit e dallimi dhe qasjes së tyre për përdoruesit në platformat në rrjet.¹⁰⁶

Rregullat e përmbajtjes së detyrueshme

Historikisht, lloje të caktuara shërbimesh ose infrastrukture të konsideruara thelbësore për jetën e përditshme të publikut, si transporti ose telekomunikacioni, janë përkufizuar si “shërbime publike”. Këto shërbime, shpesh me karakter monopolist, u shërbejnë nevojave bazë shoqërore dhe, për këtë arsye, sigurimi i qasjes së barabartë, mosdiskriminimit, përbaljes, besimit dhe llogaridhënies publike në suazat e ofrimit të këtyre shërbimeve konsiderohet përgjegjësi shoqërore. Ideja e shpalljes me ligj të një shërbimi si “shërbim publik” ka për qëllim të sigurojë që qasja në shërbim të tillë të mos trajtohet thjesht si transaksion komercial, por si e mirë publike. Pra, funksionimi i tij duhet t’i shërbejë interesit më të gjerë publik, e jo vetëm konsideratave të fitimit. Në kontekstin digjital, thirrjet për trajtimin e platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë si infrastrukturë digjitale dhe si shërbim publik burojnë nga kontrolli i tyre de facto monopolist mbi peizazhin e informacionit, kontroll ky që u mundëson ta formojnë komunikimin, qasjen në informacion dhe pjesëmarrjen demokratike, duke i bërë këto platforma aq qendrore për funksionimin e shoqërisë sa që shtetet kanë arsye të sigurojnë që ato të bartin përgjegjësi publike.¹⁰⁷

Gjatë dekadave të fundit, politikëbërësit kanë njohur faktin që disa shërbime komunikimi janë aq jetike për diskursin publik dhe qasjen në informacion sa që nevojitet ndërhyrje e veçantë rregulluese

¹⁰⁶ A. Kuczerawy dhe J. Quintais, Përmbajtja e detyrueshme: *Trajtimi i veçantë dhe liria e shprehjes në platformat në rrjet: Përvoja e Evropës*, Institute for Information Law (2024), <https://www.ivir.nl/publications/must-carry-special-treatment-and-freedom-of-expression-on-online-platforms-a-european-story/>; E. Mazzoli, *Këndvështrim krahasues mbi rregullimin e theksimit dhe implikimet e tij për pluralizmin mediatik. Dokument pune*. Konferenca e 49-të hulumtuese mbi politikën e komunikimit, informimit dhe rrjetit (2021), fq.10, <https://doi.org/10.2139/ssrn.3898474>

¹⁰⁷ M. Ricks dhe të tjerë, “Rrjetet, platformat dhe shërbimet publike: Legjislacioni dhe politika.” *Tek Faculty Books 349* (2022) <https://scholarship.law.columbia.edu/books/349> ose V. Bagnoli, “Platformat digjitale si shërbime publike.” *Tek IIC - International Review of Intellectual Property and Competition Law*, Vëll.51, Nr.8 (2020), fq.903-905, <https://ssrn.com/abstract=4472716>

për të siguruar shpërndarjen dhe disponueshmërinë universale të tyre. Kjo ka çuar në krijimin e kornizave rregulluese që i detyrojnë këto shërbime komunikimi të transmetojnë përmbajtje të caktuar, si transmetime lokale ose përmbajtje në gjuhë të caktuara, të njohura ndryshe edhe si dispozita për përmbajtje të detyrueshme. Qëllimi i këtyre rregullave është të parandalojnë që ndërmjetësit dominues, siç janë operatorët e telekomunikacionit ose transmetuesit me licenca të kufizuara spektri, të përjashtojnë ose pengojnë konkurrentët. Ndonëse në kontekstin digjital brezi i frekuencave është praktikisht i pafund, platformat me pushtet mbi informacionin kontrollojnë një burim tjetër të rrallë: vëmendjen e njerëzve. Për këtë arsye, debati politik po intensifikohet rreth çështjes nëse, dhe në ç' mënyrë, politikat duhet të përqendrohen në zbatimin e dispozitave për përmbajtje të detyrueshme në raport me përmbajtjen cilësore në rrjete sociale, motorë të kërkimit dhe platforma të transmetimit të drejtpërdrejtë.¹⁰⁸ Miratimi i dispozitave të përmbajtjes së detyrueshme për platformat mund të nënkuptojë përcaktimin e këtyre të fundit si shërbim publik (pra si ofrues të një shërbimi thelbësor për publikun) në mënyrë që interesat e tyre private afariste të balancohen me nevojat e informimit publik. Për të nënvizuar se hapësirat botërore të informimit janë e mirë publike, dispozitat e tilla mund të parashohin edhe detyrimin për neutralitet politik dhe ideologjik të këtyre hapësirave, që formohen dhe strukturohen nga kompanitë e mëdha të teknologjisë.¹⁰⁹

Politikat për dallimin mund **të mbështeten në traditën e gjatë të masave ligjore** të konceptuara për t'u ofruar mediave mbrojtje të posaçme, në mënyrë që ato të mund të vazhdojnë së përmbushuri funksionin e tyre demokratik në kushte të ndryshimeve teknologjike.¹¹⁰ Shembuj të tillë përfshijnë detyrimet për përmbajtje të detyrueshme të vendosura ndaj operatorëve kabllorë, me synim sigurimin e qasjes në përmbajtje në interes

¹⁰⁸ A. Schiffrin & C. Radsch, Shqyrtim i dispozitave për përmbajtje të detyrueshme për lajmet në ekonominë e *platformave*. Punim hulumtues (2025), <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/597645>

¹⁰⁹ Forumi për Informacion dhe Demokraci, Partneriteti ndërkombëtar për informacion dhe demokraci (2019), <https://informationdemocracy.org/an-international-partnership/>

¹¹⁰ Për pasqyrë të privilegjeve ekzistuese të medias në të gjitha shtetet, shihni Këshilli i Evropës, Gazetari dhe privilegjet e mediave (2017), <https://rm.coe.int/journalism-and-media-privilege-pdf/1680787381>.

të përgjithshëm, si dhe përjashtimet nga ligji për mbrojtjen e të dhënave për “përpunimin për qëllime gazetareske”.¹¹¹ Janë propozuar një gamë e gjerë masash për t’i përshtatur politika për dallimin në raport me platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë. Këto **politika ngërthejnë nivele të ndryshme ndërhyrjeje në mënyrën se si platformat ushtrojnë kontroll mbi përmbajtjen gazetareske**, duke filluar nga transparenca dhe fuqizimi i përdoruesve (përdorimi i “sinjaleve të besueshmërisë” për t’u mundësuar përdoruesve ta identifikojnë përmbajtjen mediatike dhe, nëse dëshirojnë, ta renditin më lart) dhe kufizimet e pushtetit të platformave për të larguar, ulur në renditje ose *demonetizuar* përmbajtjen mediatike, e deri te rregullat për theksim të duhur sipas të cilave përmbajtja në interes publik duhet të jetë e dukshme ose të ketë përparësi.

Pavarësisht shkallës së ndërhyrjes, çdo **politikë dallimi e hamendëson një përcaktim të qartë se cilat subjekte kualifikohen si media ose bien në fushëveprimin e kësaj politike**. Ndërkohë që **çështjet se çfarë duhet të konsiderohet informacion në interes publik dhe kush vendos përfundimisht për këtë**¹¹² janë konsideratë qendrore e shumicës së politikave mediatike (nga subvencionet shtetërore deri te akreditimet dhe privilegjet e qasjes për gazetarët), ato janë veçanërisht të rëndësishme në kontekstin e **politikave për dallimin që kanë potencialin më të madh për ta mbrojtur lirinë e medias duke paraparë zhvendosjen e pushtetit të platformave mbi vëmendjen e përdoruesve**.

Nëse zbatohen në mjedise mediatike kufizuese ose pa garanci, politikat për dallimin mund të keqpërdoren në mënyra që cenojnë gazetarinë e pavarur. Shembull ilustrues është ligji i miratuar në Rusi në vitin 2017 që i bënte përmbledhësit e lajmeve, si *Yandex News*, përgjegjës për “përhapjen e lajmeve të rreme”. Sipas këtij ligji, lidhjet drejt përmbajtjes së mediave të regjistruara nga shteti përjashtohen nga përgjegjësia, duke krijuar në praktikë një mekanizëm kontrolli indirekt të medias përmes prioritizimit algoritmik të orientimit të trafikut drejt

111 Neni 114 i Kodit evropian për komunikimet elektronike, Neni 85 i GDPR; shihni gjithashtu Nenin 7a të AVMSD-së dhe Nenin 17(2)(e) e 20 të Rregullores së BE-së për reklamimin politik.

112 A. Kuczerawy dhe J. Quintais, Përmbajtja e detyrueshme: *Trajtimi i veçantë dhe liria e shprehjes në platformat në rrjet: Përvoja e Evropës*. Instituti për të Drejtën e Informacionit (2024); Observatori Evropian Audiovizual, *Përmbajtja në interes publik në platformat audio-vizuale: Qasja dhe gjetja*. (2023), fq.2, 7, <https://rm.coe.int/iris-special-2023-01en-public-interest-content/1680ad084d>

mediave shtetërore.¹¹³ Për shkak të rreziqeve të kapjes ose pasojave të mundshme negative¹¹⁴, dhe kompleksitetit të zbatimit të këtyre politikave në dobi të pluralizmit mediatik dhe gazetarisë në interes publik, në komunitetin e lirisë së medias, institucione akademike dhe shoqëri civile akoma nuk ka konsensus të qartë mbi këtë çështje.

Ndonëse politikat për dallimin mund të miratohen për lloje të ndryshme “informacioni në interes publik”, ky Manual Politikash përqendrohet te gazetaria dhe organizatat që e prodhojnë atë. Përveç **politikave të dallimit që synojnë drejtpërsëdrejti mbrojtjen e lirisë së medias**, ekzistojnë një sërë opsionesh tjera të politikave që mund të ndikojnë tërthorazi në përmirësimin e dallimit të përmbajtjes mediatike në platforma si, për shembull, duke e bërë të detyrueshme që platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë ta rregullojnë renditjen e përmbajtjes në mënyra që nxisin ndërveprime pozitive ndërmjet përdoruesve, në vend të prioritizimit të angazhimit, ose duke kërkuar që t’i hapin sistemet rekomanduese edhe për alternativa të zhvilluara nga palë të treta.

Kjo pjesë përvijon gamën e instrumenteve të ndryshme të politikave për dallimin dhe shqyrton përpjekjet rregulluese në këtë kontekst me synim nxjerrjen e mësimëve dhe identifikimin e konsideratave kryesore për qeverisjen e ardhshme.

Përfituesit e politikave të dallimit

Në kuadër të politikave për dallimin mund të bëhet një diferencim midis promovimit të dallimit të përmbajtjes dhe promovimit të dallimit të organizatave që prodhojnë përmbajtje.¹¹⁵ Politikat që përqendrohen te dallimi i përmbajtjes zbatohen zakonisht për kategorinë e “përmbajtjes në interes publik”, e përkufizuar në kuptimin e “asaj që është e mirë ose në dobi të publikut nga perspektiva normative e një shoqërie

¹¹³ M. Wijermars, “Ligji rus për sistemet e agregimit të lajmeve: Kush kontrollon rrjedhën e lajmeve, kontrollon lajmet?” Tek *Journalism*, Vëll.22, Nr.12 (2021), fq.2938-2954, <https://doi.org/10.1177/1464884921990917>

¹¹⁴ Forca të caktuara politike i kanë kritikuar idetë për t’ua “imponuar” individëve disa këndvështrime të “mediave kryesore”. Diskutime të ngjashme janë parë së fundmi edhe në kontekstin e verifikimit të fakteve.

¹¹⁵ A. Kuczerawy dhe J. Quintais, Përmbajtja e detyrueshme: *Trajtimi i veçantë dhe liria e shprehjes në platformat në rrjet: Përvoja e Evropës*, Instituti për të Drejtën e Informacionit (2024).

demokratike pluraliste”.¹¹⁶ Për shembull, Akti për sigurinë në rrjet i Mbretërisë së Bashkuar (ASO MB) rregullon “përmbajtjen me rëndësi demokratike”, që përkufizohet pjesërisht si “[përmbajtje që] është ose duket se synon posaçërisht të kontribuojë në debatin politik demokratik në [një pjesë të] Mbretërisë së Bashkuar” (Neni 17 i Aktit për sigurinë në rrjet). Ngjashëm, Neni 94 i Traktatit ndërmjet landeve gjermane për median i referohet “ofertave gazetaresko-editoriale”, ndërkaq Neni 7a i Direktivës së BE-së për shërbimet mediatike audio-vizuale (AVMSD) fokusohet te shërbimet audio-vizuale në interes të përgjithshëm. **Sfidë kryesore në promovimin e dallimit të përmbajtjes individuale në platforma është fakti se atributet përkatëse (p.sh., objektiviteti, drejtësia, larmia) është shumë e vështirë të përcaktohen dhe të maten algoritmikisht në shkallë të gjerë** (sidomos në gjuhët lokale).¹¹⁷ Për më tepër, kushtëzimi i dallimit të një përmbajtjeje me cilësinë e saj ose me pajtueshmërinë me standardet profesionale të gazetarisë krijon rrezik për censurë.¹¹⁸

Pjesërisht për këto arsye, diskutimet dhe nismat lidhur me politikat për dallimin të orientuara drejt platformave janë përqendruar shpesh te organizatat që prodhojnë përmbajtje dhe te respektimi nga ana e tyre i proceseve gazetareske. **Megjithatë, edhe në nivel institucional është sfiduese të përcaktohet se cilat organizata duhet të kualifikohen për trajtim të posaçëm.** Një opsion është që politikat për dallimin të zbatohen ekskluzivisht

116 ERGA, *Zbatimi i qëndrueshëm i kuadrit të AVMSD-së: Rezultati 3 - Shqyrtimi i mënyrave në të cilat algoritmet dhe sistemet e rekomandimit mund të sigurojnë theksimin e duhur të shërbimeve të mediave audio-vizuale në interes të përgjithshëm (Neni 7a) si edhe theksimin e produkteve evropiane (Neni 13(1))*. ERGA (2022) https://erga-online.eu/wp-content/uploads/2022/12/2022-12-ERGA-SG1-Report-Prominence_Art.7a-and-Art.-13.pdf; E. Mazzoli, *Politika e prioritizimit të përmbajtjes në rrjet: Qeverisja e theksimit dhe gjetshmërisë në platformat digjitale mediatike*. Shkolla Londineze e Ekonomisë dhe Shkencave Politike (2023), fq.200, <https://etheses.lse.ac.uk/4517/>; Këshilli i Evropës, *Prioritizimi i zbërthyer: Zbulimi i përmbajtjes në interes publik në rrjet*. Studim i Këshillit të Evropës DGI (2020), fq.16, <https://rm.coe.int/publication-content-prioritisation-report/1680a07a57>; Observatori Evropian Audio-vizual, *Përmbajtja në interes publik në platformat audio-vizuale : Qasja dhe gjetja*. Këshilli i Evropës (2023) fq.2 dhe 7, <https://rm.coe.int/iris-special-2023-01en-public-interest-content/1680ad084d>

117 Shihni për shembull lidhur me larminë S. Vrijenhoek dhe të tjerë, “RADio - RADio - Njësi matëse të divergjencës të ndjeshme ndaj renditjes për matjen e larmisë normative në rekomandimet e lajmeve,” tek *“Punimet e Konferencës së 16-të të ACM mbi sistemet rekomanduese”* (2022), fq.208-219, <https://dl.acm.org/doi/abs/10.1145/3523227.3546780>. Ky kundërshtim është veçanërisht i rëndësishëm për privilegjet e medias që zbatohen në shkallë të gjerë, siç janë kërkesat për theksimin e duhur, dhe më pak i rëndësishëm për privilegjet e medias që kërkojnë procese më të mira të ankimimit ose moderim më pak kufizues. Për shembull, Deepnews.AI dhe Newsguard kanë bërë përpjekje për të përcaktuar në mënyrë algoritmike gazetarinë.

118 Këshilli i Evropës, *Prioritizimi i zbërthyer: Zbulimi i përmbajtjes në interes publik në rrjet*. Studim i Këshillit të Evropës DGI (2020); Komisioni Evropian, *Studim mbi pluralizmin dhe diversitetin e medias në rrjet: Raport përfundimtar*. Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian (2022), fq.50.

për mediat e shërbimit publik (MSHP), duke pasur parasysh rolin e tyre ligjor dhe shoqëror për të prodhuar përmbajtje të besueshme dhe të larmishme.¹¹⁹ Mirëpo, në kontekste ku MSHP-të nuk janë mjaftueshëm të pavarura (ose nuk ekzistojnë), kjo qasje rrezikon ta forcojë kontrollin qeveritar mbi debatin publik¹²⁰ dhe të përjashtojë përmbajtjen cilësore dhe në interes publik që prodhohet nga mediat jopublike.¹²¹ Një opsion hibrid, i paraparë nga ASO i Mbretërisë së Bashkuar, është që MSHP-të të kualifikohen me automatizëm, ndërsa organizatave të tjera mediatike t'u jepet mundësia të kualifikohen nëse i plotësojnë kriteret përkatëse.¹²² Qasja e tretë, e ndjekur nga Akti evropian për lirinë e medias (AELM), nuk bën diferencim ndërmjet MSHP-ve dhe mediave të tjera, por vendos kriteret të përgjithshme si pavarësia editoriale dhe përgjegjësitë që duhet t'i përmbushin të gjitha organizatat përpara se të kualifikohen për politika dallimi (shihni Tabelën 1). Qasje të ngjashme ndjek edhe Kodi australian i praktikës për dezinformimin dhe keqinformimin, që e përkufizon “burimin e lajmeve” si “prodhues gazetaresk lajmesh që gëzon pavarësi editoriale nga subjektet e mbuluara në lajme” dhe që mban përgjegjësi për standardet e tij editoriale.¹²³

119 Në “Shqyrtimi i mediave të shërbimit publik” të korrikut 2025, Rregullatori i komunikimeve në Mbretërinë e Bashkuar, Ofcom, rekomandon theksim dhe zbulim për përmbajtjen e MSHP në YouTube dhe potencialisht në platforma të tjera të palëve të treta, përveç rregullave të sapo futura të theksimit në platformat televizive. Shihni Ofcom, Shqyrtim i mediave të shërbimit publik, <https://www.ofcom.org.uk/tv-radio-and-on-demand/public-service-broadcasting/public-service-media-review>.

120 E. Mazzoli, *Këndvështrim krahasues mbi rregullimin e theksimit dhe implikimet e tij për pluralizmin mediatik. Dokument pune. Konferenca e 49-të hulumtuese mbi politikën e komunikimit, informimit dhe rrjetit (2021)*, fq.10; E. Mazzoli, *Politika e priorizimit të përmbajtjes në rrjet: Qeverisja e theksimit dhe gjetjen në platformat digjitale mediatike*. Shkolla Londineze e Ekonomisë dhe Shkencave Politike (2023), fq.200, <https://etheses.lse.ac.uk/4517/>

121 ERGA, *Sigurimi i theksimit dhe qasjes së përmbajtjes së mediave audio-vizuale në të gjitha platformat (gjetja): Rezultati 1: Dokument përmbledhës lidhur me Nenin 7a të Direktivës për shërbimet e mediave audio-vizuale* (2021), https://erga-online.eu/wp-content/uploads/2021/01/ERGA_SG3_2020_Report_Art.7a_final.pdf; Këshilli i Evropës, *Priorizimi i zbrërthyer: Zbulueshmëria e përmbajtjes në interes publik në rrjet*. Studim i Këshillit të Evropës DGI (2020); Studim mbi pluralizmin dhe diversitetin e medias në rrjet: Raport përfundimtar. Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian (2022), fq.126.

122 Akti i MB-së për sigurinë në rrjet, Neni 56, https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2023/50/pdfs/ukpga_20230050_en.pdf

123 DIGI, *Kodi australian i praktikës për keqinformimin dhe keqinformimin*. Grupi i Industrisë Digjitale Inc. (dhjetor 2022), para. 3.7, https://digi.org.au/wp-content/uploads/2022/12/Australian-Code-of-Practice-on-Disinformation-and-Misinformation-FINAL_-_December-22-2022.docx.pdf; Shihni: Autoriteti Australian për Komunikim dhe Media e bën problematik këtë diskutim mes tjerash këtu: ACMA, *Përpjekjet e platformave digjitale sipas Kodit australian të praktikës mbi keqinformimin dhe keqinformimin - Raporti i dytë për qeverinë*, Autoriteti Australian për Komunikim dhe Media (korrik 2023), fq.13, <https://www.acma.gov.au/sites/default/files/2023-07/Digital%20platforms%20efforts%20under%20Code%20of%20Practice%20on%20Disinformation%20and%20Misinformation.pdf>; Shihni po ashtu përkufizimin e bizneseve të regjistruara të lajmeve në Kodin australian të negociimit për mediat e lajmeve , divizionin 3, <https://www.legislation.gov.au/C2021A00021/latest/text>.

Ky kod parasheh edhe një nënkategori për “lajme profesionale”, që përkufizohen si material i prodhuar nga një burim lajmesh që “raporton, heton ose ofron analiza kritike mbi” çështje apo ngjarje që “janë të rëndësishme për angazhimin e përdoruesve fundorë në debatin publik dhe për informimin e vendimmarrjes demokratike” ose që kanë rëndësi publike për përdoruesit fundorë.¹²⁴

Krahas përcaktimit të kritereve se kush duhet të përfitojë nga trajtimi preferencial, është po aq e rëndësishme të sqarohet se **kush vendosë** nëse këto kritere janë përmbushur, kur bëhet vlerësimi dhe në bazë të cilit proces dhe mekanizëm vlerësimi.

Sipas **AELM-së**, organizatat mediatike **vetë deklarohen** se a i plotësojnë kriteret e parapara me AELM.¹²⁵ Platformat duhet ta kontaktojnë autoritetin rregullator përkatës kur ekziston dyshim i arsyeshëm se organizata mediatike nuk është në pajtueshmëri me kriteret rregulluese ose me mekanizmin e bashkë rregullimit/vetë rregullimit të cilit i referohet. Nëse platformat e refuzojnë ose e shpallin të pavlefshëm aplikimin e një organizate mediatike, organizata përkatëse ka të drejtë ankimi përmes procedurave të arbitrazhit dhe ndërmjetësimit jashtëgjyqësor.¹²⁶ AELM thekson gjithashtu se shoqëria civile, verifikuesit e fakteve dhe organizatat e tjera profesionale duhet të kenë mundësi që të raportojnë raste të mos pajtueshmërisë së organizatave mediatike me detyrimet e AELM-së (por nuk parasheh mekanizëm për ta mundësuar këtë).¹²⁷ Fakti që AELM ua lë në dorë platformave zbatimin praktik të politikave të dallimit të parapara nga ky akt ka qenë objekt kritikash, duke pasur parasysh mungesën e ekspertizës së platformave lidhur me, për shembull, standardet e pavarësisë së redaksisë, si dhe

¹²⁴ DIGI, *Kodi australian i praktikës mbi keqinformimin dhe keqinformimin*. Grupi i Industrisë Digjitale Inc. (dhjetor 2022), para 3.10.

¹²⁵ Në këtë kontekst, Federata Evropiane e Gazetarëve (EFJ) ka nënvizuar rëndësinë e kritereve të qarta për të siguruar që një privilegj i fortë i gazetarëve mbron përmbajtjen e redaksisë nga praktikrat arbitrare dhe të errëta të moderimit të përmbajtjes të përdorura nga platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë, shihni <https://europeanjournalists.org/blog/2025/07/28/efj-urges-commission-to-promptly-draft-clear-guidelines-on-digital-platforms-content-moderation-obligations-emfa-article-18>.

¹²⁶ AELM, Neni 18(7)

¹²⁷ Recitali 53; thekson se roli i shoqërisë civile dhe organizatave të tjera në shqyrtimin e deklaratave të organizatave mediatike mund të trajtohet në udhëzimet mbi zbatimin e AELM-së të hartuara nga Komisioni.

mungesën e stimujve ekonomikë dhe politikë për t’i zbatuar këto politika në mënyrën që e mbron më së miri lirinë e medias.¹²⁸

Një mënyrë për ta zbehur rolin e shteteve dhe platformave në përcaktimin e asaj se cilat media kualifikohen për politika dallimi, si dhe për t’i ulur rreziqet që lidhen me përqendrimin e një kontrolli të tillë vendimmarrës mbi peizazhin e informacionit, është mbështetja në vetërregullim. Një standard i tillë vetërregullues, i njohur nga AELM, është IA i **Nismës për besim** në gazetari (NBG),¹²⁹ standard ndërkombëtar për vlerësim sipas pikë referencave të transparencës së mediave dhe të zotimit ndaj praktikave profesionale gazetareske, që ka për qëllim t’u ndihmojë organizatave mediatike të dëshmojnë gazetari të besueshme për audiencat e tyre.¹³⁰ Megjithatë, NBG ka qenë objekt kritikash në dy rrafshë: së pari, për mbështetjen e pjesshme në certifikimin me pagesë (gjë që mund të krijojë barriera për mediat e vogla, lokale, të komuniteteve, ose të hapë rrugë për ndërhyrje të mundshme politike nëse certifikimi financohet nga shtetet) dhe, së dyti, për peshën e pamjaftueshme që i jepet kriterit të anëtarësimit të medias në një trup të pavarur vetërregullues të llogaridhënies, pavarësisht se NBG ka një pjesë që e parasheh llogaridhënien e jashtme.

Tabela e mëposhtme paraqet një pasqyrë të përgjithshme të kriterëve të kualifikimit për organizatat mediatike sipas standardeve të AELM-së dhe NBG-së.

	AELM	NBG
Transparenca e identitetit dhe kontaktit	Emri i organizatës dhe të dhënat E kontaktit.	Emri/emrat e organizatës, të dhënat e kontaktit, kanalet e shpërndarjes, vendndodhja, data e themelimit.

¹²⁸ J. Barata, “Mbrotjtja e përmbajtjes mediatike në platformat e mediave sociale: qasja e anshme e Aktit Evropian për Lirinë e Medias (AELM).” Tek *Verfassungsblog* (25 nëntor 2022), <https://verfassungsblog.de/emfa-dsa/>; T. Seipp dhe të tjerë, “Përkufizimi i “medias” në Evropë: Kurthet e Aktit evropian të propozuar për lirinë e medias.” Tek *Journal of Media Law*, Vëll. 15, Nr. 1 (2023), fq. 39-51, <https://doi.org/10.1080/17577632.2023.2240998>

¹²⁹ Neni 18(1) i AELM-së; Recitali 53

¹³⁰ <https://journalismtrustinitiative.org/>

<p>Kriteret e pavarësisë</p>	<p>Pavarësi nga shtetet anëtare të BE-së, partitë politike dhe (subjektet e kontrolluara ose të financuara nga) vendet e treta.</p>	<p>Garanci për mosekzistim konfliktesh interesi, parandalim i ndikimit të tepruar të jashtëm ose menaxherial në gazetari. Diferencim i qartë mes lajmeve, opinioneve dhe përmbajtjes së sponsorizuar.</p>
<p>Transparenca e pavarësisë</p>	<p>Aksionarët me ndikim në operacione dhe strategji; pronarët përfitues; shuma e financimit shtetëror dhe reklamat nga vende të treta.</p>	<p>Lloji i kompanisë dhe nëse është (pjesërisht) në pronësi të shtetit apo tregtohet publikisht.</p> <p>Lista e burimeve të të ardhurave, të renditura nga më e larta tek më e ulta, dhe natyra e financimit publik (tarifë licence, grant etj.).</p> <p>Emrat e pronarëve (in)direkt/përfitues, anëtarëve të bordit, menaxhimit, aksionarëve të drejtpërdrejtë/shumicë/kontrollues. Për disa nga këta persona duhet të deklarohen edhe të dhëna lidhur me anëtarësinë në parti politike, pronësi të kompanive tjera dhe të dhënat e kontaktit.</p> <p>Mosdeklarimi lejohet në raste të veçanta për shkak të shqetësimeve për sigurinë.</p> <p>Vetëm për MSHP: përshkrim i mekanizmave të financimit dhe qeverisjes shtetërore.</p>

<p>Kriteret e përgjegjësisë së redaksisë</p>	<p>Organizata i nënshtrohet ligjeve kombëtare ose vetë rregullimit.</p>	<p>Organizatrat duhet të ofrojnë dhe t'i përmbahen një deklarate të misionit të redaksisë që është në përputhje me parimet etike të gazetarisë së besueshme.</p> <p>Organizatrat duhet të kenë procedurë për sigurim të saktësisë, udhëzime për përmbajtjen e prodhuar nga përdoruesit, anonimitetin e burimeve dhe tema të caktuara siç është përmbajtja eksplicite.</p> <p>Duhet të përdoret një larmi burimesh dhe duhet të mbrohet privatësia e burimeve.</p>
<p>Transparenca e përgjegjësisë së redaksisë</p>		<p>Ofrimi i deklaratës së misionit të redaksisë. Vetëm për MSHP: përshkrimi i misionit të shërbimit publik.</p>
<p>Kriteret e llogaridhënies</p>	<p>Organizata i nënshtrohet ligjeve kombëtare ose vetërregullimit.</p>	<p>Theksi në llogaridhënien e brendshme, duke përfshirë procesin për të korrigjuar dhe publikuar korrigjimet, si dhe për të trajtuar ankesat nga publiku. Llogaridhënia e jashtme nuk kërkohet, pasi në shumë vende mungojnë mekanizmat e duhur.</p>

Transparenca e llogaridhënies	Të dhënat e kontaktit të autoriteteve rregulluese kombëtare ose trupit vetërregullues. Platformat shumë të mëdha në rrjet duhet t'i kontaktojnë këto kur ekziston dyshimi i arsyeshëm në lidhje me pajtueshmërinë me mekanizmin e përgjegjësive së redaksisë.	Të dhënat profesionale të kontaktit në rrjetet sociale për pyetje/komunikim lidhur me përmbajtjen e redaksisë. Të dhënat e kontaktit të redaksisë së lajmeve dhe shërbimit ndaj klientit.
Tjetër	Mos ofrimi i përmbajtjes së prodhuar automatikisht pa shqyrtim njerëzor.	Shënjimi i përmbajtjes së lajmeve të prodhuar automatikisht. Ekzistimi i politikës për rekomandimet dhe kurimin algoritmik të lajmeve. Shpjegim mbi llojin, mënyrën dhe arsyen e mbledhjes së të dhënave personale. Ekzistimi i politikave mbi trajnimin dhe kushtet e punës.

Tabela 1. Përmbledhje e kritereve të kualifikimit të organizatave mediatike për standartet e AELM dhe NBG.

Përfitimet që sjellin politikat për dallimin

Politikat për dallimin mund të kategorizohen sipas **pushtetit kontrollues të platformave që synojnë ta adresojnë** (në veçanti moderimin/largimin ose kurimin/rekomandimin e përmbajtjes) dhe sipas **mekanizmave përmes të cilëve e bëjnë këtë** (me vendim të përdoruesit, detyrime procedurale ose ndryshime në rregullat e paracaktuara të platformave, si disa prej opsioneve më të zakonshme).

Moderimi i përmbajtjes

Një kategori masash të politikave për dallimin fokusohet te pushteti i platformave për të **larguar, ulur në renditje, mos vlerësuar, ose moderuar në ndonjë mënyrë tjetër përmbajtjen**, ekskluzivisht mbi ba-

zën e politikave të brendshme dhe interesave vetjake të platformave.¹³¹ Për shembull, Neni 18 i AELM-së u garanton organizatave mediatike një sërë të drejtash procedurale të posaçme: ato kanë një afat prej 24 orësh për të reaguar ndaj vendimeve për moderim të përmbajtjes përpara se këto vendime të hyjnë në fuqi (me përjashtime në situata krize ose kur moderimi i përmbajtjes bëhet në përputhje me kërkesat e ASHD-së për zbutjen e rrezikut); ankesat e tyre duhet të procedohen me prioritet; dhe ato kanë të drejtë të përfshihen në dialog miqësor, ndërmjetësim ose procedura për zgjidhje kontestesh me platformat. **Detyrime të tilla procedurale** mund ta parandalojnë hyrjen në fuqi të disa vendimeve për moderim, ose t'u mundësojnë organizatave mediatike t'i kontestojnë me sukses këto vendime dhe ta rikthejnë përmbajtjen përmes kanaleve të ankimit. Megjithatë, nëse ndiqet qasje ekskluzivisht procedurale, atëherë në thelb pushteti për të vendosur se çfarë lejohet dhe çfarë jo ngelet kryesisht në duart e vetë platformave, duke rrezikuar thellimin e mëtejme të asimetrive ekzistuese të pushtetit.

Një qasje tjetër parashih vendosjen e detyrimeve për trajtim të barabartë. Për shembull, Neni 94 i Traktatit të landeve gjermane për median ua ndalon platformave (si dhe aktorëve tjerë përkatës) që, pa arsye objektive të justifikueshme, të devijojnë nga rregullat e tyre të përgjithshme të moderimit dhe rekomandimit në raport me përmbajtje gazetareske të caktuar. Rregulla të tilla mund të përdoren për ta adresuar diskriminimin e platformave ndaj organizatave të caktuara mediatike (për shembull, duke ua larguar, ulur në renditje, ose mos vlerësuar përmbajtjen) për shkak të orientimit të tyre politik, raportimit kritik ose përfshirjes në negociata për kompensim të drejtë për përmbajtjen. Megjithatë, këto rregulla nuk i adresojnë masat që zbatohen njëtrajshmërisht për gjitha llojet e përmbajtjes dhe që mund të ndikojnë negativisht mbi median në tërësi, siç është deprioritizimi i përgjithshëm i lajmeve ose ndalimi i pamjeve tronditëse që shpesh janë pjesë përbërëse e raportimeve nga zonat e luftës.

¹³¹ Shihni në mënyrë të ngjashme nenet 17-19 të Aktit për sigurinë në rrjet të Mbretërisë së Bashkuar dhe Nenin 14 të ASHD-së, shihni J. Quintais, N. Appelman, R. O Fathaigh, "Përdorimi i kushteve dhe përkufizimeve për zbatimin e të drejtave themelore në moderimin e përmbajtjes," tek German Law Journal, Vëll.24, Nr.5 (2023), fq.881-911, <https://pure.uva.nl/ws/files/164496163/using-terms-and-conditions-to-apply-fundamental-rights-to-content-moderation.pdf>; A. Kuczerawy dhe J. Quintais, Përmbajtja e detyrueshme: *Trajtimi i veçantë dhe liria e shprehjes në platformat në rrjet: Përvoja e Evropës*, Instituti për të Drejtën e Informacionit (2024).

Në mënyrë më thelbësore, potenciali i politikave për dallimin për ta adresuar pushtetin e platformave në raport me moderimin e përmbajtjes është i kufizuar, ngaqë pushteti real i platformave nuk qëndron te kontrolli mbi atë se çfarë përmbajtje lejohet të qaset, **por te aftësia e tyre për të kontrolluar se cilat lajme tërheqin vëmendje përmes sistemeve të rekomandimit dhe, për rrjedhojë, nuk mbeten vetëm teorikisht të zbulueshme, por edhe realisht të dukshme dhe të arritshme** për publikun.

Kurimi i përmbajtjes dhe sistemet e rekomandimit

Një sërë instrumentesh të politikave synojnë **zbulimin dhe qasjen (e jo vetëm disponueshmërinë) e përmbajtjes mediatike në platforma**, për shembull duke promovuar nisma vetërregullimi që etiketojnë gazetarinë e besueshme, si *Trust Project*¹³² dhe *NewsGuard*.¹³³ Studime laboratorike në SHBA sugjerojnë se transparenca (p.sh. etiketat e besueshmërisë, informacionit mbi organizatën mediatike/gazetarin ose sqarimet pse është prodhuar një lajm i caktuar) mund të ketë efekt (të vogël) në perceptimin e besueshmërisë së përmbajtjes,¹³⁴ ndonëse shtrohet pyetja nëse këto gjetje mund të përgjithësohen. Sidoqoftë, transparenca nuk është faktor që i shtyn domosdoshmërisht përdoruesit të angazhohen më shumë me mediat e besueshme.¹³⁵ Studime tjera nuk kanë evidentuar efekte të tilla pozitive në qasjen në përmbajtje gazetareske pas etiketimit, mbase pjesërisht për shkak të vështirësisë për të siguruar që përdoruesit do arrijnë ta përpunojnë

132 <https://thetrustproject.org>

133 <https://www.newsguardtech.com>

134 A. Curry & N. J. Stroud, "Besimi te lajmet në rrjet." *Universiteti i Teksasit në Austin, Qendra për angazhim mediatik* (12 dhjetor 2017), <https://mediaengagement.org/wp-content/uploads/2017/12/CME-Trust-in-Online-News.pdf>; A.L. Curry dhe N.J. Stroud, "Efektet e transparencës gazetareske në vlerësimet e besueshmërisë dhe qëllimet e angazhimit." Tek *Journalism*, Vëll.22, Nr.4 (2019), <https://doi.org/10.1177/1464884919850387>; K.A. Johnson dhe B. St John III, "Transparenca në lajme: Ndikimi i vetëdeklarimit dhe i transparencës së procesit në besueshmërinë e perceptuar të gazetarit, stories, dhe të medias." Tek *Journalism Studies*, Vëll.22, Nr.7 (2021), fq.953-970, <https://doi.org/10.1080/1461670X.2021.1910542>; G.M. Masullo dhe të tjerë, "Sinjalizimi i besueshmërisë së organizatave të lajmeve në një panel njohurish të Google: eksperiment sipas metodës conjoint në Brazil, Gjermani dhe SHBA." Tek *New Media & Society*, Vëll.26, Nr.9 (2024), fq.5379, <https://journals.sagepub.com/doi/10.1177/14614448221135860?icid=int.sj-abstract.citing-articles.2>; B. K. Norambuena dhe të tjerë, "Kush i mbikëqyr mbikëqyrësit: përdorimi i treguesve të transparencës për t'i ndihmuar audiencat e lajmeve të vlerësojnë cilësinë e informacionit." Tek *Media and Communication*, Vëll.11, Nr.4 (2023), <https://www.cogitatiopress.com/mediaandcommunication/article/view/7018>

135 K. Aslett dhe të tjerë, "Etiketat e besueshmërisë së lajmeve shfaqin efekte mesatare të kufizuara mbi cilësinë e konsumit të lajmeve dhe nuk rezultojnë efektive në uljen e keqkuptimeve." Tek *Science Advances*, Vëll.8, Nr.18 (2022), <https://www.science.org/doi/10.1126/sciadv.abl3844>

përnjëmend informacionin mbi transparencën.¹³⁶ Efektet mund të ndryshojnë gjithashtu në varësi të bindjeve politike të përdoruesve ose qëndrimit të tyre ndaj organizatës mediatike përkatëse.¹³⁷

Opcion më substancial i politikave do të ishte **që platformave t'u kërkohet t'i integrojnë sinjalet e besueshmërisë në sistemet e tyre të rekomandimit**. Edhe pse platformat aktualisht nuk janë të detyruara ta bëjnë këtë, disa korniza rregulluese e kanë përqaftuar tashmë këtë qasje: për shembull, AELM parasheh dialog të strukturuar rreth mënyrave në të cilat platformat mund të nxisin qasjen në media të larmishme dhe të pavarura (Neni 19(1)(b)).

Legjislacioni ekzistues mund t'u japë shteteve hapësirë për të vendosur detyrime për **renditje preferenciale të përmbajtjes gazetareske** në platforma.¹³⁸ Në suazat e rregullimit të platformave në BE, nenet 34 dhe 35 të ASHD-së parashohin që platformat të vlerësojnë dhe më pas të zbusin rreziqet e identifikuar ndaj të drejtave themelore si liria e medias, përfshirë përmes përshtatjes së sistemeve të tyre të rekomandimit. Bashkë me detyrimet për pluralizëm mediatik të parapara në Nenin 3 të AELM-së, **këto dispozita mund interpretohen si kërkesë që platformat të sigurojnë dallimin dhe theksimin e duhur të mediave në shërbimet e tyre**. Duke mbajtur parasysh sfidat e përgjithshme ndaj

¹³⁶ G. M. Masullo, T. Lee dhe M. J. Riedl, "Sinjalizimi i besueshmërisë së organizatave të lajmeve në një Google Search." Tek *Journalism & Mass Communication Quarterly*, Vëll.99, Nr.4 (2021), <https://journals.sagepub.com/doi/abs/10.1177/10776990211047964>; M. Varnum dhe të tjerë, "Modelet e mëdha gjuhësore sipas teksteve historike mund të ofrojnë mjete informuese për shkencën e sjelljes." *Punimet e Akademisë Kombëtare të Shkencave të SHBA* (tetor 2024), https://www.researchgate.net/publication/384765592_Large_language_models_based_on_historical_text_could_offer_informative_tools_for_behavioral_science; C. Peacock, G. M. Masullo dhe N. J. Stroud, "Efekti i etiketave të lajmeve në besueshmërinë e perceptuar." Tek *Journalism*, Vëll.23, Nr.2 (2022), fq.301, <https://journals.sagepub.com/doi/abs/10.1177/1464884920971522>; S. Bradshaw, M. Elswah dhe A. Perini, "Shihni kush po shikon: Etiketimet e platformave dhe angazhimi i përdoruesve me media të mbështetura nga shteti." Tek *American Behavioral Scientists*, Vëll.68, Nr.10 (2024), fq.1325-1344, <https://journals.sagepub.com/doi/epub/10.1177/00027642231175639>

¹³⁷ M. Karlsson, "Zbutja e paqartësisë së transparencës në gazetari: Tërheqja e formave të ndryshme të transparencës për publikun e gjerë" Tek *Journalism Studies*, Vëll.21, Nr.13 (2020), fq.1795, <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/1461670X.2020.1790028>; G. M. Masullo dhe të tjerë, "Storia prapa stories: Shqyrtim i transparencës së procesit gazetaresk dhe besueshmërisë së mediave të lajmeve." Tek *Journalism Practice*, Vëll.16, Nr.7 (2022), fq.1287, <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/17512786.2020.1870529>; G. M. Masullo dhe të tjerë, "Sinjalizimi i besueshmërisë së organizatave të lajmeve në një panel njohurish të Google: eksperiment sipas metodës "conjoint" në Brazil, Gjermani dhe SHBA." Tek *New Media & Society*, Vëll.26, Nr.9 (2024), fq.5379

¹³⁸ Për kontekstin audiovizual shihni Nenin 7a të AVMSD. Grupi i Rregullatorëve Evropianë për Shërbimet e Medias Audio-vizuale, Dokument përmbledhës lidhur me Nenin 7a të Direktivës për shërbimet e mediave audio-vizuale, ERGA (2020), https://erga-online.eu/wp-content/uploads/2021/01/ERGA_SG3_2020_Report_Art.7a_final.pdf.

lirisë së medias që burojnë nga kontrolli i platformave mbi vëmendjen e përdoruesve dhe shpërndarjen e përmbajtjes, të identifikuara në këtë Manual Politikash, shtetet mund t'u kërkojnë platformave që t'i realizojnë detyrimet e tyre për zbutjen e rreziqeve ndaj të drejtave të njeriut duke miratuar politika dallimi sipas këtyre normave. Megjithatë, ka akoma shumë paqartësi se çfarë ndërhyrjesh konkrete mund t'u imponohen platformave në bazë të këtyre normave të hapura, ndërkohë që zbatimi i tyre varet në masë të madhe nga diskrecioni i rregullatorëve dhe prioritetet e zbatimit. Po ashtu, ato nuk ofrojnë një kornizë për t'u përgjigjur pyetjeve se cilat organizata mediatike ose cilat lloje përmbajtjeje duhet të përfitojnë nga politikat e dallimit, kush duhet të vendosë për këtë, dhe si mund të parandalohet kapja e këtij procesi. Çdo detyrim për theksim të duhur apo edhe prioritizim të përmbajtjes mediatike duhet të vendoset vetëm kur ekzistojnë garanci të qarta dhe të forta për **sundimin e ligjit dhe barazinë e sistemit mediatik**.

Një qasje alternative do të ishte që platformave t'u kërkohet që t'ua mundësojnë përdoruesve të zgjedhin sisteme rekomandimi që i japin përparësi përmbajtjes bazuar në treguesit e besueshmërisë. Kjo është qasja e ndjekur, për shembull, në Kodin e sjelljes për dezinformimin (Masa 22.2) sipas ASHD-së. Ngjashëm, politikat që parashohin **sisteme të ndërveprueshme rekomandimi**, përfshirë algoritme alternative të dizajnuara nga palë të treta, jashtë platformës, do t'u mundësonin aktorëve të shumtë që t'u ofrojnë përdoruesve opsione alternative për sistemet e rekomandimit.¹³⁹ Duke u mbështetur te zgjedhja e përdoruesit (dhe, në rastin e sistemeve të ndërveprueshme të rekomandimit, duke e decentralizuar pushtetin mbi opsionet që u ofrohen përdoruesve), këto qasje do t'u jepnin përdoruesve më shumë kontroll në formësimin e mjedisit të tyre digjital, duke lënë njëherazi më pak hapësirë për keqpërdorim. Hulumtimet sugjerojnë se përdoruesit aktualisht nuk ndihen se kanë kontroll mbi algoritmet e personalizimit dhe se do ta mirëprisnin transparencën dhe kontrollin

¹³⁹ Fondacioni Panoptykon & populli kundër kompanive të mëdha të teknologjisë, *Drejt pluralizmit algoritmik* (qershor 2025), https://panoptykon.org/sites/default/files/2025-07/towards-algorithmic-pluralism-in-the-eu-policy_pvbt-discussion-paper_04072025.pdf?utm_source=substack&utm_medium=emAI; dhe Fondacioni Panoptykon, *Safe by Default - Largimi nga renditjet e bazuara në angazhim drejt sistemeve rekomanduese të sigurta, që respektojnë të drejtat dhe janë të përqendruara te njeriu*. (mars 2024), https://panoptykon.org/sites/default/files/2024-03/panoptykon_peoplesbigtech_safe-by-default_briefing_03032024.pdf

e shtuar.¹⁴⁰ Megjithatë, përvoja në qeverisjen e platformave tregon se mbështetja ekskluzive të fuqizimi i përdoruesit vështirë se mund të mjaftojë për t'i tejkaluar sfidat strukturore për pluralizmin mediatic.

Mësime të nxjerra nga zgjedhjet dhe krizat

Në kohë krizash dhe zgjedhjesh, si shtetet ashtu edhe vetë platformat kanë ndërmarrë **masa të posaçme** për të siguruar qasje në informacion të besueshëm. Për shembull, disa platforma të kompanive të mëdha të teknologjisë i kanë ri kalibruar llogaritjet e “relevancës”, duke i dhënë më shumë peshë saktësisë, autenticitetit dhe autoritetit. Gjatë krizave si fatkeqësitë natyrore, emergjencat shëndetësore ose konfliktet, disa platforma kanë vendosur të promovojnë burime autoritare dhe të shtojnë ekspozimin ndaj informacionit në interes publik.¹⁴¹ Në kontekste krizash dhe zgjedhjesh, BE parasheh rregulla që mundësojnë respektimin e duhur të ndryshimit dhe qasjen në informacion të besueshëm përmes protokolleve.¹⁴² Për shembull, gjatë pandemisë COVID-19, disa platforma u dhanë përparësi mesazheve autoritare të verifikuara nga ekspertë të pavarur. Gjatë zgjedhjeve, platformat kanë ofruar në mënyrë proaktive informacion që lidhet me zgjedhjet, si vendet ku të votohet ose ku të gjendet informacion zyrtar i besueshëm.¹⁴³

¹⁴⁰ B. Kas dhe të tjerë, *Drejtimi digjital për konsumatorët*. BEUC – Organizata Evropiane për Mbrojtjen e Konsumatorit (2024), https://www.beuc.eu/sites/default/files/publications/BEUC-X-2024-032-Digital_fairness_for_consumers_Report.pdf; M. van Drunen, M. Zarouali dhe N. Helberger, “Sisteme rekomanduese në të cilat mund të mbeshtetesh – Perspektivë ligjore dhe ekonomike mbi transparencën dhe kontrollin që u nevojitet përdoruesve për t'i besuar personalizimit të lajmeve.” Tek *Journal of Intellectual Property, Information Technology and Electronic Commerce Law*, Vëll.13, Nr.3 (2022), fq.302-322, https://pure.uva.nl/ws/files/130466614/van_drunen_13_3_2022.pdf

¹⁴¹ Shihni, për shembull, H. Budaraju, “Mbështetja e nevojave në zhvillim për informacion rreth COVID-it.” Tek *Google Search Blog* (16 korrik 2022), <https://blog.google/products/search/supporting-evolving-covid-information-needs/> ose New America, “Shpërndarja e informacionit autoritar dhe nxitja e vendimmarrjes së informuar nga përdoruesit.” (p.d.), <https://www.newamerica.org/oti/reports/misleading-information-and-the-midterms/sharing-authoritative-information-and-promoting-informed-user-decision-making/>.

¹⁴² Shihni ASHD 48(1) dhe Komisioni Evropian, Kumtesë nga Komisioni – Udhëzime të Komisionit për ofruesit e platformave shumë të mëdha në rrjet dhe motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit në rrjet mbi zbutjen e rreziqeve sistemike për proceset zgjedhore, në përputhje me Nenin 35(3) të Rregullores (BE) 2022/2065, C/2024/3014, paragrafi 27(d)(i), <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52024XC03014&qid=1714466886277>.

¹⁴³ Për vlerësimin e *Meta* mbi qasjen e vet ndaj konteksteve zgjedhore gjatë gjithë vitit 2024, shihni <https://about.fb.com/news/2024/12/2024-global-elections-meta-platforms/>. Si shembull tjetër, në gusht të vitit 2025, *TikTok* njoftoi se do t'i "fuqizonte njerëzit me informacion të besueshëm" dhe "do t'u jepte atyre kontekst të rëndësishëm në lidhje me përmbajtjen" gjatë zgjedhjeve parlamentare në Moldavi më 28 shtator 2025, shihni <https://newsroom.tiktok.com/ro-md/protecting-the-integrity-of-tiktok-during-the-parliamentary-elections-in-moldova>.

Në fillim të pushtimit të Ukrainës nga Rusia, disa platforma patën njoftuar se do ta rrisnin dallimin e faqeve autoritare të lajmeve, ndërkohë që do ta kufizonin, përmes kufizimeve algoritmike, dallimin e faqeve propaganduese ruse të mbështetura nga shteti.¹⁴⁴ Megjithëse këto masa synonin mbrojtjen e integritetit të informacionit, ato u zbatuan shpesh në mënyrë *ad hoc*, jo-transparente dhe arbitrare, ndërsa shpërndarja e burimeve dhe prioritetet e politikave u ndikuan më shumë nga madhësia e tregut dhe konsideratat ekonomike e të reputacionit, sesa nga vlerësimet gjithëpërfshirëse të rrezikut.¹⁴⁵ Masat e tilla specifike për situata krizash janë thelbësore duke mbajtur parasysh rëndësinë e shtuar të qasjes në informacionin në interes publik në rrethana të tilla, megjithatë qeverisja e përmbajtjes e bazuar në të drejtat e njeriut duhet të aplikohet në mënyrë të vazhdueshme, jo vetëm në situata krizash. **Masat e marra për situata krizash dëshmojnë se kompanitë e mëdha të teknologjisë janë në gjendje ta ri-kalibrojnë renditjen algoritmik, duke e zhvendosur theksin nga angazhimi tek saktësia, kur e shohin të arsyeshme për arsye politike, komerciale ose të reputacionit.**

Politikat ekzistuese për dallimin

Tabela në vijim paraqet një përmbledhje të masave që, në forma të ndryshme, parashohin **trajtim të veçantë për mediat dhe përmbajtjen mediatike në interes publik**. Disa prej këtyre dispozitave nuk kanë hyrë (akoma) në fuqi, kurse tjerat janë masa opsionale që platformat mund t'i ndërmarrin për të adresuar rreziqe të tilla si dezinformimi.

¹⁴⁴ Shihni për shembull, Google Safety, "Qasja e Google ndaj luftimit të keqinformimit në rrjet." https://safety.google/intl/en_us/stories/fighting-misinformation-online dhe Meta Transparency Centre, "Përpijekjet e vazhdueshme të Meta sa i përket pushtimit të Ukrainës nga Rusia." (26 shkurt 2022), <https://about.fb.com/news/2022/02/metaspending-efforts-regarding-russias-invasion-of-ukraine/>; Meta, "Qasja jonë ndaj përmbajtjes me vlerë lajmi." (12 nëntor 2024), <https://transparency.meta.com/features/approach-to-newsworthy-content/>. Për një përmbledhje të veprimeve të ndërmarrura në përgjigje të pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës nga Rusia, shihni Human Rights Watch, "Rusia, Ukraina, rrjetet sociale dhe aplikacionet e mesazheve". (mars 2022), <https://www.hrw.org/news/2022/03/16/russia-ukraine-and-social-media-and-messaging-apps#table-1>.

¹⁴⁵ Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, *Qeverisja e platformave dhe përmbajtjes në kohë krizash*. (2023), https://www.osce.org/files/f/documents/2/4/564961_0.pdf dhe Access Now, "Qeverisja e përmbajtjes në kohë krizash: si mund t'i mbrojnë platformat të drejtat e njeriut" (2022), <https://www.accessnow.org/publication/new-content-governance-in-crises-declaration>

Rregullimi	Fushëveprimi	Politika e dallimit
AELM, Neni 18	Ofruesit e shërbimeve mediatike	Kufizime në moderim
ASO e MB-së, Neni 17	Përmbajtje me rëndësi demokratike	Kufizime në moderim
ASO e MB-së, Neni 18 (i mundshëm)	Përmbajtja e botuesit të lajmeve	Kufizime në moderim
ASO e MB-së, Neni 19	Përmbajtje gazetareske	Kufizime në moderim
Traktati i landeve gjermane mbi mediat, Neni 94	Ofertat gazetareske të redaksive	Detyrim për mosdiskriminim
Akti kanadez për lajmet në rrjet, Neni 51	Bizneset e lajmeve	Detyrim për mosdiskriminim
Kodi i sjelljes kundër dezinformimit sipas ADSH-së, masa 22.2	Burime mediatike të besueshme	Kontroll i përdoruesit mbi rekomandimet
Kodi australian i negocimit për mediat e lajmeve, 52ZC	Biznese lajmesh të regjistruara	Detyrim për mosdiskriminim
Kodi australian i praktikës mbi dezinformimin dhe keqinformimin 4.4	Lajme profesionale	Përjashtim nga përkufizimi i keqinformimit (por jo nga IA i dezinformimit)
Kodi australian i praktikës mbi dezinformimin dhe keqinformimin 5.9K dhe 5.22C	Burime e lajmesh	Përparësi dhe transparencë në lidhje me besueshmërinë ose burimin, përfshirë treguesit e besimit

Tabela 2. Masat që parashohin trajtim të veçantë për përmbajtjen mediatike dhe në interes publik

Shembull tjetër, në këtë rast vullnetar, i integritit të faktorëve të interesit publik ose besueshmërisë në renditjen algoritmike të përmbajtjes është përmbledhësi i lajmeve i vetë *Google*. Në seksionin **Google News**, motori i kërkimit **zbaton një peshim ndryshe** të sinjaleve të “**duhur**” që nga sa raportohet i jep më shumë përparësi saktësisë,

besimit të përmbajtjes se sa angazhimit të përdoruesve.¹⁴⁶ Megjithatë, kjo qasje zbatohet vetëm për një skedë të veçantë të lajmeve dhe jo për rezultatet kryesore të kërkimit, dhe është jo-transparente në disa aspekte kyçe: nuk ka qartësi publike (e aq më pak mundësi ndikimi apo zgjedhjeje nga përdoruesit) se cilat media përfshihen, si përzgjidhen (apo përjashtohen) ose si renditen në raport me njëra-tjetrën. Kjo qasje ilustron si potencialin ashtu edhe kufizimet e rregullimeve të udhëhequra nga vetë platformat për t'i shërbyer interesit publik.

¹⁴⁶ Politikat e Google News, <https://support.google.com/news/publisher-center/answer/6204050?hl=en>, <https://www.google.com/search/howsearchworks/how-news-works/>, dhe Renditja në Google News, <https://support.google.com/news/publisher-center/answer/9606702?sjid=9931494097097045197-EU>

5.2. Masat zbutëse që synojnë promovimin e dallimin e medias në periudhën afatshkurtër

Çdo debat mbi politikat për dallimin duhet të bazohet në kriteret **për përcaktimin e interesit publik**, përfshirë gazetarinë që respekton kodet e etikës profesionale, si dhe në përcaktimin se **kush ka të drejtën e interpretimit dhe kompetencën vendimmarrëse**. Politikat për dallimin duhet të hartohen me kujdes në mënyrë që të shmanget rregullimi që, pa dashje, hap rrugë për kontroll shtetëror mbi hapësirat e informimit. Mbeten të hapura pyetje kyçe lidhur me **efektivitetin e këtyre politikave** në rritjen e besimit në gazetari dhe në pasurimin e debatit publik, si edhe lidhur me masat mbrojtëse që nevojiten për të parandaluar kapjen politike ose kapjen nga platformat dhe për të zbutur rreziqet ndaj pluralizmit të medias.

Vitet e ardhme paraqesin një **mundësi për mbledhjen e më shumë të dhënave dhe realizimin e më shumë hulumtimeve për ta krijuar bazën faktike të nevojshme për ta ulur këtë pasiguri**. Rregullore të miratuara së fundmi, siç është AELM, parashohin krijimin e proceseve të nevojshme për t'u ofruar organizatave të caktuara mediatike më shumë mbrojtje nga moderimi "arbitrar" dhe për diferencimin ndërmjet këtyre mediave dhe kategorive tjera të përmbajtjes. Njëkohësisht, rregullimi i ri i qasjes në të dhëna sipas Nenit 40 të ADSH-së u mundëson studiuesve ta kuptojnë më mirë mënyrën në të cilën platformat e bëjnë, dhe do ta bëjnë, diferencimin ndërmjet organizatave (mediatike), përmbajtjes "me

vlere lajmi” dhe kategorive të tjera të përmbajtjes. Nëse dispozitat për qasjen në të dhëna zbatohen tërësisht, këto korniza mund të prodhojnë provat e nevojshme për **hartimin e politikave të dallimit që mbështesin lirinë e medias, duke i minimizuar njëherazi rreziqet.**

Politikat për dallimin mund të kontribuojnë në zbutjen e disbalancit ekzistues të pushtetit, por nuk e kufizojnë domosdoshmërisht pushtetin e kompanive të mëdha të teknologjisë mbi shpërndarjen e lajmeve, përkundrazi rrezikojnë ta përforcojnë atë. Prandaj, politikat për dallimin duhen parë si **ndërhyrje të mundshme afatshkurtra, ndërsa përpjekjet në suazat e politikëbërjes duhet të përqendrohen edhe në ndryshime strukturore afatgjata, modele alternative shpërndarjeje dhe në ndërtimin e një ekosistemi më të shëndetshëm të informimit në rrjet** (*shihni Pjesën 8*).

Parimet e hartimit të politikave për dallimin

Qasje e shkallëzuar

- Shtetet duhet të **miratojnë politika dallimi vetëm kur ekzistojnë garanci të mjaftueshme** (siç përcaktohet më poshtë) për ta parandaluar kapjen politike ose kapjen nga platformat dhe për të zbutur rreziqet ndaj pluralizmit të medias. Politikat me shtrirje më të gjerë, si kërkesat për theksim të duhur, duhet të shoqërohen me garanci më të forta dhe me efektivitet të dëshmuar.
- Në përputhje me parimet demokratike të **kontrollit dhe balancimit reciprok**, kontrolli mbi politikat për dallimin duhet të decentralizohet gjatë tërë procesit të politikëbërjes dhe zbatimit, në mënyrë që të parandalohet kapja. Garancitë për parandalimin e ndërhyrjeve politike duhet po ashtu të sigurojnë pavarësinë politike të autoriteteve rregulluese dhe zbatuese. Më tej, garancitë kundër kapjes nga platformat duhet të përfshijnë, për shembull, shmangien e dhënies së diskrecionit të tepruar platformave për të zbatuar politikat për dallimin, si edhe shmangien e dhënies së kompetencës për të përcaktuar se cilat media kualifikohen për trajtim të veçantë.

Pavarësi dhe decentralizim

- Politikat për dallimin duhet të hartohen (dhe vlerësohen) në suaza të një **procesi shumëpalësh**, gjatë të cilit merren parasysh edhe pikëpamjet e organizatave mediatike më të vogla dhe lokale.
- Vendimet se cilat organizata kualifikohen për politika dallimi nuk duhet të merren as nga platformat, as nga institucionet shtetërore, por në kuadër të **proceseve të pavarura të vetë rregullimit të mediave**. Përkundrazi, shtetet duhet të mëtojnë decentralizimin e pushtetit mbi këto vendime. Kjo mund të arrihet duke mundësuar përdorimin e standardeve të ndryshme për njohjen e pavarësisë e redaksisë, dhe duke pranuar dëshmi të historikut të organizatave mediatike në publikimin e përmbajtjes së pavarur, të besueshme dhe në interes publik (p.sh. anëtarësimi në kode etike ose këshilla kombëtare të shtypit). Në kontekste ku këto kode ose organe janë të kapura nga grupe politikisht të anshme, duhet të merren parasysh tregues tjerë të pavarur, si pjesëmarrja në rrjete ndërkombëtare të pavarura, politikat e redaksisë transparente dhe sinjalet e tjera të pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare. Vendimet që lidhen me cilësinë duhet përfundimisht t'i nënshtrohen mbikëqyrjes gjyqësore.
- Politikat e dallimit duhet të zbatohen nga **rregullatorë të pavarur**.¹⁴⁷

Pluralizëm

Politikat e dallimit duhet të hartohen në mënyra që ta forcojnë, e jo ta minojnë, larminë dhe pluralizmin.

- Kriteret e kualifikimit për politika dallimi duhet të jenë mjaftueshëm fleksibile për të akomoduar një gamë të gjerë aktorësh mediatik, nga gazetarët individualë deri te organizatat të mëdha mediatike. Çdo politikë dallimi duhet të synojë përmirësimin e qasjes së individëve në një **shumësi** mediash të pavarura.

¹⁴⁷ Është thelbësore që çdo autoritet rregullator që merret me qeverisjen e platformave të jetë i strukturuar si i pavarur, i mbrojtur nga interesat politike dhe ekonomike dhe të ketë sisteme të shqyrtimit të jashtëm në vend. Për informacion të mëtejshëm, shihni paragrafët 68-73 të Udhëzimeve të UNESCO-s për qeverisjen e platformave digjitale, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000387339>.

- Procedurat e kualifikimit për politika dallimi duhet të jenë **lehtësisht** të arritshme dhe të mos jenë kufizuese. Kjo do të thotë se ato nuk duhet të jenë aq të kushtueshme, të ngarkuara me kërkesa ose të gjata saqë aktorët më të vegjël të mos arrijnë t'i përdorin në praktikë.
- Politikat për dallimin duhet të hartohen në një mënyrë që përfitimet që ofrojnë të jenë të arritshme edhe për **mediat më të vogla dhe lajmet lokale**. Mungesa e burimeve nuk duhet të jetë pengesë për të përfituar nga politikat e dallimit.

Mbikëqyrje

Transparenca është kyçe për të siguruar legjitimitetin demokratik të politikave për dallimin, për të parandaluar kapjen dhe për të garantuar që efektiviteti i masave të jetë mund të shqyrtohet nga një gamë e gjerë aktorësh. Pa transparencë, është e pamundur që rregullatorët, studiuesit dhe mbikëqyrësit publikë, siç janë mediat ose organizatat e shoqërisë civile, të ushtrojnë mbikëqyrje efektive të politikave për dallimin. Për ta arritur këtë:

- **të dhënat** e nevojshme për shqyrtimin e politikave të dallimit duhet, për aq sa të jetë e mundur, të jenë të **publikisht të qasshme**;
- **vendimet** për pranim ose refuzim të organizatave të caktuara mediatike duhet të jenë publikisht të qasshme, të shoqërohen me arsyetim të qartë lidhur me përmbushjen e kriterëve të ndryshme të kualifikimit dhe të jenë të ankimeshme (përfshirë edhe rastet kur rrethanat ndryshojnë);
- shtetet duhet të sigurojnë disponueshmërinë e të dhënave të nevojshme për **vlerësimin e ndikimit** të politikave të dallimit, përfshirë kriteret që përdoren për ta prioritetizuar përmbajtjen ose organizatat (dhe mënyrën e peshimit të tyre), cilët aktorë kanë përfituar dhe çfarë përfitimesh kanë marrë (p.sh. angazhim më të lartë të përdoruesve ose mekanizma më efektive ankimeshmëri ndaj moderimit). Çdo prioritetizim vullnetar i “përmbajtjes autoritare” nga platformat duhet të shoqërohet me publikimin e përfitimeve konkrete që i jepen kësaj përmbajtjeje dhe të jetë i bazuar në krit-

ere të përcaktuara qartë e të qasshme publikisht (përfshirë çdo ndryshim të tyre).

Zbatim

Duke mbajtur parasysh kufizimet e vetërregullimit ekzistues të platformave dhe mospërputhjen e stimujve, shtetet duhet të sigurojnë që zbatimi i politikave për dallimin të mbështetet nga një mekanizëm publik i besueshëm zbatimi (për rekomandime të hollësishme lidhur me zbatimin, shihni Pjesën 8.2). Me kushtin që të ketë garanci të mjaftueshme kundër kapjes, normat si rregullat për vlerësim të rrezikut të parapara në nenet 34-35 të ASHD-së mund të shërbejnë si udhërrëfyes për vendosjen e masave shtesë të dallimit në periudhën afatshkurtër.

Garancitë

Politikat për dallimin nuk janë **zgjidhje universale e zbatueshme për të gjitha kontekstet**. Potenciali i tyre për të mundësuar debat demokratik të mirëfilltë, duke i dhënë publikut më shumë kontroll mbi mënyrën se si informacioni kurohet dhe shpërndahet në ekosistemin digjital, shoqërohet edhe me rreziqe. Ato mund të ndikojnë në mënyrën se si platformat ushtrojnë pushtetin e tyre filtrues mbi lajmet, madje rrezikojnë të shpërfaqin forma të tjera të këtij kontrolli. Pikërisht këto forma të reja kontrolli janë ajo çfarë i bën politikat e dallimit potencialisht të rrezikshme për lirinë e medias, veçanërisht në kontekste ku sundimi i ligjit dhe pavarësia e organeve rregulluese janë të pamjaftueshme.

Politikat e dallimit të përshtatshme për miratim të gjerë

Politikat për dallimin që janë të përshtatshme për miratim të gjerë janë ato që synojnë rritjen e transparencës, ndërveprueshmërisë dhe fuqizimit të përdoruesve, por që nuk kërkojnë krijimin e një procesi për të përcaktuar se cilat përmbajtje specifike ose organizata mediatike do të përfitojnë nga trajtimi preferencial. Këto politika përfshijnë:

- **Transparencën:** Transparenca është e nevojshme për t'i mundësuar publikut të kuptojë se si përcaktohet dallimi. Këtu përfshihet transparenca e parametrave të sistemeve të rekomandimit, politikave

të moderimit dhe vendimeve të moderimit, si dhe çdo priorizitim të “përmbajtjes autoritare” në baza vullnetare nga platformat.

• **Fuqizimin e përdoruesve dhe ndërveprueshmërinë:**

- Shtetet duhet t’u kërkojnë platformave që t’u **mundësojnë aktorëve të shumtë të ofrojnë sisteme rekomandimi**, nga mesi i të cilëve përdoruesit mund të zgjedhin sipas nevojave të tyre, qoftë për lajme në kohë, burime të besueshme, pikëpamje të ndryshme apo përmbajtje të orientuar më shumë kah argëtimi. Për ta ulur rrezikun që përdoruesit të vazhdojnë së përdoruri sistemin e parazgjedhur të rekomandimit, mund të parashihet që platformat t’u kërkojnë përdoruesve të zgjedhin nga mesi i opsioneve të ndryshme.¹⁴⁸ Këto ndërhyrje duhet të **sigurojnë ndërveprueshmërinë teknike** të veglave të tilla. Duke decentralizuar kontrollin mbi mënyrën se si shfaqet përmbajtja, masat e tilla rrisin jo vetëm autonominë e përdoruesit, por edhe ulin rreziqet që diskursi publik të formësohet ekskluzivisht nga algoritme jo-transparente të udhëhequra nga interesa komerciale. Në këtë kuadër, lejimi i **zgjidhjeve ndërmjetëse**, si p.sh. vegla ose shërbime të pavarura të palëve të treta që veprojnë si ndërmjetës mes përdoruesve dhe algoritmeve të platformës, mund të krijojë një shtresë të personalizuar që e forcon autonominë e përdoruesit dhe nxit larminë, si dhe konsideratat e interesit publik.
- Për ta rritur **gjetjen**, shtetet mund t’u kërkojnë platformave që t’u ofrojnë përdoruesve opsione të ndryshme sistemesh rekomandimi që i ekspozojnë ata ndaj përmbajtjes së larmishme dhe gazetarisë së pavarur, ose të krijojnë seksione të veçanta në kuadër të shërbimit të tyre ku përdoruesit mund të gjejnë gazetari në interes publik. Megjithatë, një qasje e tillë duhet gjithsesi të shoqërohet me një proces të përcaktimit se cilat organizata mediatike, ose cilat lloje përmbajtjeje, kualifikohen për këtë kategori. Si alternativë, shtetet mund t’u kërkojnë platformave që t’u mundësojnë përdoruesve t’i ndryshojnë parametrat e përgjithshëm të renditjes së përmbajtjes në sistemet e rekomandimit.

¹⁴⁸ Forumi për Informacion dhe Demokraci, *Pluralizmi i lajmeve dhe informacionit në algoritmet e kurimit dhe indeksimit*. (shkurt 2024), https://informationdemocracy.org/wp-content/uploads/2023/02/Report_Pluralism-in-algorithms.pdf

- **Vendosja e të drejtave të njeriut në qendër të miratimit dhe zbatimit të politikave:** Shtetet duhet të sigurojnë që garancitë ekzistuese të lirisë së shprehjes, të tilla si rregullat e vlerësimit të rrezikut, kujdesi i duhur për të drejtat e njeriut dhe kriteret për moderim të përmbajtjes, të zbatohen me rigorozitet. Duke e ngritur pragun e përgjithshëm të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, masat e tilla e mbrojnë në mënyrë të tërthortë edhe lirinë e medias. Në veçanti, rregullat që e zhvendosin theksin e priorizimit algoritmik nga sinjalet e bazuara në angazhim drejt treguesve të autenticitetit dhe besueshmërisë do ta zbusnin dëmin, duke e ulur në renditje përmbajtjen që, ndonëse tërheqëse, është problematike.

Politikat e dallimit që duhet të shoqërohen me garanci shtesë

Politika të mëtëjshme për dallimin duhet të zbatohen vetëm kur ekzistojnë garanci të fuqishme që kufizojnë ndikimin e tyre të mundshëm negativ në pluralizmin e medias dhe ulin rrezikun e kapjes qoftë nga platformat, qoftë nga interesat politike. Këto garanci duhet të marrin parasysh jo vetëm mjedisin aktual politik në një shtet të caktuar, por edhe rreziqet e regresit demokratik.

Varësisht nga kapacitetet institucionale dhe shkalla e rendit ligjor në secilin shtet, politikat e dallimit me shtrirje më të gjerë mund të përfshijnë:

- **Mos diskriminimin:** Për të parandaluar diskriminimin dhe hakmarrjen ndaj organizatave të caktuara mediatike, shtetet duhet të vendosin rregulla mos diskriminimi që përcaktojnë zbatim konsistent të politikave të moderimit dhe që ndalojnë devijimin prej tyre pa arsye objektive të justifikueshme.
- **Moderimin:** Shtetet mund të miratojnë rregulla për parandalimin e largimit arbitrar të përmbajtjes në interes publik, përfshirë procedura moderimi me udhëzime të qarta, mekanizma ankimi dhe mekanizma shqyrtimi të pavarur.
- **Theksimin e duhur:** Shtetet mund ta marrin në konsideratë vendosjen e detyrimeve për platformat që ta renditin më lart përmbajtjen gazetareske në sistemet e tyre të rekomandimit, me qëllim rritjen e qasjes

së qytetarëve në informacion të besueshëm. Në mënyrë që kjo masë të mbështesë siç duhet qasjen në burime pluraliste, të pavarura dhe në interes publik, ajo duhet të shoqërohet me garanci të mjaftueshme kundër kapjes.

- **Normat e vlerësimit të rrezikut:** Shtetet mund të shqyrtojnë se si të përdorin legjislacionin kombëtar ekzistues për pluralizmin e medias, standardet ndërkombëtare për vlerësimet e rreziqeve ndaj të drejtave të njeriut, ose normat e zbatueshme në nivel rajonal për vlerësim të rrezikut, si nenet 34-35 të ASHD-së, për të vendosur masa dallimi në periudhën afatshkurtër dhe për ta përafëruar administrimin e përmbytjes më shumë me interesin publik. Këto “rregulla të hapura” nuk përcaktojnë një masë konkrete të vetme, përkundrazi u japin shteteve mundësi që të vendosin detyrime të ndryshme në bazë të këtyre dispozitave. Në këtë kuadër, qasjet politike dhe rregulluese mund të parashohin që platformat të integrojnë kritere që forcojnë pluralizmin, siç janë larmia e burimeve, besueshmëria dhe rëndësia për debatin demokratik, duke ndihmuar në uljen e dominimit të algoritmeve që maksimizojnë angazhimin në dëm të mediave në interes publik. Në një qasje të tillë, nevoja për garanci kundër kapjes politike ose kapjes nga platformat është e një rëndësie vendimtare.

IA prodhuese: Shtetet duhet të shqyrtojnë se në ç’ mënyrë mund t’i përshtatin politikat për dallimin për t’i zbatuar edhe ndaj përmbytjes së prodhuar me anë të IA prodhuese. Në periudhën afatshkurtër, shtetet duhet të vendosin detyrime për të siguruar që përmbytja e prodhuar nga IA, si rregull, të përmbyjë lidhje të burimeve origjinale të lajmeve dhe të parashohin masa për të siguruar pluralizmin mediatik. Këto masa duhet të përfshijnë edhe garanci për reputacionin e mediave, si p.sh. kanale të posaçme për trajtimin e ankesave dhe shqyrtimin e tyre në kohë të arsyeshme.¹⁴⁹

¹⁴⁹ Forumi për Informacion dhe Demokraci, *IA si një e mirë publike: sigurimi i kontrollit demokratik të IA-së në hapësirën e informacionit* (Shkurt 2024).

Meqë qasja në lajme lidhet ngushtë me stabilitetin financiarë të mediave në kuptimin e shtrirjes të audiencës dhe gjenerimit të të ardhurave, **politikat për dallimin, qofshin të drejtpërdrejta apo të tërthorta, përfundimisht i shërbejnë qëndrueshmërisë financiare të mediave.**

Politikëbërësit duhet të kenë parasysh se **problemi nuk qëndron vetëm te mënyra se si platformat e ushtrojnë pushtetin e tyre kontrollues, por edhe te fakti që ato kanë pushtet kaq të madh.**

Ky problem nuk mund të zgjidhet vetëm me politika dallimi, përkundrazi politikat e tilla mund ta thellojnë varësinë nga platformat për dallimin dhe të ardhura. Kufizimet në të ardhura mund t'i frenojnë investimet në risi ose krijimin e kanaleve alternative të shpërndarjes dhe të raporteve të drejtpërdrejta me audiencën. Prandaj, për krijimin e ekosistemeve të shëndetshme të informimit lipset të krijohet infrastrukturë alternative ku mediat të mos varen nga platformat e mëdha të teknologjisë për të arritur të audiencën. *(Kjo çështje shtjellohet më gjerësisht në Pjesën 8.)*

VIABILITY

VIABILITY

VIABILITY

VIABILITY

VIABILITY

VIABILITY

6. Stabiliteti Financiar i Mediave

Në këtë pjesë paraqitet një pasqyrë e shkurtër e instrumenteve të politikave që synojnë të mbështesin stabilitetin financiar të gazetarisë. Fillimisht, shqyrtohen përpjekjet rregulluese që shtetet kanë ndërmarrë në këtë drejtim dhe mësimet e nxjerra nga përvojat e tyre. Më pas, jepen rekomandime se si shtetet mund të promovojnë kompensimin e drejtë dhe të forcojnë stabilitetin financiar të gazetarisë në interes publik në epokën digjitale.

6.1 Nismat e politikave dhe rregullave për t'i detyruar platformat që të paguajnë kompensim për gazetarinë

Të përballura me humbje të mëdha të shkaktuara nga zhvendosja e të ardhurave nga reklammat drejt reklamimit të synuar dhe reklamimit programatik të ofruar nga kompanitë dominuese të teknologjisë, për vite me radhë organizatat mediatike kanë kërkuar dhe testuar mënyra të reja për të rritur të

ardhurat dhe për ta forcuar stabilitetin financiar. **Shumë media po orientohen drejt modeleve të abonimit ose mbështetjes në kontribute nga audienca.** Këto modele shpesh shoqërohen me “paywall” (pagesa, të plota, të pjesshme ose me kuota), që rrezikojnë ta kufizojnë qasjen në informacionin në interes publik për disa kategori të publikut. Raporte dhe analiza të shumta evidentojnë si shembuj burimesh jo-tradicionale të të ardhurave edhe donacionet, organizimin e ngjarjeve, shitjen e produkteve promovionale, dhe zhvillimin e strategjive të reja të shpërndarjes digjitale dhe të modeleve të ndërtimit të komunitetit.¹⁵⁰ Në disa raste, mediat shpresojnë ta përmirësojnë stabilitetin financiar përmes krijimit të sinergjive, përfshirë përmes bashkëpunimeve me influencues ose me vetë platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë. Megjithatë, shumë media të lajmeve kanë pasur vështirësi në tërheqjen e abonentëve, veçanërisht të brezave të rinj që janë distancuar nga markat dhe formatet tradicionale të lajmeve.¹⁵¹

Nga ana tjetër, **bollëku i informacionit që shpërndahet përmes platformave në rrjet ka çuar në mbingarkesë informacioni**¹⁵² dhe çrregullim informativ.¹⁵³ Shmangia e lajmeve dhe rënia e besimit te mediat, por edhe fakti se përmbajtja e lajmeve qaset shpesh falas në platforma, e kanë ulur gatishmërinë për të paguar për lajme në rrjet si shenjë vlerësimi për gazetarinë.¹⁵⁴ Kufizime të theksuara ekzistojnë po ashtu edhe te modelet e biznesit që mbështeten në financimin nga

¹⁵⁰ Shihni për shembull: K. Bleyer-Simon dhe të tjerë, *Monitorimi i pluralizmit mediatic në epokën digjitale: Zbatimi i monitorit të pluralizmit të mediave në shtetet anëtare evropiane dhe në vendet kandidatë në vitin 2023*. Instituti Universitar Evropian (qershor 2024), <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/d66622e8-4fb4-11ef-acbc-01aa75ed71a1> dhe Këshilli i Evropës, *Praktika të mira për financimin e qëndrueshëm të mediave të lajmeve*. (2024), <https://edoc.coe.int/en/media/11879-good-practices-for-sustainable-news-media-financing.html>.

¹⁵¹ Shihni, për shembull, Raportin e Institutit të Reuters mbi lajmet digjitale.

¹⁵² A. Holton dhe H. I. Chyi, “Lajmet dhe konsumatori i mbingarkuar: Faktorët që ndikojnë në mbingarkesën e informacionit tek konsumatorët e lajmeve. Tek *Cyberpsychology, Behavior and Social Networking*, Vëll. 15, Nr. 11 (2012), https://www.researchgate.net/publication/231610553_News_and_the_Overloaded_Consumer_Factors_Influencing_Information_Overload_Among_News_Consumers; Shihni edhe raportet e Institutit të Reuters mbi lajmet digjitale.

¹⁵³ C. Wardle dhe H. Derakhshan, *Çrregullimi i informacionit: Drejt një kuadri ndërdisiplinor për kërkimin dhe hartimin e politikave*. Raport i Këshillit të Evropës DGI (2017)09, <https://edoc.coe.int/en/media/7495-information-disorder-toward-an-interdisciplinary-framework-for-research-and-policy-making.html>

¹⁵⁴ Observatori për Informacione Demokratike, *Ekosistemet e informacionit dhe demokracia e trazuar - një sintezë botërore për gjendjen e njohurive mbi mediat e lajmeve, IA dhe qeverisjen e të dhënave*. (janar 2025), https://observatory.informationdemocracy.org/wp-content/uploads/2025/06/rapport_forum_information_democracy_2025-1.pdf

audienca përmes abonimeve, meqë përdoruesit që blejnë abonime zakonisht kufizohen në një ose disa media kryesore kombëtare. Për më tepër, abonimet blihen shpesh nga individë me të ardhura dhe arsimim më të lartë, gjë që ngre shqetësime se mund të thellohen pabarazitë dhe polarizimi ekzistues shoqëror. Sidoqoftë, modelet e abonimit mund ta rrisin pavarësinë nga modelet e reklamimit që kontrollohen nga platformat e kompanive të mëdha teknologjike dhe të zbusin disa nga pasojat negative të modeleve aktuale të të ardhurave.

Praktikat dhe modelet risi që mediat i zhvillojnë në mënyrë vetjake nuk mjaftojnë për ta kundër balancuar krizën e modeleve tradicionale të biznesit ose pushtetit e platformave të kompanive të mëdha teknologjike. Mundësitë për risi janë shpesh të arritshme vetëm për një segment të vogël, zakonisht media tërësisht digjitale ose media më të mëdha, meqë për risi nevojiten investime dhe burime njerëzore të kualifikuara. Duke e njohur vlerën demokratike dhe publike të pazëvendësueshme të mediave të fuqishme, të pavarura dhe pluraliste si e mirë publike, shtetet duhet të mundësojnë konkurrencë të ndershme dhe qasje të pandërprerë në informacion të besueshëm për tërë shoqërinë. **Për media dhe gazetari të qëndrueshme nevojiten burime të diversifikuara financimi,¹⁵⁵ përfshirë shërbime risi me vlerë të shtuar ose programe mbështetjeje publike të drejtpërdrejta ose të tërthortë. Shtetet duhet të sigurojnë një shpërndarje më të drejtë të të ardhurave nga reklammat që platformat e kompanive të mëdha teknologjike nxjerrin nga shpërndarja dhe vlerësimi i përmbajtjes gazetareske në shërbimet e tyre.**

Anëmbanë globit, shtetet po miratojnë ligje dhe po zbatojnë masa për t'i adresuar pabarazitë e theksuara të tregut dhe pushtetit që rrezikojnë stabilitetin financiar të mediave. **Në këtë pjesë paraqitet një pasqyrë e shkurtër e përpjekjeve rregulluese dhe të politikave që synojnë sigurimin e kompensimit të drejtë për shpërndarje, përdorim dhe vlerësim të përmbajtjes mediatike nga platformat e kompanive të mëdha teknologjike,** si dhe e mekanizmave të tjerë të politikave që synojnë forcimin e qëndrueshmërisë financiare.

¹⁵⁵ Këshilli i ekspertëve për rritjen e reziliencës së mediave (MSI-RES), *Praktika të mira për financimin e qëndrueshëm të mediave të lajmeve*. Këshilli i Evropës (2024), <https://edoc.coe.int/en/media/11879-good-practices-for-sustainable-news-media-financing.html>

Tabela e mëposhtme i përvijon mekanizmat më të spikatur të politikave që janë në shqyrtim ose janë tashmë në fuqi. Si te modelet e taksës digjitale, ashtu edhe skemat më tradicionale të subvencionimit, shtrohet pyetja sa fonde dhe subvencione duhen ndarë për ta mbështetur sektorin e mediave dhe gazetarinë.

Mekanizmi i politikave	Shembuj
Konkurrenca dhe antitrusti	Hetimet sipas ATD-së së BE-së (2024/2025) Vendimet e SHBA-së kundër Google lidhur me kërkimin (2024) dhe reklamimin në rrjet (2025)
Të drejtat e autorit	Të drejtat e përafërta për botuesit e shtypit sipas Direktivës së BE-së për të drejtat e autorit (2020) Projektligji brazilian për IA që parasheh kompensim për përmbajtjen mediatike (2024)
Kompensimi - Negocimi dhe shpërblimi	Kodi i negocimit të mediave të lajmeve të Australisë (2021) Akti për lajmet në rrjet i Kanadasë (2023) Marrëveshjet për kompensimin e lajmeve në Kaliforni (2024)
Taksat digjitale (me mbështetje të destinuar për mediat)	Taksa e reklamimit digjital e Austrisë (2020)

Tabela 3. Mekanizmat e politikave që janë aktualisht në shqyrtim ose në fuqi në shtete të ndryshme të botës

Konkurrenca dhe anti-trusti

Gjatë dekadës së fundit janë zhvilluar disa hetime anti-trust për shkak të **dominimit të platformave të kompanive të mëdha teknologjike në ekosistemin bashkëkohor të informacionit**. Në të njëjtën kohë, ligji për mbrojtjen e konkurrencës **mund të shndërrohet edhe në pengesë për bashkëpunimin** ndërmjet organizatave mediatike, duke e ngushtuar hapësirën për shkëmbimin e përmbajtjes dhe informacionit dhe duke kufizuar mundësitë për veprim kolektiv në përcaktimin e çmimeve dhe në negocimin me platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë. Sidoqoftë, kohëve të fundit po vërehet një prirje drejt

zbutjes së rregullave kundër përqendrimit në sektorin e medias, duke i balancuar rreziqet e lidhura me përqendrimin me nevojën themelore që mediat të bashkojnë forcat për ta ruajtur stabilitetin financiarë. Kjo prirje pasqyrohet në Aktin evropian për lirinë e medias (AELM), që e trajton përqendrimin në raport me implikimet e tij në autonominë e redaksisë të mediave dhe dinamikën e platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë. Akti njeh faktin se përqendrimi i tepruar i mediave mund të jetë i dëmshëm për vetë pluralizmin e mediave.

Politikat antitrust dhe të konkurrencës po përdoren në tregjet kryesore si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian dhe disa nga shtetet e tij anëtare, për ta ribalancuar pushtetin në tregjet digjitale, me synim rivendosjen e një rregullave të barabarta për mediat dhe kompanitë e mëdha të teknologjisë.¹⁵⁶ Ligjet ekzistuese antitrust po përdoren për të hetuar dhe rregulluar kompanitë e mëdha të teknologjisë, përmes masave zbatuese që fokusohen te praktikatat monopoliste dhe dominimi i tregut. Krahas kësaj, janë miratuar edhe ligje të reja të konkurrencës, siç është Akti i BE-së për tregjet digjitale. Që kur ky akt hyri në fuqi në vitin 2022, Komisioni Evropian ka nisur disa hetime të praktikave anti-konkurrese të kompanive të mëdha të teknologjisë që kanë rezultuar në konstatim mos pajtueshmërie në rastin e *Apple* dhe *Meta* për faktin se veprimet e këtyre të fundit kishin thelluar varësinë e përdoruesve afaristë dhe konsumatorëve nga platformat e tyre.¹⁵⁷ Në SHBA, në 2024 dhe 2025, gjykatat vendosën se *Google* kishte vepruar në mënyrë të kundërligjshme për ta ruajtur dominimin në treg, përfshirë në fushën e kërkimit dhe reklamimit në rrjet. Vendimi në fjalë u rreshtua me qëndrimin e Departamentit të Drejtësisë të SHBA-së dhe konstatoi se *Google* ishte angazhuar në taktika anti-konkurrese

¹⁵⁶ Në gusht të vitit 2025, *Amnesty International* u bëri thirrje shteteve – bazuar në detyrimin e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për të respektuar, mbrojtur dhe përbushur të drejtat e njeriut – që të rregullojnë kompanitë e mëdha të teknologjisë dhe të përdorin ligjin e konkurrencës dhe masa të tjera “për të mbajtur nën kontroll pushtetin e korporatave”. Raporti i tyre “Ndarja me kompanitë e mëdha të teknologjisë” thekson se ndikimi i jashtëzakonshëm që disa gjigantë të teknologjisë kanë mbi infrastrukturën, shërbimet dhe normat e jetës në rrjet të njerëzve bie ndesh me të drejtat e njeriut, veçanërisht pasi ato mbështeten në mbikëqyrje të përhapur, dhe ofron një argument të bazuar në të drejtat e njeriut për të trajtuar pushtetin e kompanive të mëdha të teknologjisë mbi tregun. Shihni <https://www.amnesty.org/en/documents/POL30/0226/2025/en/>.

¹⁵⁷ Komisioni Evropian, “Komisioni konstaton se *Apple* dhe *Meta* kanë shkelur aktet për tregje digjitale”, Komunikatë për shtyp (23 prill 2025), https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_25_1085

për krijim monopoli, si blerjet dhe praktikat përjashtuese, duke i dëmtuar botuesit dhe tregun konkurrues të reklamimit në rrjet.¹⁵⁸

E drejta e autorit

Për të siguruar kompensim të drejtë për përdorimin e përmbajtjes gazetareske nga platformat, janë bërë përpjekje për forcimin e **mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave autoriale**. Një zhvillim i rëndësishëm rregullator në këtë drejtim ishte krijimi i një të drejte të re të përafërt për botuesit e shtypit në kuadër të **Direktivës së BE-së për të drejtën e autorit** në vitin 2020, që ua njeht botuesve të shtypit të themeluar në BE të drejtën për të autorizuar përdorimin, riprodhimin dhe vënien në dispozicion në rrjet për publikun të përmbajtjes së tyre, si dhe për të kërkuar të ardhura nga ky përdorim. Meqë është direktivë, ajo nuk zbatohet drejtpërdrejt në shtetet anëtare të BE-së, por secili shtet duhet ta transpozojë atë në ligjin kombëtar dhe ka një shkallë diskrecioni në mënyrën e zbatimit. Si e tillë, Direktiva krijon bazën për negociim të kompensimit të drejtë për përdorimin në rrjet të botimeve të shtypit nga platformat e mëdha në rrjet. Megjithatë, ajo është vlerësuar si e pamjaftueshme për t'i adresuar asimetritë e pushtetit në treg dhe prandaj, nuk mund ta garantojë më vete të drejtën e autorit të botuesve të shtypit dhe të drejtën e publikut për informim.¹⁵⁹ Zbatimi i hershëm i Direktivës është përcjellë me fragmentim në transpozimet kombëtare dhe vështirësi në negociim, veçanërisht sa i përket qasjes, përfaqësimit (sidomos të gazetarëve dhe botuesve më të vegjël të lajmeve), transparencës dhe efektivitetit.¹⁶⁰ Në disa raste ka pasur edhe përplasje me platformat si, për shembull, në Republikën Çeke, ku *Google* dhe *Meta* ndaluan në tërësi shfaqjen e fragmenteve përmbledhëse të lajmeve pas një

¹⁵⁸ Deklaratë nga Departamenti i Drejtësisë i SHBA-së (17 prill 2025), <https://www.justice.gov/opa/pr/department-justice-prevails-landmark-antitrust-case-against-google>. Për vendimin, shihni <https://law.justia.com/cases/federal/district-courts/virginia/vaedce/1:2023cv00108/533508/1410/>. Shihni edhe D. McCabe, "Google theu ligjin për ta ruajtur monopolin e vet në tregun e reklamave, vendos një gjykatës." *The New York Times* (17 Prill 2025), <https://www.nytimes.com/2025/04/17/technology/google-ad-tech-antitrust-ruling.html>. Për vendimin e dytë, shihni <https://www.justice.gov/atr/case/us-and-plaintiff-states-v-google-llc#discovery> dhe D. McCabe, "Google është monopolist, konstaton gjykatësi në rastin e madh antitrust." *The New York Times* (5 gusht 2024), <https://www.nytimes.com/2024/08/05/technology/google-antitrust-ruling.html>

¹⁵⁹ C. Lombardi, "Rikonceptim i mbrojtjes së gazetarisë: Të shohësh përtej të drejtës së autorit" Tek *Journal of Media Law*, Vëll. 15, Nr.1 (2023), fq.90–120, <https://doi.org/10.1080/17577632.2023.2234691>

¹⁶⁰ EUI, Qendra për Pluralizmin e Medias dhe Lirinë e Medias, Monitori i pluralizmit të medias 2024, <https://cmpf.eui.eu/media-pluralism-monitor-2024/>

ndryshimi në ligjin për të drejtën e autorit, që përcaktonte se platformat duhej të pajiseshin me licencë nga mediat për përdorim për qëllime komerciale të përmbajtjes së tyre.¹⁶¹ Në Francë u arrit të lidheshin marrëveshje shumëvjeçare vetëm pasi autoriteti i konkurrencës ndërhyri në proces, duke e konsideruar refuzimin e *Google* për të negociuar në mirëbesim si abuzim me pozitën dominuese.¹⁶²

Tani që kompanitë e *IA* prodhuese po përdorin gjithnjë e më shumë përmbajtje të mbrojtur nga e drejta e autorit për qëllime trajnimi dhe zhvillimi modelesh dhe për gjenerim rezultatesh, shpesh duke e kopjuar dhe ripërpunuar këtë përmbajtje në shkallë të gjerë, çështjet e licencimit, dhënies dhe kompensimit po vijnë edhe më shumë në shprehje. **Për të siguruar mbrojtjen dhe kompensimin adekuat të mediave lipset jo vetëm zbatim më i fuqishëm i të drejtave të autorit, por edhe instrumente të reja ligjore.** Në këtë kontekst, nevojitet të sqarohet më mirë dallimi ndërmjet “përdorimit të drejtë” e përdorimit për qëllime kërkimi e zhvillimi dhe përdorimeve kryesisht për interesa komerciale.¹⁶³ Aktualisht, Brazili është i vetmi shtet me një projektligj që parasheh shprehimisht kompensim nga kompanitë e *IA* për përmbajtjen mediatike.¹⁶⁴

Nga ana tjetër, çështjet e së drejtës së autorit dhe gatishmëria e mediave për të licencuar përmbajtjen e tyre gazetareske në interes publik janë të rëndësishme edhe në raport me zhvillimin e

¹⁶¹ K. Bleyer-Simon dhe të tjerë, *Monitorimi i pluralizmit mediatik në epokën digjitale: Zbatimi i monitorit të pluralizmit të medias në shtetet anëtare evropiane dhe në vendet kandidatë në vitin 2023*. Instituti i Universitetit Evropian (qershor 2024); A. Fodor, “Google çaktivizon shfaqjen e fragmenteve të lajmeve çeke.” *Radio Ndërkombëtare e Pragës* (15 dhjetor 2022), <https://english.radio.cz/google-turns-display-czech-news-snippets-8769850>

¹⁶² Autoriteti Francez i Konkurrencës, “Të drejtat e ndërlidhura: Autoriteti gjosit *Google* me 250 milionë euro për mosrespektim të disa prej zotimeve të bëra në qershor të vitit 2022.” Njoftim për shtyp (20 mars 2024), <https://www.autoritedelaconurrence.fr/en/press-release/related-rights-authorite-fines-google-eu250-million-non-compliance-some-its>

¹⁶³ Për një pasqyrë të ndikimit të *IA*-së në të drejtat e pronësisë intelektuale të gazetarëve, shihni, për shembull, Përmbledhje politikash për Samitin e G20-ës 2025: <https://media20.org/2025/06/30/m20-policy-brief-Ais-impact-on-the-intellectual-property-rights-of-journalists> ose Përmbledhje e Parlamentit Evropian për temën: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2025/776529/IUST_BRI\(2025\)776529_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2025/776529/IUST_BRI(2025)776529_EN.pdf).

¹⁶⁴ Diskutimi për tatimin e kompanive të mëdha të teknologjisë në Brazil thekson se nuk bëhet fjalë vetëm për drejtësi ekonomike, por edhe për mbrojtjen e institucioneve demokratike dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së informacionit n; interes publik, shihni R. Lavez dhe të tjerë, *Tatimimi i kompanive të mëdha të teknologjisë dhe gazetaria: Opsionet e Brazilit*. Momentum - Task Forca për Gazetari dhe Teknologji (qershor 2025), <https://momentumnewsandtech.org/en/big-tech-taxation-and-journalism-paths-for-brazil/>.

modeleve alternative të IA-së, siç është dëshmuar në kontekstin e një modeli të madh gjuhësor në interes publik (GPT-NL) në Holandë.¹⁶⁵

Kompensimi dhe negociimi në mirëbesim

Një numër gjithnjë e më i madh ndërhyrjesh me politika, përmes mekanizmave të ndryshëm, po krijojnë ose po i bëjnë të detyrueshme negociatat ndërmjet organizatave mediatike dhe platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë për të siguruar kompensim të drejtë për përdorimin, shpërndarjen dhe vlerësimin e përmbajtjes gazetareske.

Australia

Një nga kornizat e para të negociimit në mirëbesim, që ka shërbyer si frymëzim për nisma të ngjashme në mbarë globin, ishte **Kodi australian i negociimit në mirëbesim për mediat e lajmeve**, që hyri në fuqi në mars të vitit 2021, por nuk është zbatuar akoma plotësisht edhe sot e kësaj dite. Kodi u propozua në vijimësi një hetimi të vitit 2019 nga Komisioni Australian i Konkurrencës dhe Konsumatorit (KAKK) mbi ndikimin e platformave digjitale në konkurrencën në tregjet e reklamave dhe mediave,¹⁶⁶ dhe kishte si qëllim të adresonte pabarazinë e theksuar të pozicionit negociues të bizneseve australiane të lajmeve në raport me platformat digjitale, duke kërkuar që platformat të mbështetnin stabilitetin financiar të industrisë australiane të lajmeve, përfshirë përmes marrëveshjeve për kompensim të drejtë të mediave. Në fazën fillestare, Kodi e pati efektin e synuar duke i shtyrë platformat kryesore, *Meta* dhe *Google*, të lidhnin vullnetarisht marrëveshje komerciale me organizatat e mediave të lajmeve. Nëse marrëveshje të tilla nuk mund të arrihen në baza vullnetare, parashihet mundësia e “përcaktimit zyrtar” të platformave dhe shërbimeve digjitale, çka nënkupton vendosjen e tarifave të detyrueshme ndaj tyre. Në fazën e parë, KAKK vlerësoi se vetë ekzistenca e Kodit dhe kërcënimi me përcaktim zyrtar po e prodhoni

¹⁶⁵ T. Barbereau dhe L. Dom, “GPT-NL: Drejt një modeli gjuhësor të madh në shërbim të interesit publik.” Punim për konferencë (shtator 2023), <https://www.hiig.de/wp-content/uploads/2024/09/Barbereau2024-GPTNL-1.pdf>

¹⁶⁶ Komisioni Australian i Konkurrencës dhe Konsumatorit, *Hetim mbi platformat digjitale - Raporti përfundimtar*. (korrik 2019), <https://www.accc.gov.au/inquiries-and-consultations/finalised-inquiries/digital-platforms-inquiry-2017-19>

ndikimin e synuar. Kur *Facebook* bllokoi fillimisht qasjen në lajme, u deshën disa ditë diskutime me qeverinë për ta tërhequr ndalesën. Në muajt dhe vitet në vijim, u lidhën rreth 30 marrëveshje komerciale ndërmjet *Google* dhe *Meta* dhe bizneseve australiane të lajmeve, që mbulonin rreth 100 media. KAKK autorizoi veçmas *Country Press Australia* dhe *Commercial Radio Australia* që të negocionin kolektivisht me *Google* dhe *Meta* për kompensimin e përmbajtjes së lajmeve të shfaqur në këto platforma, pa shkelur ligjet australiane të konkurrencës. Megjithatë, ndonëse në raundin e parë u arritën disa marrëveshje, *Google* dhe *Meta* shfaqën gatishmëri më të ulët për t'i vazhduar ato me afrimin e afatit të skadimit. Versioni i rishikuar i Kodit mbulon platformat digjitale që prodhojnë të ardhura mbi 250 milionë dollarë australiane në Australi, ku krahas *Meta* dhe *Google* përfshihet edhe *TikTok* (ByteDance).¹⁶⁷ Mirëpo, në vitin 2024, *Meta* nuk i rinovoi kontratat, ndërkaq *Google* uli ndjeshëm shumën e kompensimit.¹⁶⁸ Krahas kësaj, platformat i përsëritën kërcënimet se do të ndalonin shpërndarjen e lajmeve në shërbimet e tyre nëse do të “përcaktoheshin” zyrtarisht, ndërsa *TikTok* deklaroi se e konsideron veten “platformë argëtimi” dhe jo “vend ku shkohet për lajme”.¹⁶⁹ Për këtë arsye, Australia e hodhi për diskutim idenë e një takse digjitale (shihni “*Tarifat digjitale*” më poshtë).

Kanadaja

Shembulli më i avancuar i kornizës ligjore për kompensim vjen nga Kanadaja, ku **Akti për lajmet në rrjet** hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2023 me synimin që platformat dominuese t'i kompensojnë në mënyrë të drejtë bizneset e lajmeve kur përmbajtja e tyre qaset në shërbimet e këtyre platformave. Ligji krijon një kornizë negocimi në mirëbesim dhe inkurajon platformat që e bëjnë përmbajtjen e lajmeve qaset (“ndërmjetësues digjitalë të lajmeve”) të lidhin në baza vullnetare marrëveshje komerciale me bizneset e lajmeve. Nëse palët nuk mund të

¹⁶⁷ Deklaratë nga ministri i Shërbimeve Financiare (12 dhjetor 2024), <https://ministers.treasury.gov.au/ministers/stephen-jones-2022/transcripts/joint-doorstop-commonwealth-parliament-offices-sydney>.

¹⁶⁸ Nisma për Gazetari në Shërbim të Interesit Publik, “Mbështetja për Kodin e negocimit të mediave të lajmeve mbetet e fortë, por kërkohet veprim i shpejtë” (gusht 2025), <https://pji.com.au/blog/news-media-bargaining-code-supported/>.

¹⁶⁹ Shihni <https://www.bandt.com.au/tiktok-says-its-not-the-go-to-place-for-news-as-albanese-government-mulls-adding-it-to-bargaining-code/> dhe Përgjigja e *TikTok* ndaj Raportit të KAKK-së mbi çështjet e shërbimeve të rrjeteve sociale, <https://www.accc.gov.au/system/files/TikTok.pdf>.

arrijnë vetë një marrëveshje të drejtë, parashihet procesi i detyrueshëm negociimi me ndërmjetësim. Nëse, edhe pas ndërmjetësimit, palët nuk arrijnë marrëveshje, secila palë duhet të paraqesë një ofertë përfundimtare dhe një panel arbitrazhi zgjedh njërën nga dy ofertat.¹⁷⁰ Akti u prit me reagime të ashpra nga platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë. Në vend se të negocionte pagesat dhe të kompensonte botuesit e lajmeve për shpërndarjen e përmbajtjes së tyre, *Meta* e bllokoi tërësisht qasjen në lajme në *Facebook* dhe *Instagram* për përdoruesit kanadezë. *Meta* vazhdon praktikisht ta pamundësojë qasjen në lajme në Kanada edhe sot. Ndonëse fillimisht konsideroi të ndërmerre masa të ngjashme, në fund *Google* arriti marrëveshje me qeverinë. Akti për lajmet në rrjet shoqërohet me Rregulloren për përjashtime, që u mundëson platformave në rrjet të anashkalojnë negociatat e detyrueshme me bizneset individuale të lajmeve nëse arrijnë marrëveshje me një entitet kolektiv që i shpërndan fondet në mënyrë të barabartë. Pas marrëveshjes me Kolektivin Kanadez të Gazetarisë për të kontribuar 100 milionë dollarë në vit, *Google* u lirua nga negociatat individuale, me efekt nga tetori 2024.¹⁷¹

Kalifornia

Shembull tjetër i pagesave për botuesit si rrjedhojë e presionit rregullator vjen nga shteti i Kalifornisë, ku ligjvënësit **shtynë përpara idenë e vendosjes së një takse për kompanitë e mëdha të teknologjisë**¹⁷² dhe të faturimit të *Google* dhe *Meta* për lajmet që shpërndajnë.¹⁷³ Megjithatë, në fund, Kalifornia u mjaftua me një marrëveshje pesëvjeçare me *Google*, të arritur prapa dyerve të mbyllura. Kjo nismë, që potencialisht do të përfshinte edhe kompani të tjera teknologjike dhe organizata filantropike, krijoi një partneritet

¹⁷⁰ Qeveria e Kanadasë, Akti për lajmet në rrjet, <https://www.canada.ca/en/canadian-heritage/services/online-news.html>

¹⁷¹ Qeveria e Kanadasë, "CRTC miraton aplikimin e *Google* dhe përshpejton procesin e kontributit vjetor prej 100 milionë dollarësh për organizatat kanadeze të lajmeve." Njoftim për shtyp, <https://www.canada.ca/en/radio-television-telecommunications/news/2024/10/crtc-approves-googles-application-and-paves-way-for-annual-100-million-contribution-to-canadian-news-organizations.html>

¹⁷² Informacionrreth ligjeve në Kaliforni, SB-1327 Tatimi mbi të ardhurat: kreditet: media lokale e lajmeve: transaksione të nxjerrjes së të dhënave, https://leginfo.legislature.ca.gov/faces/billTextClient.xhtml?bill_id=202320240SB1327

¹⁷³ Informacionrreth legjislacionit të Kalifornisë, Akti AB-886 i Kalifornisë për ruajtjen e gazetarisë, https://leginfo.legislature.ca.gov/faces/billTextClient.xhtml?bill_id=202320240AB886

publiko-privat të quajtur Fondi për Transformimin e Lajmeve me një investim total të parashikuar prej 250 milionë dollarësh (kombinim i kontributit të *Google* dhe fondeve publike).¹⁷⁴ Ndonëse shumat që *Google* pranoi të paguante ishin vetëm një pjesë e vogël e vlerës që do të ishte paraparë nga projektligji, marrëveshja u paraqit si një arritje e rëndësishme për mbijetesën e redaksive dhe forcimin e gazetarisë lokale në mbarë shtetin.¹⁷⁵ Kritikët argumentuan se, falë lobimit, *Google* ia doli që të paguajë më pak duke e bindur qeverinë që të kontribuojë edhe ajo dhe duke krijuar paqëndrueshmëri të financimit. Marrëveshjet e arritura prapa dyerve të mbyllura janë zakonisht më pak transparente, i nënshtrohen mbikëqyrjes publike të kufizuar dhe mund të ndryshohen ose shpërfillen më lehtë, prandaj janë alternativë më fleksibile, me më pak llogaridhënie, krahasuar me kornizat ligjore detyruese. Në fakt, më pak se një vit pas marrëveshjes, Kalifornia e uli ndjeshëm kontributin e saj të zotuar, duke e arsyetuar këtë me masa të përgjithshme kursimesh buxhetore. *Google* menjëherë e përdori këtë zhvillim si justifikim për zvogëlimin e kontributit të vet, duke e forcuar më tej argumentin se zotimet vullnetare janë të pamjaftueshme dhe se për t'i detyruar platformat e mëdha të teknologjisë të paguajnë nevojitet legjislacion.¹⁷⁶

Qasje të ngjashme kompensimi, që jo çdoherë janë përcjellë me nisma rregulluese, janë ndërmarrë edhe në shtete tjera.¹⁷⁷ Për shembull, në vitin 2022, Komisioni Japonez për Tregti të Drejtë nxori një opinion këshillëdhënës që u hapi rrugën organizatave të lajmeve të negociojnë me platformat, si me kompanitë botërore të mëdha të teknologjisë ashtu edhe me shpërndarësit lokalë të lajmeve si *Yahoo Japan*, për të siguruar kompensim të drejtë për shpërndarjen e përmbajtjes

174 Tomorrow's Publisher, "Kalifornia tërhiqet nga financimi i marrëveshjes për kompensim të lajmeve i *Google* prej 125 milionë dollarësh." (20 maj 2025), <https://tomorrowspublisher.today/new-formats/california-backtracks-on-funding-of-125m-google-news-deal/>.

175 S. Culpepper, "Marrëveshja e Kalifornisë me *Google* nuk duhet t'i përfshijë startup të lajmeve dhe botuesit më të vegjël." *NiemanLab* (11 shtator 2024), <https://www.niemanlab.org/2024/09/the-california-google-deal-could-leave-out-news-startups-and-the-smallest-publishers/>.

176 N. Dhanesha, "Kalifornia tërhiqet nga zotimi i saj për të financuar lajmet lokale." *NiemanLab* (15 maj 2025), <https://www.niemanlab.org/2025/05/california-pulls-back-on-its-commitment-to-fund-local-news/>.

177 Për hartën botërore ndërvepruese për kornizat e kompensimit të drejtë të teknologjisë dhe mediave, shihni <https://www.journalismliberty.org/publications/center-journalism-liberty-global-tracker-tech-media-fair-compensation>.

së tyre.¹⁷⁸ Ndërkohë, India po shqyrton përfshirjen në kuadër të Aktit për Indinë digjitale të një kornize negocimi në mirëbesim për mediat e lajmeve¹⁷⁹, ndërsa Zelanda e Re po harton një projektligj për negocim të drejtë për lajmet digjitale.¹⁸⁰ Në Afrikën e Jugut, Komisioni i Konkurrencës ka rekomanduar që platformat digjitale të hyjnë në marrëveshje kompensimi të drejtë me mediat lokale¹⁸¹, ndërkohë që Brazili është në proces të ndryshimit të legjislacionit për të drejtën e autorit për të vendosur detyrime kompensimi për platformat e mëdha digjitale që shpërndajnë përmbajtje lajmesh.¹⁸²

Kodet e negocimit me mirëbesim: mangësitë dhe shtegtimi i mundshëm

Mangësitë

Ndërkohë që në shtete si Brazili, India dhe Zelanda e Re, dhe në nivel federal në Shtetet e Bashkuara, po krijohen korniza negocimit në mirëbesim ndërmjet platformave të mëdha të teknologjisë dhe medias, zakonisht në suazat e rregullimit më të gjerë të platformave digjitale, përvojat e Australisë dhe Kanadasë nxjerrin në pah disa mangësi themelore të kësaj qasjeje. Së pari, **marrëveshjet në baza vullnetare janë në thelb të brishta, sepse mbështeten në vullnetin e mirë të palëve**, që mund të zbehet ose zhduket lehtësisht. Së dyti, në kuadër të kornizave të negocimit vërehet një prirje që platformat të **favorizojnë ose negociojnë kryesisht me mediat e mëdha**, të paktën në disa kontekste, me implikime negative për mediat më të vogla e lokale dhe gazetarët.¹⁸³ Implikimet e kodeve të negocimit kanë

¹⁷⁸ Komisioni i Tregtisë së Drejtë i Japonisë, Raporti i studimit të tregut mbi shpërndarjen e përmbajtjes së lajmeve (shtator 2023), <https://www.iftc.go.jp/en/pressreleases/yearly-2023/September/230921.html>. Sihini edhe <https://www.asahi.com/ajw/articles/15010803> dhe <https://japannews.yomiuri.co.jp/business/economy/20230922-138317/>.

¹⁷⁹ <https://indianexpress.com/article/business/economy/digital-india-bill-to-prescribe-guardrails-for-digital-competition-separate-competition-law-to-enforce-specific-rules-8751643/>

¹⁸⁰ Projektligji për negocimin e drejtë të lajmeve digjitale, <https://www.legislation.govt.nz/bill/government/2023/0278/latest/whole.html#whole>

¹⁸¹ Komisioni i Konkurrencës i Afrikës së Jugut, Hetimi i tregut të mediave dhe platformave digjitale (2025), https://www.compcom.co.za/wp-content/uploads/2025/02/CC_MDPMI-Provisional-Report-Non-Confidential-Final.pdf

¹⁸² <https://www.poynter.org/commentary/analysis/2024/bargaining-code-battle-shifts-to-european-copyright-law-taxes-also-under-consideration/>

¹⁸³ Derisa në rastin e Kanadasë botuesit e pavarur më të vegjël u lanë jashtë marrëveshjes së negociuar me Google, në Kaliforni u përfshinë edhe media të vogla.

ndryshuar në varësi të kontekstit, me ndryshueshmëri në shtete të mëdha kundrejt atyre të vogla, media të mëdha kundrejt atyre më të vogla, dhe në tregjet anglofone kundrejt atyre me gjuhë më pak të përhapura.

Veç kësaj, vendosja e një **detyrimi të fokusuar vetëm te pagesa** në këmbim të shpërndarjes së përmbajtjes mund t'i shtyjë platformat e mëdha të teknologjisë që **ta ndalojnë shfaqjen e lajmeve krejtësisht**. Përpjekjet për të krijuar rregulla të barabarta për negociim të kompensimit të drejtë për mediat kanë rënë në ujë në rastet kur platformat kanë ndalur së transmetuari përmbajtjen mediatike në tërësi, për t'iu ikur detyrimeve për kompensim. Për shembull, në tetë shtete të BE-së, *Google* ka testuar implikimet e lënies jashtë të botuesve të lajmeve nga rezultatet e kërkimit për përdoruesit.¹⁸⁴

Rrugët e mundshme përpara

Për të siguruar efektivitet, politikëbërësit kanë **shqyrtuar mundësinë që detyrimi për shpërndarje të përmbajtjes mediatike të vendoset si parakusht i dispozitave të kompensimit**. Duke mbajtur parasysh rolin e platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë si infrastrukturë kritike në ekosistemin e informacionit dhe rezistencën e tyre ndaj ligjeve që parashohin kompensim, çdo ditë e më shumë po diskutohet opsioni i detyrimeve për “përmbajtje të detyrueshme”¹⁸⁵. **Rregullat për “përmbajtje të detyrueshme” kanë traditë të gjatë në sigurimin dhe promovimin e pluralizmit mediatik dhe përmbajtjes në interes publik në shërbime dhe kanale të kontrolluara privatisht**.¹⁸⁶ Megjithatë, në dritën e dominimit të paprecedent infrastrukturor të platformave të kompanive

¹⁸⁴ Shihni, për shembull, The Fix Foundation, “‘Është një lojë pushteti’ – Testi i *Google* për të hequr përmbajtjen e lajmeve me bazë në BE ngrë shqetësime” (13 dhjetor 2024), <https://thefix.media/2024/12/13/its-a-power-play-googles-test-to-remove-eu-based-news-content-raises-concerns/> dhe PressGazette, “*Google* thotë se eksperimenti tregon se lajmet nuk kanë ‘ndikim të matshëm’ në të ardhurat nga reklamata.” (21 mars 2025), <https://pressgazette.co.uk/marketing/google-ad-revenue-experiment-europe/>. Ky test u pezullua në Francë nga Gjykata Tregtare e Parisit, duke vënë në dukje se “zbatimi i testit ka të ngjarë të shkelë seriozisht të drejtën e qytetarëve për qasje në përmbajtjen e shtypit, një e drejtë e mbrojtur si me kushtetutë, ashtu edhe tradicionalisht”, shihni <https://rsf.org/en/paris-court-suspends-google-test-limiting-users-news-access-rsf-calls-permanent-ban>.

¹⁸⁵ Për informaciontë më të detajshme rreth përmbajtjes së detyrueshme, shihni pjesën 5.1 dhe A. Schiffrin & C. Radsch, *Shqyrtimi i asaj se çfarë duhet të mbani me vete për lajme në ekonominë e platformave*. Punim kërkimor (2025), <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/597645>.

¹⁸⁶ A. Schiffrin & C. Radsch, *Shqyrtimi i përmbajtjes së detyrueshme për lajmet në ekonominë e platformave*. Punim kërkimor (2025), <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/597645>

të mëdha teknologjike në ekosistemin e sotëm të informacionit, mund të jetë e nevojshme që dispozitat për “përmbajtje të detyrueshme” të shtrihen përtej “bartjes” (vënies në dispozicion dhe qasjes bazike në përmbajtje gazetareske) për të inkorporuar edhe elementët e gjetjes, zbulimit ose theksimit të duhur (dallimin përmes renditjes së përmbajtjes), zgjerim rregullash ky që sjell një sërë sfidash shtesë. Nga ana tjetër, **rregullat e “përmbajtjes së detyrueshme” janë kontestuar gjerësisht** sa i përket efektivitetit, rrezikut që t’i përforcojnë dinamikat ekzistuese të pushtetit (pasi mund të thellojnë varësinë nga platformat për shpërndarje të përmbajtjes) dhe potencialit për keqpërdorim politik.

Në përgjithësi, kodet e negocimit në mirëbesim janë vlerësuar si hap fillestar i mirë. Shoqëria civile në mbarë botën kanë shprehur mbështetjen për parimet *“Kompanitë e mëdha të teknologjisë dhe gazetaritë — Parimet për kompensim të drejtë”*, gjerësisht interesin publik, pluralizmin, diversitetin, qëndrueshmërinë, paanshmërinë, bashkësinë, transparencën, llogaridhënien, pavarësinë dhe orientimin drejt rezultateve.¹⁸⁷ Gjatë hartimit dhe testimit të kornizave të negocimit janë shfaqur edhe tendenca pozitive. Ndonëse ende jo të përhapura gjerësisht, disa raste dëshmojnë konsolidim të qasjes së negocimit kolektiv në industrinë e medias, përfshirë edhe ndërmjet organizatave mediatike dhe gazetarëve. **Solidariteti në sektorin e medias**, ndonëse jo i vetëkuptueshëm duke pasur parasysh konkurrencën, pabarazitë në burime dhe modelet e ndryshme të biznesit, është shndërruar në faktor kritik për fuqizimin e pozicionit negociues të mediave përballë platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë. Përmes organizimit kolektiv, mediat mund t’i balancojnë asimetritë strukturore dhe të ndihmojnë në adresimin e shqetësimeve se vetëm mediat më të mëdha përfitojnë nga kornizat e negocimit. Një qasje e tillë kolektive mund të nxisë shpërndarje më të drejtë të të ardhurave dhe masave mbrojtëse, duke rritur njëherazi ndikimin e aktorëve më të vegjël ose të nënpërfaqësuar në funksion të pluralizmit në shkallë të gjerë. Megjithatë, vlerësimet sugjerojnë se, pa masa shtesë, kodet e negocimit në mirëbesim nuk mjaftojnë për të siguruar kompensim të drejtë.

¹⁸⁷ Forumi Global për Zhvillimin e Mediave, Kompanitë e mëdha të teknologjisë dhe gazetaritë - Parimet e kompensimit të drejtë, <https://gfmd.info/engagements/big-tech-and-journalism-principles-for-fair-compensation/>

Tarifat digjitale

Debati politik rreth mënyrave të sigurimit të kompensimit të drejtë po zhvendoset gjithnjë e më shumë nga kornizat e negocimit në mirëbesim drejt qasjeve më të gjera strukturore, që mund të ofrojnë mbështetje më të mirë për mediat e vogla dhe lokale dhe varen më pak nga vullneti i platformave të mëdha të teknologjisë.¹⁸⁸

Instrumentet fiskale si **taksa mbi shërbimet digjitale (TSHD) mund të jenë opsion potencialisht më i balancuar dhe i qëndrueshëm** për sigurimin e kompensimit të drejtë për gazetari. Sistemi aktual ndërkombëtar tatimor nuk e adreson në shkallë të mjaftueshme digjitalizimin e ekonomisë, ngaqë kompanitë shumëkombëshe shpesh prodhojnë fitime nga përdorues në shtete ku këto kompani nuk kanë prani fizike dhe, si rrjedhim, nuk u nënshtrohen detyrimeve tatimore në të ardhurat korporative në ato shtete.¹⁸⁹ Për ta adresuar këtë boshllëk, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (**OECD ka qenë prijatë e negociatave** për një reformë që parasheh pagesë të tatimeve nga kompanitë e mëdha shumëkombëshe në shtetet ku ndodhen konsumatorët e tyre. Një reformë e tillë do t'i zëvendësonte TSHD-të kombëtare, që janë taksa që zbatohen në të ardhurat bruto të ndërmarrjeve të mëdha shumëkombëshe të realizuara nga veprimtari të caktuara digjitale (p.sh. shitje në rrjet, reklamim digjital, përdorim i të dhënave, tregti elektronike ose shërbime transmetimi digjital) në një juridiksion. Megjithatë, akoma nuk është arritur asnjë marrëveshje në nivel të OECD-së dhe rezistenca ndaj një zgjidhjeje të tillë vazhdon, veçanërisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku dhe e kanë selinë shumica e kompanive të mëdha të teknologjisë.

Në nivel kombëtar, **mbi 30 shtete kanë propozuar ose miratuar ndonjë formë të TSHD-së.**¹⁹⁰ Sipas raportimit për vitin 2025 nga Fondacioni

¹⁸⁸ Për shembull: <https://www.theguardian.com/media/2024/oct/23/labor-concerned-meta-may-sidestep-obligations-to-pay-for-news-as-media-bargaining-code-fight-reignites> dhe puna e Qendrës për Tranzicionin Mediatik, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Teknologjisë në Sidnej.

¹⁸⁹ Fondacioni Tatimor i Evropës, "Taksa mbi shërbimet digjitale në Evropë." (6 maj 2025), <https://taxfoundation.org/data/all/eu/digital-services-taxes-europe/>

¹⁹⁰ R. Stotzky dhe A. Fano, "Tatimi në ekonominë digjitale: Taksa mbi shërbimet digjitale, shtylla e parë dhe rruga përpara." *Qendra e Politikave Dypartiake* (26 tetor 2023), <https://bipartisanpolicy.org/blog/taxation-in-the-digital-economy-digital-services-taxes-pillar-one-and-the-path-forward/>

Tatimor i Evropës, Austria, Danimarka, Franca, Hungaria, Italia, Polonia, Portugalia, Spanja, Zvicra, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar kanë zbatuar variacione të TSHD-ve ndaj kompanive të mëdha digjitale. Belgjika, Republika Çeke, Letonia, Norvegjia, Sllovakia, Sllovenia dhe Gjermania¹⁹¹ kanë dhënë po ashtu sinjale të zbatimit të një takse të tillë. Edhe BE e ka shqyrtuar mundësinë e përfshirjes së një takse mbi shërbimet digjitale në programin e shpenzimeve. Taksat e propozuara dhe ato tashmë në zbatim ndryshojnë dukshëm për nga struktura: disa tatojnë të ardhurat nga reklamat në rrjet, disa të ardhurat nga shërbimet e transmetimit, ndërsa të tjerat tatojnë reklamat e fokusuar ose transferimin e të dhënave të përdoruesve, ose një kombinim të këtyre elementëve. Normat tatimore shkojnë nga 1.5 deri në 7.5 për qind, ndërkaq Gjermania ka propozuar një taksë prej 10 për qind.

Austria ka zbatuar një TSHD, ku një pjesë e të ardhurave të arkëtuara nga kjo taksë destinohet për **mbështetjen e gazetarisë**. Taksa në fjalë është 5% dhe zbatohet për reklamimin digjital (e barasvlershme me taksën prej 5% të Austrisë për reklamimin në shtyp, televizion dhe radio), për kompani me të paktën 25 milionë euro të ardhura vendore dhe 750 milionë euro të ardhura botërore. Analiza e ndikimit ligjor e kryer para miratimit të taksës, thekson synimin që një pjesë e të ardhurave të përdoret për mbështetjen e gazetarisë.¹⁹² Në vitin 2024, rreth 20 milionë euro nga të ardhurat nga vjelja e kësaj takse u ndanë për një fond për promovimin e transformimit digjital në sektorin e medias.¹⁹³ Ky fond u krijua në vitin 2021 dhe administrohet nga autoriteti i pavarur rregullator i mediave. Taksa në fjalë ka prodhuar të ardhura prej gjithsej 124.1 milionë euro në vitin 2024.¹⁹⁴

191 The Economic Times, "Gjermania planifikon të vendosë taksë prej 10% mbi platformat në rrjet si Google." (29 maj 2025), <https://economictimes.indiatimes.com/tech/technology/germany-seeks-to-levy-10-tax-on-online-platforms-like-google/articleshow/121490834.cms?from=mdr>

192 Projektligji i Ministrave (2019), Parlamenti austriak, https://www.parlament.gv.at/dokument/XXVI/ME/132/fname_746835.pdf. Programi i qeverisë austriake për vitet 2025-2029 angazhohet ta shqyrtojë këtë me ligj të mjeteve të arkëtuara nga taksa digjitale për mbështetjen e mediave, shihni <https://www.bundeskanzleramt.gv.at/bundeskanzleramt/die-bundesregierung/regierungsdokumente.html>.

193 <https://www.derstandard.at/story/3000000258137/26-werbemilliarden-aus-oesterreich-gingen-2024-an-google-tiktok-insta>

194 RTR Media, Buletin (19 mars 2025), https://www.rtr.at/medien/aktuelles/publikationen/Newsletter/newsletter_2025/RTR_Medien_NL_01_2025/Werbeerloese-und-Digitalsteuer.de.html

Në dhjetor 2024, pas përpjekjeve të pasuksesshme për rinovimin e marrëveshjeve të negocimit në mirëbesim, Australia njoftoi për vendosjen e një tarife të re digjitale,¹⁹⁵ që synon tatimin e platformave të mëdha digjitale dhe motorëve të kërkimit, përveç kur ato bien dakord që t'i ndajnë të ardhurat me mediat e lajmeve. Norma e saktë e taksës nuk është përcaktuar akoma, por nisma synon kompanitë e teknologjisë që fitojnë mbi 250 milionë dollarë australianë në vit nga veprimtaria në Australi, ku përfshihet *Meta*, *Alphabet (Google)* dhe *ByteDance (TikTok)*. Në verën e vitit 2025, Komisioni i Konkurrencës i Afrikës së Jugut, në vijimësi të një hetimi të tregut të mediave dhe platformave digjitale, që përfshinte edhe një sërë rekomandimesh të tjera, propozoi qasje të ngjashme të zbatimit të një takse digjitale për rishpërndarje të fondeve nga platformat te mediat, nëse kompanitë nuk i kompensojnë mediat në mënyrë vullnetare.¹⁹⁶

Meqë të ardhurat nga reklamimi tradicional, që dikur e mbanin industrinë e medias, janë absorbuar nga platformat e mëdha të teknologjisë, argumenti **në favor të shkuarjes së të ardhurave nga vjelja e TSHD për financimin e mediave të pavarura në interes publik po bëhet gjithnjë e më shumë e duhur**. Një mënyrë për ta arsyetuar një përfundim i tillë është analogjia me parimin “ndotësi paguan”, të njohur në të drejtën mjedisore.¹⁹⁷ Megjithatë, ngelen të hapura çështjet se çfarë duhet të tatohet saktësisht, sa nga të ardhurat duhet të destinohen për gazetari, dhe në ç’ mënyrë, nga kush dhe për cilat organizata duhet të shpërndahen këto fonde. Po aq e rëndësishme është edhe çështja e **administrimit të shpërndarjes së fondeve**, pra nëse administrimi duhet t’u besohet trupave të pavarura apo agjencive qeveritare, si dhe përcaktimi i kritereve që duhet të përdoren për

¹⁹⁵ The New Daily, “Facebook, Google face new tax in push to fund news.” (12 dhjetor 2024), <https://www.thenewdaily.com.au/news/national/2024/12/12/facebook-google-tax-news-funding>

¹⁹⁶ Për Hetimin e tregut të mediave dhe platformave digjitale dhe dokumentet përkatëse, shihni <https://www.compcom.co.za/media-and-digital-platforms-market-inquiry/>.

¹⁹⁷ Parimi “ndotësi paguan” pohon se ata që prodhojnë ndotje duhet të marrin përsipër kostot e menaxhimit të saj. Sipas analogjisë, platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë mund të shihni si platforma që ndikojnë në mënyrë negative në mjedisin e informacionit, duke devijuar të ardhurat thelbësore nga reklamat nga media dhe duke përfituar nga përmbajtja e lajmeve pa kompensim të duhur. Për një analizë të përpjekjeve të ndryshme për zbatimin e TSHD-së, shihni Përmbledhjen e Politikave M20 “Një taksë digjitale për të mbështetur gazetarinë cilësore” nga Forumi për Informacion dhe Demokraci (shtator 2025), <https://informationdemocracy.org/2025/08/28/time-for-a-new-approach-a-new-policy-brief-calls-for-digital-taxes-to-fund-journalism>.

identifikimin e mediave që kualifikohen për këto fonde. Garancitë për transparencë, pavarësi e redaksisë dhe orientim drejt interesit publik janë thelbësore për ta shmangur politizimin dhe për të siguruar qasje të drejtë, veçanërisht për mediat më të vogla, lokale dhe jofitimprurëse. Pjesëmarrja në organe vetërregulluese të llogaridhënies mund të shërbejë si tregues i rëndësishëm. **Parim udhërrëfyes për shpërndarjen e këtyre fondeve duhet të jetë pavarësia dhe pluralizmi i mediave.**

Përfundim

Përpyekjet e përshkuara më sipër përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt një ekosistemi më të drejtë të lajmeve digjitale, por ngrenë gjithashtu shqetësime thelbësore lidhur me efektivitetin dhe gjithë përfshirjen, mënyrën e zbatimit dhe rrezikun e thellimit të mëtejshëm të varësive nga platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë. Mbetet gjithashtu për t'u parë se në ç' shkallë masat e tilla do të arrijnë ta reflektojnë prirjen e platformave për të kaluar gradualisht drejt IA prodhuese, që shoqërohet me ulje progresive të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike. Kjo nënkupton se modelet alternative të shpërndarjes së përmbajtjes po shndërrohen në një domosdoshmëri gjithnjë e më të madhe ekonomike për mediat, meqë mbështetja te platformat si burim kryesor i të ardhurave dhe si kanal parësor për arritjen e audiencave po bëhet gjithnjë e më e rrezikshme.

Duhet theksuar po ashtu se, përveç politikave që synojnë drejtpërdrejt stabilitetin financiar të mediave, politikëbërësit po shqyrtojnë edhe mënyra **se si politika industriale mund të përdoret për të promovuar media të pavarura në interes publik.** Njohja e gazetarisë si e mirë publike, dhe pranimi i faktit se format më të kushtueshme dhe më të orientuara kah interesi publik, siç është gazetaria hulumtuese, nuk mund të mbështeten vetëm në forcat e tregut, vë në dukje **nevojën për subvencione** dhe skema mbështetjeje publike që prej kohësh kanë qenë karakteristikë e sektorit të medias.

6.2 Masat zbutëse që synojnë mbrojtjen e stabilitetit financiar mediatik në periudhën afatshkurtër

Në peizazhin digjital të sotëm, **qëndrueshmëria financiare e mediave** është e lidhur drejtpërsëdrejti me dallimin e përmbajtjes së tyre. Platformat digjitale dhe motorët e kërkimit nxjerrin përfitime të konsiderueshme nga përmbajtja mediatike, por shpesh nuk sigurojnë qasje në të dhënat kyçe mbi angazhimin e përdoruesve dhe rendimentin e reklamimit, duke ua kufizuar mediave mundësinë për të zhvilluar strategji konkurruese për gjenerimin e të ardhurave. Deklarata e përbashkët e vitit **2023 mbi lirinë e medias dhe demokracinë** (e mandatarëve të fjalës së lirë të Kombeve të Bashkuara, OSBE-së, Komisionit Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve, dhe Organizatës së Shteteve Amerikane) thekson **nevojën që shtetet të krijojnë stimuj që platformat** të kontribuojnë në stabilitetin e mediave dhe në një peizazh mediatik dinamik, përfshirë përmes kundër-balancimit të varësive infrastrukturore të mediave. Deklarata nënvizon gjithashtu se platformat duhet të ofrojnë kompensim të drejtë për përdorimin dhe vlerësimin e përmbajtjes mediatike.¹⁹⁸

Në këtë kontekst, nevojiten një **sërë politikash dhe ndërhyrjesh për të siguruar një mjedis mediatik të drejtë, pluralist dhe të qëndrueshëm në epokën e platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë dhe IA:**

¹⁹⁸ Deklaratë e përbashkët mbi lirinë e mediave dhe demokracinë, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (2 maj 2023), <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/542676>

Sigurimi i kompensimit të drejtë

Shtetet duhet të miratojnë, të hartojnë ose të përmirësojnë korniza rregulluese për sigurimin e kompensimit të drejtë për përmbajtjen mediatike dhe gazetareske që përdoret për gjenerim të të ardhurave nga reklamat¹⁹⁹ ose për trajnim të modeleve prodhuese të IA. Për këtë qëllim janë shqyrtuar **opsione të ndryshme politikash**, përfshirë marrëveshjet vullnetare, bashkë rregullimi, e drejta e autorit, ligji i konkurrencës dhe taksa mbi shërbimet digjitale. Për të siguruar efikasitet dhe për të mbrojtur parimet e drejtësisë dhe pluralizmit, secila prej këtyre qasjeve duhet të shoqërohet me garanci. **Këto garanci** duhet të parandalojnë edhe kapjen e mediave, duke siguruar që kornizat e kompensimit të mos i shërbejnë konsolidimit të mëtejshëm të pushtetit të platformave ose kontrollit shtetëror në dëm të gazetarisë së pavarur.

Meqë marrëveshjet vullnetare dhe aranzhimet për bashkë rregullim kanë treguar efektivitet të kufizuar, madje në disa raste kanë prodhuar edhe pasoja të padëshiruara të tilla si ndërprerja e menjëhershme e shpërndarjes së përmbajtjes së lajmeve (shihni analizën në pjesën e mësipërme), shtetet duhet **të krijojnë një kornizë rregulluese të qartë dhe të zbatueshme**. Për të siguruar pajtueshmëri, kjo kornizë duhet të përfshijë obligime detyruese, mbikëqyrje të pavarur dhe sanksione proporcionale, duke mbrojtur njëkohësisht gazetarinë në interes publik dhe pluralizmin e medias. Modelet e kompensimit duhet të jenë sipas parimeve të interesit publik, pluralizmit, ndryshimit, qëndrueshmërisë, drejtësisë, bashkësisë, transparencës, llogaridhënies, pavarësisë dhe orientimit drejt rezultateve (siç shtjellohet në *"Kompanitë e mëdha të teknologjisë dhe gazetaria — Parimet për kompensim të drejtë"*).²⁰⁰

Nëse shtetet zgjedhin të promovojnë ose mandatojnë **kode dhe korniza negocimi në mirëbesim**, qoftë përmes legjislacionit për mbrojtjen e së

¹⁹⁹ Këshilli i Evropës ka njohur nevojën e platformave digjitale për të kontribuar për ruajtjen e gazetarisë cilësore për shkak të dominimit të tyre për shpërndarjen dhe vlerësimin e përmbajtjes, shihni CM/Rec(2022)4, Rekomandimi i Këshillit Ministror drejtuar shteteve anëtare për promovimin e një mjedisi të favorshëm për gazetari cilësore në epokën digjitale, <https://search.coe.int/cm/?i=0900001680a5ddd0>. Deklarata e përbashkët e vitit 2023 mbi lirinë e mediave dhe demokracinë e katër mandatarëve ndërkombëtarë të fjalës së lirë u bën gjithashtu thirrje shteteve që të nxisin platformat e mëdha që të kontribuojnë për qëndrueshmërinë e mediave, shihni <https://www.osce.org/files/f/documents/3/2/542676.pdf>

²⁰⁰ Forumi Global për Zhvillimin e Medias, Kompanitë e mëdha të teknologjisë dhe gazetaria - Parimet e kompensimit të drejtë, <https://gfmd.info/engagements/big-tech-and-journalism-principles-for-fair-compensation/>

drejtëssëautoritapopolitikës për mbrojtjen e konkurrencës, atëherë në këta mekanizma duhet të integrohen **parimet kryesore** vijuese . Shtetet duhet:

- të inkurajojnë **procese pjesëmarrëse** në negociatat ndërmjet platformave dhe mediave, duke siguruar përfaqësimin e mediave më të vogla, gazetarëve dhe zërave të ndryshëm;
- të mundësojnë dhe mbështesin **negocimin kolektiv**, në mënyrë që organizatat mediatike të negociojnë me platformat e mëdha të teknologjisë nga një pozicion më i fuqishëm;
- të krijojnë mekanizma për mbështetjen dhe mbrojtjen e pluralitetit të zërave në sektorin e medias;
- të sigurojnë që kompensimi t'i shërbejë inkurajimit dhe mbështetjes së **gazetarisë në interes publik**, duke garantuar përkrahjen e drejtë të një peizazhi mediatik pluralist, të larmishëm dhe lokal;
- të vendosin procedura që promovojnë qëndrueshmëri, drejtësi dhe transparencë, dhe që mbikëqyren nga **trupa të pavarur. Vlerësimet e rregullta** duhet të sigurojnë që rezultatet përputhen me vlerat themelore si pavarësia, barazia dhe interesi publik afatgjatë.

Kodet dhe kornizat e negocimit në mirëbesim duhet të përfshijnë edhe masa për menaxhimin e **rrezikut të hakmarrjes nga platformat** (p.sh., ndërprerja e shpërndarjes së lajmeve, siç është parë në Kanada dhe gjetkë). Një qasje që po shqyrtohet gjithnjë e më shumë është integrimi i rregullave për përmbajtje të detyrueshme, duke shkuar potencialisht përtej thjesht garantimit të qasjes në përmbajtjen mediatike dhe sigurimit edhe të theksimit të duhur dhe qasjes së saj.

Eksplorimi i dispozitave për përmbajtje të detyrueshme

Për shkak të reagimeve të platformave të mëdha të teknologjisë ndaj përpjekjeve rregulluese (hakmarrje, bllokim i plotë i lajmeve, lobim intensiv etj.) disa shtete kanë shqyrtuar mundësinë e vendosjes së **rregullave për t'i obliguar platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë që të shpërndajnë përmbajtje gazetareske dhe mediatike që është në përputhje**

me standardet rregulluese dhe parimet e vetërregullimit, dhe për të siguruar jo vetëm qasje minimale, por edhe qasje dhe theksim të duhur sipas kriterëve të qarta dhe të vëzhgueshme. Kjo qasje është e njohur në sektorë si telekomunikimi ose rrjetet kabllore dhe mund të përfshijë shpalljen e disa shërbimeve ose funksionaliteteve si shërbime publike, me qëllim vendosjen e detyrimeve të shërbimit universal. Megjithatë, mekanizmat e tillë janë shpesh objekt debati dhe **duhet të konceptohen me shumë kujdes**, ngaqë mund ta përforcojnë pushtetin ekzistues, të rezultojnë joefektive dhe të krijojnë një shtresë të re kontrolli të padëshiruar mbi vendimmarrjen se kush kualifikohet për të përfituar dhe kush jo.

Adresimi i përqendrimit të tregut në reklamimin programatik

Shtetet dhe organizatat ndërqeveritare duhet ta adresojnë dominimin në rritje të platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë në tregun botëror të reklamave. Këto platforma veprojnë njëkohësisht si ndërmjetës dhe si konkurrentë të drejtpërdrejtë të mediave, duke e shtrembëruar kështu konkurrencën në tregun e reklamave.

- Shtetet duhet të sigurojnë **shpërndarje më të drejtë të të ardhurave nga reklammat që platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë përfitojnë nga** shpërndarja e përmbajtjes gazetareske në shërbimet e tyre dhe nga përdorimi i saj për qëllime tjera.
- Shtetet duhet gjithashtu **t'i shtojnë** përpjekjet për të siguruar **mos vlerësimin monetar të dezinformimit dhe të aktorëve mashtrues**.

Stimulimi i reklamuesve për të investuar në gazetari në interes publik

Shtetet duhet t'i fuqizojnë përpjekjet për ta angazhuar **sektorin e reklamave si aktor i rëndësishëm në** mbështetjen e gazetarisë së pavarur dhe në interes publik, si dhe për të **promovuar cilësi kundrejt karremave për klikime**. Mësime të vlefshme në këtë kuptim mund të nxirren nga përpjekjet e industrisë (p.sh., Internews, Ads4Media²⁰¹) ose nga nismat e Asociacionit Evropian të Reklamuesve. Argumentet që lidhen me reputacionin e markës dhe sigurinë e reklamimit mund të shfrytëzohen paralelisht me qasjet tashmë të

201 <https://www.ads4media.online>

konsoliduara për parandalimin e vendosjes së reklamave pranë përmbajtjes ekstremiste të dhunshme ose dezinformuese. Në përgjithësi, fokusi duhet të vendoset te **përgjegjësitë sociale të korporatave**, në mënyrë që përgjegjësia në reklamim të bëhet pjesë integrale e debatit mbi biznesin dhe të drejtat e njeriut. Shtetet mund t'i nxisin nismat e tilla, përfshirë përmes ofrimit të lehtësirave tatimore ose zbritjeve të posaçme për reklamim në interes publik.

Vendosja e tarifave digjitale për t'i mbështetur mediat në interes publik

Shtetet duhet të vendosin një tarifë digjitale ose taksë mbi shërbimet digjitale për platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë dhe **të ardhurat nga kjo taksë t'i destinonjë për mbështetjen e mediave të pavarura dhe në interes publik**. Për të siguruar efektivitet, drejtësi dhe llogaridhënie, ndarja e fondeve duhet të **bazohet në kritere të qarta e transparente dhe të administrohet nga trupa** të pavarur, me garanci kundër ndikimit politik dhe ndikimeve të tjera të papërshtatshme. Kriteret duhet të pasqyrojnë përkushtimin ndaj pavarësisë së redaksisë, pluralizmit dhe interesit publik, si dhe të përfshijnë edhe mediat digjitale lokale, sipas risive dhe komunitëve.

Sigurimi i shkëmbimit të të dhënave

Për t'u mundësuar mediave të kuptojnë se si platformat e mëdha të teknologjisë vlerësojnë përmbajtjen e tyre, shtetet duhet t'u kërkojnë platformave të ndajnë me to të dhëna të **kategorizuara sipas mënyrave të ndërveprimit të përdoruesve** me përmbajtjen mediatike, si edhe të dhëna mbi të ardhurat nga reklamat që prodhohen prej saj. Si frymëzim në këtë drejtim mund të shërbejë legjislacioni i BE-së, konkretisht Akti për tregjet digjitale.

Adresimi i IA prodhuese

Shtetet duhet ta trajtojnë IA prodhuese si një fushë të re që duhet të rregullohet,²⁰² përfshirë përmes vendosjes së rregullave për transparencë lidhur me të dhënat mbi bazën e të cilave IA trajnohet, për pëlqim dhe kompensim të drejtë për përmbajtjen e përdorur, si dhe standarde të reja llogaridhënieje për përmbajtjen e prodhuar nga IA. Kjo nënkupton zbatim rigoroz të të drejtave të autorit dhe potencialisht krijimin e kornizave të reja

²⁰² Forumi për Informacion dhe Demokraci, *IA si e mirë publike: Sigurimi i kontrollit demokratik të IA-së në hapësirën e informacionit*. (shkurt 2024)

rregulluese të përshtatura për realitetet dhe ciklin jetësor të IA prodhuese. Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të autorit në kontekstin digjital dhe të IA është vendimtar jo vetëm për **mbrojtjen e interesave ekonomike të bartësve të të drejtave, por edhe për ruajtjen e integritetit, qëndrueshmërisë dhe ndryshimit të ekosistemit të informacionit**. Kjo vlen si për përdorimin e përmbajtjes për trajnimin e modeleve të IA prodhuese, ashtu edhe për përdorimin e saj për gjenerim të përmbledhjeve, përgjigjeve dhe rezultateve të tjera.

Aktualisht, mungesa e transparencës lidhur me prejardhjen e seteve të të dhënave e bën të pamundur të përcaktohet se ç'masë, dhe në ç'mënyrë, përmbajtja mediatike përdoret për zhvillimin dhe funksionimin e sistemeve të IA prodhuese. Për këtë arsye, është thelbësore të krijohen të drejta të zbatueshme për organizatat mediatike dhe gazetarët sa i përket përdorimit të përmbajtjes së tyre në trajnimin dhe në aplikacionet e IA,²⁰³ përfshirë:

- **Të drejtën për të ditur:** Organizatat mediatike duhet ta kenë mundësinë që të kërkojnë transparencë të plotë lidhur me faktin nëse, dhe në ç'masë, përmbajtja e tyre përfshihet në grupet e të dhënave mbi bazën e të cilave trajnohen sistemet e IA, përdoret në proceset e përshtatjesmose në gjenerimin e asistuar nga kërkimi në burime,²⁰⁴
- **Të drejtën për pëlqim paraprak:** Mediat, si bartëse të të drejtave, duhet të kenë autoritetin për të vendosur nëse përmbajtja e tyre mund të përdoret në sisteme komerciale të IA, ose në sisteme që nuk janë të përcaktuara qartë si sisteme në interes publik, me garanci për pavarësi dhe pluralizëm. Këtu përfshihet përmbajtja e përdorur për trajnim, ofrim konteksti ose referencash për përgjigjet e sistemeve të IA, si dhe çdo operacion tjetër ku materiali i tyre përdoret si e dhënë hyrëse. Bartësit e të drejtave duhet të kenë të drejtën që ta tërheqin pëlqimin për përdorim të mëtejshëm në cilëndo fazë dhe të kenë qasje në mjete efektive korrigjuese;
- **Të drejtën për kompensim të drejtë:** Kur përmbajtja mediatike përdoret për trajnim ose operim të sistemeve të IA, bartësit e të drejtave duhet të kompensohen në nivel proporcional me vlerën që kjo përmbajtje prodhon.

²⁰³ Po aty, pjesa 1(f).

²⁰⁴ Gjenerimi i asistuar nga kërkimi në burime (RAG) është një teknikë që përmirëson rendimentin e modeleve të mëdha gjuhësore duke i lidhur ato me burime të jashtme të njohurive, siç është përmbajtja mediatike, për të përfshirë informacionin nga këto burime në përgjigjet e tyre.

Këto të drejta janë thelbësore jo vetëm për ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të mediave, por edhe për ruajtjen e integritetit të gazetarisë.

Mbështetja për risi në media

Shtetet duhet të ofrojnë mbështetje publike dhe stimuj të dedikuar enkas për **transformim, eksperimentim dhe risi digjital** në gazetari dhe në formatet mediatike. Kjo mbështetje duhet të shoqërohet me masa të integruara të sigurimit të transparencës, të shërbyerit të interesave të përdoruesve për t'u informuar, dhe parandalimit të politizimit të këtyre instrumenteve.

Ndryshimi i burimeve të të ardhurave për mediat

Shtetet duhet të promovojnë modele të financimit të qëndrueshëm përmes një kombinimi të:

- politikave tatimore të favorshme ose lirimeve tatimore për mediat (p.sh., zbritje tatimore për mbështetje filantropike për mediat në interes publik, për abonime, ose lehtësira tatimore për reklamuesit);
- mekanizmave transparentë dhe të pavarur të financimit publik, me kritere të qarta, për mbështetjen e gazetarisë në interes publik dhe pluralizmit mediatik, si dhe me konsiderata të posaçme për mediat lokale dhe rajonale, veçanërisht në kontekste autoritare ku mediat e pavarura përballen me presion nga autoritetet;
- mekanizmave të financimit nga qytetarët (p.sh., abonime, mikropagesa, platforma donacionesh, si dhe eksplorim i mekanizmave të rinj siç janë “kuponët e gazetarisë”²⁰⁵ që u mundësojnë qytetarëve të financojnë drejtpërdrejt mediat sipas zgjedhjes së tyre); dhe
- granteve për risi, për të nxitur forma të reja të gazetarisë dhe angazhimit të audiencës.

²⁰⁵ “Kuponët e gazetarisë” janë mekanizma të financimit publik ku qytetarët marrin një kupon me një vlerë të caktuar monetare që mund t’ua ndajnë medias/mediave sipas zgjedhjes së tyre. Ato janë të dizajnuara për t’u dhënë individëve mundësi të drejtpërdrejta në mbështetjen e gazetarisë.



VIGILANCE

VIGILANCE

VIGILANCE

VIGILANCE

VIGILANCE

VIGILANCE

7. Vigjilenca (Siguria) e Mediave

Kjo pjesë shqyrton ndërhyrjet e politikave që synojnë forcimin e vigjilencës së mediave (në kuptim të sigurisë së gazetarëve). Nën nënpjesën e parë shqyrtohen qasjet e politikave dhe ato rregulluese, si dhe evidentohen mësimet e nxjerra nga përvojat e deritanishme. Nën pjesa e dytë paraqet rekomandime për shtetet për mbrojtjen dhe promovimin e sigurisë së gazetarëve në mjedisin në rrjet.

7.1 Nismat e politikave dhe rregullave për forcimin e vigjilencës së mediave dhe sigurisë së gazetarëve

Për ta kuptuar nocionin e sigurisë së gazetarëve nevojitet një **qasje e dyfishtë**. Në radhë të parë, siguria duhet të konceptohet duke i marrë parasysh **realitetet e ndryshme dhe identitetet e ndërthurura** të gazetarëve. Në radhë të dytë, një nocion gjithëpërfshirës i sigurisë duhet të pasqyrojë edhe **ndërlidhjen e saj edhe me aspektet strukturore të mediave**, veçanërisht me dallimin dhe stabilitetin financiar të lajmeve.

Për analizimin e nismave për sigurinë e gazetarëve lipset një qasje **tërësore**, siç thuhet në Vendimin e Këshillit Ministror të OSBE-së për sigurinë e gazetarëve²⁰⁶ dhe në kornizën standarde të UNESCO-s për sigurinë e gazetarëve, që u kërkojnë shteteve të parandalojnë, të ndjekin penalisht dhe të ndëshkojnë dhunën ndaj gazetarëve.²⁰⁷ Mbështetja në këtë kornizë nënkupton trajtimin e gjitha dimensioneve kryesore të sigurisë:

- Fizike
- Mirëqenie mendore/emocionale
- Ligjore dhe ekonomike
- Digjitale
- Konsideratat e lidhura me gjininë dhe identitetin

Për ta tejkaluar ndarjen e kahershme binare mes kërcënimeve *jashtë* dhe *në rrjet*, që priret ta ulin seriozitetin e dhunës në rrjet dhe dëmeve të lidhura me të, këto dimensionë duhet të merren parasysh para, gjatë dhe pasi të ketë ndodhur dhuna.²⁰⁸

Kjo pjesë shqyrton përpjekjet politike dhe rregullat e fokusuara në sigurinë e gazetarëve dhe trajton dhunën **në rrjet** në platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë. Dhuna në rrjet duhet kuptuar si dëm që shkaktohet në një mjedis digjital, ose me anë të veglave teknologjike, sidomos në platformat e rrjeteve sociale dhe aplikacionet përkatëse të mesazheve. Disa aplikacione mesazhesh po integrojnë gjithnjë e më shumë tipare të ngjashme me ato të platformave dhe po shndërrohen në hapësira kyçe për dhunë në rrjet, dhe për veprimtari të aktorëve ekstremistë dhe dezinformues. Për shembull, *Telegram* mundëson mënyra të shumta komunikimi, duke filluar nga mesazhet individuale

²⁰⁶ Vendimi i Këshillit Ministror të OSBE-së Nr.3/18 mbi sigurinë e gazetarëve, MC.DEC/3/18, <https://www.osce.org/chairpersonship/406538>

²⁰⁷ UNESCO. *Plani i veprimit i Kombeve të Bashkuara për sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit*. (2012), <https://www.unesco.org/en/safety-journalists/un-plan-action>

²⁰⁸ Nënvizuar në Udhëzimet e UNESCO-s për zbatimin e planit të veprimit të OKB-së për sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit, shihni <https://www.unesco.org/en/safety-journalists/un-plan-action>; Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias Lufta kundër dhunës në rrjet: *Udhëzime për monitorimin e dhunës në rrjet ndaj gazetarëve*. (tetor 2023), <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/554098>; *Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Mediave, Komunikatë nga Zyra e Misionit të OSBE-së për Lirinë e Mediave mbi Pluralizmin e medias, sigurinë e gazetarëve dhe mbrojtjen e zërave të marginalizuar në rrjet* (Komunikata Nr.1/2019), <https://www.osce.org/sites/default/files/2019-02-21%20SOFJO%20Communique.pdf>

deri te kanalet publike, me moderim ose rregullim të paktë.²⁰⁹ *Viber*, si shembull tjetër, deri në maj 2024 lejonte krijimin falas të bot-ëve për përhapje të shpejtë dhe të gjerë të mesazheve.²¹⁰ Dhuna në rrjet përfshin ngacmimin, mujshimin, diskreditimin, përndjekjen, publikimin e të dhënave personale, ngacmimin seksual, falsifikimin e identitetit, gjuhën diskriminuese, abuzimin seksual përmes fotografive dhe videove, fushatat e shënjestruara të shpifjes, mbikëqyrjen dhe sulmet kibernetike.²¹¹ Ajo shoqërohet shpesh me regres demokratik, polarizim politik ose trazira,²¹² dhe ka ndikim veçanërisht të theksuar në shtetet ku institucionet demokratike janë të brishta dhe ku sundimi i ligjit është i dobët.²¹³

Shumica e formave të dhunës në rrjet nuk lejohen sipas kushteve të shërbimit të platformave të mëdha të teknologjisë, andaj ato duhet të adresohen përmes moderimit të përmbajtjes. Në **kuptim të përgjithshëm, termi “moderim i përmbajtjes” i referohet veglave dhe masave të ndryshme, të automatizuara dhe të udhëhequra nga njeriu, për largim ose zvogëlim të dallimit të llojeve të caktuara të përmbajtjes që është ose e kundërligjshme ose bie ndesh me politikat e brendshme të platformave.**²¹⁴ Këto procese ofrojnë mekanizma korrigjimi, si taste për raportim, filtrim dhe bllokim, dhe janë kryesisht të automatizuara, me përfshirje minimale njerëzore në korrigjimin e pasojave.

Tabela në vijim paraqet **proceset e moderimit të përmbajtjes që**

209 Instituti për Dialog Strategjik, Hulumtimi i ekosistemit në rrjet në zhvillim: Barrierat, metodat dhe sfidat e ardhshme (2022), https://www.isdglobal.org/wp-content/uploads/2022/07/Researching-the-Evolving-online-Ecosystem_MIA-report.pdf

210 M.O. Rosenblat dhe të tjerë, Fushatat e fshehta: Mbrojtja e platformave të mesazheve të enkriptuara nga manipulimi i votuesve (2024), <https://bhr.stern.nyu.edu/publication/safeguarding-encrypted-messaging-platforms>

211 M. Žuffová dhe R. Carlini, “Siguria e gazetarëve në Evropë: Kërcënimet dhe praktikrat më të mira për t’i trajtuar ato”. Në *Qendrën Robert Schuman për Studime të Avancuara, Punimi Kërkimor Nr.RSCAS 2021/43* (2021), fq.13, https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3829514

212 UNESCO, *Klima frikësuese: Trendet botërore të dhunës në rrjet ndaj gazetareve*. Dokument Diskutimi Kërkimor (2021), fq.13.

213 Në mënyrë të ngjashme, vrasjet e gazetarëve mund të shoqërohen me nivelin e lartë të korrupsionit në shtete. Shihni M. Žuffová dhe R. Carlini, “Siguria e gazetarëve në Evropë: Kërcënimet dhe praktikrat më të mira për t’i trajtuar ato”. Në *Qendrën Robert Schuman për Studime të Avancuara Punim Kërkimor Nr.RSCAS 2021/43* (2021), fq.13; C. Tenove dhe të tjerë, *Jo vetëm fjalë - Si sulmet ndaj reputacionit dëmtojnë gazetarët dhe minojnë lirinë e shtypit*. Qendra Botërore e Raportimit (2023), <https://globalreportingcentre.org/reputational-attacks/>

214 Neni 19, *Manuali i moderimit të përmbajtjes dhe liria e shprehjes*. (Gusht 2023), fq.5, <https://www.article19.org/wp-content/uploads/2023/08/SM4P-Content-moderation-handbook-9-Aug-final.pdf>

ekzistojnë aktualisht. Disa sosh ndërmerren nga platformat paraprakisht, ndërkohë që tjerat nisen vetëm pasi përmbajtja të jetë raportuar nga përdoruesit ose partnerët e besuar, përfshirë përmes kanaleve të përshkallëzimit. Gjatë procesit të moderimit, pjesë të caktuara të përmbajtjes mund të largohen, t'u ulet dallimi, të etiketohen (p.sh., si dezinformim), të ulen në renditje ose mos vlerësohen financiarisht, ndërsa disa veçori të llogarisë që konstatohet se është përgjegjëse për përmbajtjen mund të çaktivizohen. Gabimet në këto vendime, qoftë kufizim i së drejtës për shprehje të ligjshme, apo mosveprim në situata të nxitjes së dhunës, mund të kenë ndikim serioz në sigurinë e gazetarëve.

Ndonëse moderimi i përmbajtjes shihet shpesh si parim reagues, për vetë faktin se ndërhyhet vetëm pasi dëmi të jetë shkaktuar nga modelet e biznesit të orientuara kah angazhimi dhe nga mungesa e llogaridhënies efektive, IA përfshin megjithatë një gamë veglash e procedurash teknike që mund të jenë jetike për sigurinë e gazetarëve në hapësirën në rrjet. Veçori të tilla sigurie janë krijuar për të mbrojtur përdoruesit nga dëmet duke parandaluar, zvogëluar ose menaxhuar ekspozimin ndaj dhunës në rrjet. Siç tregon tabela, vetëm një numër i kufizuar i veçorive të sigurisë ofrohen si masa parandaluese, ndërsa shumica janë reaguese dhe të automatizuara. Veçoritë që aktivizohen nga përdoruesi janë të dizajnuara për të mundësuar kontroll individual të përvojës personale në platformë, dhe jo për sanksionimin e shkelësve.²¹⁵

Veçoritë e sigurisë	Veglat	Karakteristikat kryesore
Politikat	Kushtet e shërbimit dhe udhëzimet e komunitetit identifikojnë dhe rendisin shkeljet dhe veglat për moderimin e përmbajtjes	Ato përbëjnë marrëveshje kontraktuale mes platformës dhe përdoruesit. Përcaktojnë format e dhunës në rrjet që janë të palejueshme në shërbim.

²¹⁵ K. Lo, *Mjete për Inventarin e Shoqërisë Civile dhe Moderimit*. Meedan (nëntor 2020), <https://meedan.com/post/toolkit-for-civil-society-and-moderation-inventory>

Zbulimi	Teknologjia e identifikimit me gjurmë unike digjitale, ²¹⁶ njohja e imazheve, përpunimi i gjuhës natyrore (NLP) ²¹⁷	Filtra parandalues, që pengojnë ngarkimin e përmbajtjes në platformë. Aplikohen kryesisht për materiale të abuzimit seksual të fëmijëve dhe për materiale ekstremiste/terroriste, e më rrallë për mbrojtjen specifike të gazetarëve/gazetarisë. Modelet e përpunimit të gjuhës mund të ndihmojnë në zbulimin e dhunës në rrjet ndaj gazetarëve.
Vlerësimi, zbatimi, ankimimi	Veglat reaguese Mekanizmat e raportimit shërbejnë për shënjimin dhe paraqitjen (“raportimin”) e ankesave lidhur me shkelje të politikave të brendshme. Këto opsione dhe proceset pasuese të gjykimit zbatohen si për përmbajtjen ashtu edhe llogaritë e përdoruesve. Butoni i raportimit fillon një proces vendimmarrjeje mbi lëndën e ankesës. Nëse konstatohet shkelje, përmbajtja/llogaria hiqet ose bëhet më pak e dukshme/qasshme. Në disa raste, varësisht nga platforma dhe politikat e saj, individët mund ta kundërshtojnë vendimin përmes procedurave të ankimimit. Shumica e proceseve janë plotësisht ose pjesërisht të automatizuara, përfshirë edhe përmes sistemeve të ndryshme të përpunimit të gjuhës natyrore (NLP) dhe chatbot. Nuk deklarohet publikisht se në ç’fazë dhe në ç’masë përfshihen moderatorët njerëz në këtë proces.	
Veçoritë e aktivizuara nga përdoruesi	Bllokimi, vënia në heshtje, kufizimi i përmbajtjes, fshehja/heqja e postimit, çaktivizimi i ndjekjes/miqësisë, kufizimi i qasjes në përmbajtje	Këto vegla shërbejnë për qëllime të ndryshme. Bllokimi ndërpret qasjen në përmbajtje ose llogari të caktuara, vënia në heshtje e bën përmbajtjen e caktuar të padukshme, kufizimi u mundëson gazetarëve ta etiketojnë përmbajtjen e dëmshme në mënyrë që të mos jetë e dukshme publikisht dhe ta arkivojnë atë për fshirje ose shqyrtim të mëvonshëm.

Tabela 4: Pasqyrë e veçorive të sigurisë në platforma të ndryshme.

²¹⁶ Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, *Fokus mbi inteligjencën artificiale dhe lirinë e shprehjes - Manual politikash*. 2021), fq.293

²¹⁷ Përpunimi i gjuhës natyrore (NLP) është degë e inteligjencës artificiale (IA) që u mundëson kompjuterëve të kuptojnë, prodhojnë dhe manipulojnë gjuhën. Shihni për më shumë: C. Epright, “Çka është përpunimi i gjuhës natyrore (NLP)?” *OCI* (25 Mars 2021), <https://www.oracle.com/uk/artificial-intelligence/what-is-natural-language-processing/>

Analizë e mekanizmave aktualë të sigurisë

Ndonëse disa veçori të sigurisë janë të integruara në politikat e platformave dhe në praktikat (gjërisht të automatizuara) të administrimit të përmbajtjes, shumica sosh e zhvendosin barrën e mbrojtjes te gazetari individual. Për më tepër, pas raportimit të një kërcënimi ndaj sigurisë, gazetarët kanë pak kontroll mbi mënyrën se si zhvillohet procesi i shqyrtimit, gjë që mund ta përkeqësojë situatën e tyre të sigurisë. Veçoritë ekzistuese të sigurisë dhe mekanizmat përkatës të korrigjimit janë vlerësuar përgjithësisht si joefektive,²¹⁸ kurse ndikimi afatgjatë i këtyre veçorive në uljen e rasteve të ngacmimit është ende i paqartë.

Mungesa e efektivitetit lidhet mes tjerash edhe me mungesën e të dhënave të verifikueshme. Pavarësisht kërkesave të kohëve të fundit për raporte transparence, qasja në prova, përfshirë të dhënat mbi dallimin dhe sigurinë e mediave, vazhdon të jetë përgjithësisht e kufizuar. “Madhësia reale e dëmit”²¹⁹ vlerësohet kryesisht në bazë të hulumtimeve të fragmentuara, studimeve të thelluara, të dhënave të mbledhura nga përvojat e gazetarëve, monitorimit nga organizata mediatike rajonale dhe lokale, dhe informacionit që platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë publikojnë kohë pas kohe.²²⁰ Raportet ekzistuese, si *raportet e transparencës dhe vlerësimet e rreziqeve sistemike*, që përpilohen në suazat e ASHD-së, ofrojnë një pasqyrë të mjegullt të shkallës aktuale të dhunës në rrjet dhe efikasitetit të moderimit të përmbajtjes, pa detaje specifike për gazetarët.²²¹

218 Për shembull, <https://onlineviolenceresponsehub.org/> dhe V. Vilck dhe E. Vialle, *Nuk ka justifikim për abuzim*. PEN Amerika (2021), <https://pen.org/report/no-excuse-for-abuse/>.

219 SB Micova, *Cili është dëmi sipas madhësisë? Vlerësim paraprak i qasjes së Komisionit Evropian ndaj fuqisë së tregut në sektorin e medias*. Qendra për Rregullimin në Evropë (CERRE) (2021), <https://cerre.eu/publications/what-is-the-harm-in-size/>.

220 Për shembull, shihni UNESCO, *Dhuna në rrjet kundër gazetarëve: Një pasqyrë botërore e incidencës dhe ndikimeve*. (2020) <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000375136/>; Monitorimi i sigurisë nga aspekti i kërcënimeve të gazetarëve: Përpjekjet për monitorimin e reagimit të shpejtë në mbrojtje të lirisë së medias <https://www.mfrr.eu/monitor/>; Gazetarë të sigurt, Rrjeti Rajonal i Monitorimit të Ballkanit Perëndimor, <https://safejournalists.net/>; C. Tenove dhe të tjerë, *Jo vetëm fjalë - Si sulmet ndaj reputacionit dëmtojnë gazetarët dhe minojnë lirinë e shtypit*. Qendra Botërore e Raportimit (2023); Kërkime shtesë nga L. Loureiro, shihni <https://globalreportingcentre.org/reputational-attacks/>; S. Dunn dhe të tjerë, *Mbështetja e hapësirave digjitale më të sigurta: Raport mbi dëmet gjinore në rrjet dhe nevojën për veprim*. Qendra për Risi në Qeverisjen Ndërkombëtare (2022), <https://www.cigionline.org/publications/supporting-safer-digital-spaces/>.

221 Një shembull i një raporti të tillë të transparencës mund të gjendet këtu: Meta, *Akti i BE-së për Shërbimet Digjitale: Raportet e transparencës për platformat shumë të mëdha në rrjet*. (26 prill 2024), fq.15, <https://transparency.meta.com/reports/regulatory-transparency-reports/>.

Si rrjedhojë e informacionit të pamjaftueshëm, përfshirë të dhënave të grupuara që mundësojnë identifikimin e llogarive të gazetarëve dhe mediave, është e pamundur të vlerësohet ndikimi konkret i ndërhyrjeve përmes moderimit të përmbajtjes në rastet e dhunës ndaj gazetarëve.²²²

Përveç këtyre mangësive funksionale dhe teknike, **duhet të merren parasysh edhe tri konsiderata të tjera:**

- Ndërlidhja **mes moderimit të përmbajtjes dhe masave për dallimin e mediave** (p.sh., ulja në renditje, largimi i përmbajtjes pa dijeninë e autorit dhe etiketimi i përmbajtjes) nuk është eksploruar mjaftueshëm. Politikëbërësit duhet të kenë parasysh se çdo ndërhyrje **që prek dallimin dhe stabilitetin financiar të mediave ka të ngjarë të reflektohet edhe në sigurinë e gazetarëve.** Për shembull, kur gazetarët synojnë të rrisin angazhimin e audiencës, ata mund t’u ekspozohen rreziqeve më të larta për dhunë në rrjet.²²³ Në anën tjetër, rënia e të ardhurave mund t’i shtyjë mediat t’i kufizojnë investimet në masa sigurie, të ulin pagat e gazetarëve ose të bëjnë shkurtime të punonjësve, duke e dobësuar edhe më tej pozitën ekonomike dhe sigurinë e gazetarëve. Në të njëjtën kohë, platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë i kanë zvogëluar ekipet e besimit dhe sigurisë që punojnë në politikat dhe produktet kundër ngacmimit në rrjet.²²⁴
- Një pjesë e konsiderueshme e dhunës në rrjet (p.sh., agresioni digjital tej kombëtar, “deepfakes” ndërveprues)²²⁵, përfshirë edhe sulmet kolektive të koordinuara që shpesh orkestrohen përmes një morie llogarish “bot” dhe shpërndahen në shumë platforma përn-

²²² Qendra për Demokraci dhe Teknologji, *Reagimi i shoqërisë civile ndaj raporteve të vlerësimit të rrezikut të ASHD-së: Përmbledhje fillestare e reagimeve.* (17 mars 2025), <https://cdt.org/insights/dsa-civil-society-coordination-group-publishes-an-initial-analysis-of-the-major-online-platforms-risks-analysis-reports/>

²²³ V. Vilck dhe E. Vialle, *Nuk ka justifikim për abuzim.* PEN Amerikan (2021), <https://pen.org/report/no-excuse-for-abuse/>

²²⁴ M. Motyl dhe G. Ellingson, *Kostoja e padurueshme e lartë e shkurtimeve të këndeve të besimit dhe sigurisë.* Politika e Teknologjisë në Shtyp (4 janar 2024), <https://www.techpolicy.press/the-unbearably-high-cost-of-cutting-trust-safety-corners>.

²²⁵ T.L. Harel, *Gjendja e ngacmimit në rrjet dhe mundësitë për bashkëpunim.* SoS Në rrjet (2020), fq.27-29, <https://drive.google.com/file/d/10tF2fcdBkldOT9Qm9lAbkF-oyQxl-xzJ/view>; N. Aljizawi dhe të tjerë, *Nuk ka shpëtim: Përdorimi i gjinisë si armë për qëllime të represionit digjital transnacional.* Raporti hulumtues i The Citizen Lab (dhjetor 2024), fq.3-6.

jëherësh, nuk mund të adresohet në mënyrë efektive me sistemet aktuale të moderimit të përmbajtjes.

- **Ndryshimet në politikat e Meta për moderimin e përmbajtjes** në janar 2025, krahas uljes së përgjithshme të prioritetit të infrastrukturës së sigurisë dhe moderimit, e **kategorizojnë përmbajtjen** që bie ndesh me kushtet e shërbimit sipas një shkalle vlerësimi shkeljesh nga **“më pak e rëndë” deri te “më e rëndë”**, sistem ky më subjektiv, **i paqartë dhe me kritere të papërcaktuara mirë**. Meta ka njoftuar se vetëm shkeljet e etiketuara si “më të rënda” do të moderohen me automatizëm, kurse përmbajtja e klasifikuar si “më pak e rëndë” do të largohet, ose do t’i ulet dallimi, vetëm pas raportimeve individuale të përdoruesve, me kushtin që përdoruesi raportues të ketë një nivel të caktuar besueshmërie në platformë.²²⁶ Mbetet për t’u parë se si do të ndikojë kjo në sigurinë e përdoruesve dhe, në veçanti, të gazetarëve që përdorin shërbimet e Meta, por parashikimet nuk janë premtuese duke pasur parasysh vlerësimet për rritje të dhunës në rrjet pas ndryseve të ngjashme të politikave në X/Twitter.²²⁷

Efektiviteti i rregulloreve (ndër)kombëtare

Rregulloret e BE-së për platformat, veçanërisht dispozitat e ASHD-së lidhur me rreziqet sistemike, moderimin e përmbajtjes, detyrimet për kujdes të duhur, sinjalizuesit e besueshëm dhe mekanizmat e zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, janë të rëndësishme për sigurinë e gazetarëve.²²⁸

²²⁶ J. Hendrix, “Transkripti: Mark Zuckerberg paralajmëron ndryshime të mëdha në politikat dhe operacionet e moderimit të përmbajtjes së Meta. *Politika teknologjike për mediat* (7 janar 2025), <https://www.techpolicy.press/transcript-mark-zuckerberg-announces-major-changes-to-metas-content-moderation-policies-and-operations/>

²²⁷ Për analizën e dhunës në rrjet në Twitter dhe ndryshimet e politikave, shihni, për shembull, një dokumentar nga BBC Panorama të përgatitur së bashku me Qendrën Ndërkombëtare për Gazetarët dhe Universitetin e Sheffieldit (korrik 2023), <https://www.bbc.co.uk/programmes/m001jwb5>. Për një vlerësim të parë në lidhje me dhunën me bazë gjinore në Meta, të kryer nga Observatori Evropian i Urrejtjes Në rrjet, shihni “Si ndikojnë politikat e reja të Meta-s për Moderimin e përmbajtjes në dhunën me bazë gjinore (qershor 2025), <https://eohp.eu/articles/meta/online/gender/based/violence/content/moderation>.

²²⁸ Komisioni Evropian, *Studim mbi zbatimin në praktikë nga shtetet anëtare të Rekomandimit për mbrojtjen, sigurinë dhe fuqizimin e gazetarëve - Raporti përfundimtar*. Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian (2024), fq.49, <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/bca5a5bd-090a-11ef-a251-01aa75ed71a1/language-en>

Sipas Nenet 22 të ASHD-së, sinjalizuesit e besueshëm,²²⁹ të emëruar nga koordinatorët kombëtarë të shërbimeve digjitale (KSHD), pritet të luajnë rol kyç në identifikimin dhe raportimin e përmbajtjes së kundërligjshme, përfshirë përmbajtjen që shënjestron gazetarët, me qëllim që të nxitet shqyrtimi i shpejtë dhe i plotë i saj nga platformat. Emërimi, nga KSHD gjerman, i një organizate të shoqërisë civile puna e së cilës fokusohet në gjuhën e urrejtjes përbën një rast interesant studimi lidhur me zbatimin e kësaj dispozite në praktikë. Krahas kësaj, dispozitat e ASHD-së për zgjidhjen jashtëgjyqësore të kontesteve²³⁰ u krijojnë gazetarëve një rrugë për t'i kundërshtuar vendimet e platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë kur reagimet e këtyre të fundit janë të pamjaftueshme ose jo-proporcionale. **Edhe AELM mund të shërbejë si mbrojtje e rëndësishme.** Neni 4, në veçanti, parasheh **garanci specifike për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, duke ndaluar mbikëqyrjen shtetërore,** përveç rasteve kur ka autorizim paraprak nga gjyqësori ose nga një organ i pavarur, ose në rrethana të jashtëzakonshme dhe urgjente. Megjithatë, këto “raste të jashtëzakonshme dhe urgjente” nuk janë të përcaktuara qartë dhe janë identifikuar si boshllëqe të mundshme ligjore që mund të dëmtojnë mbrojtjen efektive të gazetarëve.²³¹ Legjislacioni i ardhshëm në nivel kombëtar duhet të parashohë gjithashtu mekanizma mbikëqyrës për të siguruar që “ligjet të jenë të mbrojtura nga abuzimi”.²³²

Efektiviteti i ASHD-së dhe AELM-së do të varet nga zbatimi i tyre dhe nga shkalla në të cilën ato ndikojnë në sjelljen e platformave në praktikë, përfshirë edhe sa i përket sigurisë së gazetarëve. Për shembull, fokusi i ngushtë i vlerësimit vetëm në përmbajtje të kundërligjshme, që aplikohet nga sinjalizuesit e besueshëm ose nga mekanizmat për zgjidhjen jashtëgjyqësore të kontesteve, mund të

229 Bundesnetzagentur, Miratimi i parë për sinjalizuesit e besueshëm për platformat në rrjet në Gjermani, Bundesnetzagentur Press (2024), https://www.bundesnetzagentur.de/SharedDocs/Pressemitteilungen/EN/2024/20240927_DSC_Trusted_Flagger.html

230 N. Shengelia, “Akti për sinjalizuesit e besueshëm dhe shërbimet digjitale: Implikimet ekstraterritoriale për Gjeorgjinë si vend kandidat për anëtarësim në BE. *Fondacioni 3CL* (6 janar 2025), www.3cl.org/trusted-flaggers-and-the-digital-services-act-extraterritorial-implications-for-georgia-as-an-eu-candidate-country/

231 J. E. Kermer, “Neni 4 i Aktit evropian për lirinë e mediave: Një mundësi e humbur?: Vlerësim i mangësive të saj në mbrojtjen e burimeve gazetareske” Tek *Punime nga Konferenca e njëmbëdhjetë shkencore ndërkombëtare e Departamentit të Studimeve Evropiane: Agjenda e ciklit të ri institucional të BE-së* (Sofje, Minerva 2024), fq.193, <https://cadmus.eui.eu/handle/1814/77470>

232 Po aty.

bëjë që në praktikë të përjashtohen forma të ndryshme të dhunës në rrjet. Sidoqoftë, fakti që në rrethana të caktuara mekanizmat e ankimit dhe sinjalizuesit e besuar mund të jenë të qasshëm edhe për qytetarë që nuk janë shtetas të BE-së është zhvillim pozitiv.

Të frymëzuara nga rregullimi i platformave digjitale në BE, edhe shtetet tjera po miratojnë korniza rregulluese kombëtare që adresojnë sigurinë në rrjet. Për shembull, Akti për sigurinë në rrjet i Mbretërisë së Bashkuar dhe Akti për dëmet në rrjet i Kanadasë ndjekin në masë të madhe logjikën rregulluese të ASHD-së, por e zgjerojnë fushëveprimin për të adresuar forma të caktuara të përmbajtjes së dëmshme.²³³

Në mbarë hapësirën e OSBE-së, ligjvënësit kombëtarë kanë vënë në zbatim masa mbrojtëse të përshtatura sipas gjinisë për gazetaret, duke njohur rrezikun e shtuar ndaj të cilit ato ekspozohen në hapësirën në rrjet. Si një nga mbrojtësit e parë ndërkombëtarë të lirisë së medias, Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias i ka njohur sulmet në rrjet kundër grave gazetare si sfidë sistemike për lirinë e medias që në vitin 2015 dhe, që atëherë, ka ofruar udhëzime politike për masa të posaçme sigurie të ndjeshme ndaj dimensionit gjinor.²³⁴ Në vitin 2018, nëpërmjet Vendimit të Këshillit Ministror për sigurinë e gazetarëve, të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u zotuan të ndërmarrin masa efektive për ta rritur sigurinë e gazetarëve, duke i njohur shprehimisht rreziqet e veçanta me të cilat përballen gratë gazetare, sidomos në sferën digjitale.²³⁵ Në vitin 2023, një koalicion prej 45 shtetesh pjesëmarrëse të OSBE-së u zotua që t'u kërkojë platformave digjitale t'i përmbushin më mirë përgjegjësitë e tyre për respektimin e të drejtave të grave gazetare dhe t'i bazojnë politikat dhe praktikat e tyre në të drejtat e njeriut.²³⁶

²³³ Gjithashtu të cekura në kontributin e Ofcom-it për këtë iniciativë, <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/581821>.

²³⁴ Për informacion të mëtejshme, shihni projektin e OSBE-së për sigurinë e gazetarëve në rrjet (SOFJO), <https://www.osce.org/fom/safety-female-journalists-online>.

²³⁵ Vendimi i Këshillit Ministror të OSBE-së Nr.3/18 mbi sigurinë e gazetarëve, MC.DEC/3/18, <https://www.osce.org/chairpersonship/406538>

²³⁶ Deklarata e përbashkët e OSBE-së mbi sigurinë e gazetarëve (2023), <https://www.osce.org/chairpersonship/559833>

Së fundmi, disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së²³⁷ kanë kodifikuar dispozita penale që sanksionojnë shpërndarjen jokonsensuale të imazheve intime (SHJKII), përfshirë edhe ato të rreme. Po ashtu, shumë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së i kanë përafruar kornizat e tyre ligjore me Konventën e Stambollit të Këshillit të Evropës,²³⁸ që adreson shprehimisht dhunën digjitale. Përkundër këtyre zhvillimeve, ende mbeten mangësi, përfshirë sa i përket zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe llogaridhënies së kryerësve dhe ndërmjetësve. Një studim i vitit 2018 nga *RrjetLab* vë në dukje se shumica e ligjeve për SHJKII-në nuk arrijnë të qartësojnë përgjegjësinë e platformave dhe as nuk parashohin detyrime për largimin e përmbajtjes.²³⁹

Legjislacioni kombëtar që trajton mbrojtjen e gazetarëve nga dhuna e mundësuar nga teknologjia është i pakët dhe, si rrjedhim, mekanizmat e mbrojtjes vazhdojnë të mbështeten kryesisht në kornizat e fushëveprimit të sistemit të drejtësisë penale. Mekanizmat ekzistues të bashkëpunimit ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit dhe platformave në përgjithësi nuk janë transparentë, gjë që e bën thuajse të pamundur vlerësimin e fushëveprimit dhe procedurave operative të tyre, por edhe zbulimin e abuzimeve të mundshme. Bazuar në informacionin e kufizuar në dispozicion,²⁴⁰ ky bashkëpunim duket se përqendrohet kryesisht te veprat e rënda penale, siç janë abuzimi me fëmijë dhe terrorizmi, ndërsa mbetet e paqartë nëse ka përpjekje të koordinuara që adresojnë dhunën në rrjet ndaj gazetarëve. Në mënyrë paradoksale, fushëveprimi i ndërhyrjeve rregulluese në këtë fushë nuk është përqendruar në adresimin e mangësive të mirë dokumentuara të moderimit të përmbajtjes ose në avancimin kuptimplotë të veçorive të sigurisë, përkundrazi nismat përkatëse **janë shtyrë përpara kryesisht nga aktorë jo shtetërorë.**

237 Fondacioni Share, *Pornografia hakmarrëse: Analizë krahasuese në Evropën Juglindore*. (Maj 2022), <https://cms.seedigitalrights.network/wp-content/uploads/2022/05/Comparative-analysis-short-version-non-consensual-processing.pdf>; L. Scepanovic, "Pornografia hakmarrëse është e ndëshkueshme me ligj në Mal të Zi." *Radio Evropa e Lirë* (20 dhjetor 2022), <https://www.slobodnaevropa.org/a/crna-gora-osvetnicka-pornografija-drustvo-zakonodavstvo/32186029.html>

238 Komisioni Evropian, *Studim mbi zbatimin në praktikë nga shtetet anëtare të Rekomandimit për mbrojtjen, sigurinë dhe fuqizimin e gazetarëve - Raport përfundimtar*. Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian (2024), fq.65.

239 Shihni tek: Qendra për Media, Teknologji dhe Demokraci, rreth aktit për dëmet në rrjet, <https://www.mediatechdemocracy.com/about-c63>

240 Meta, Zbatimi i ligjit, Qendra e Sigurisë Meta, <https://about.meta.com/actions/safety/audiences/law>

Ndërhyrjet gjithëpërfshirëse dhe sistematike që adresojnë sigurinë e gazetarëve është më e vështirë të realizohen në kontekste ku angazhimi i platformave është i kufizuar (ose mungon), ose kur nuk sigurohet shqyrtim i shpejtë i rasteve të raportuara të dhunës. Shoqëria civile ka bërë përpjekje që ta mbushë këtë boshllëk duke krijuar **kanale të përshkallëzimit** në platforma, që **mundësojnë shqyrtim dhe zgjidhje të shpejtë të rasteve të dhunës në rrjet.**²⁴¹ Duke qenë joformale për nga natyra, këto kanale të përshkallëzimit shpesh mbështeten në lidhje personale me përfaqësues të platformave ose në partneritete me organizata të konsoliduara.²⁴² Në këtë drejtim, platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë kanë krijuar po ashtu edhe programe të partnerëve të besuar me organizata të shoqërisë civile. **Kanalet e përshkallëzimit dhe programet e partnerëve të besuar mund të shërbejnë si mekanizma efektivë për gazetarët, mirëpo u mungon qëndrueshmëria,** ngase shumë syresh krijohen në baza të *posaçme*, vetëm në juridiksione të caktuara, dhe varen nga politikat dhe vullneti i mirë i platformave.

Për t'i adresuar këto mangësi, shumë shtete evropiane kanë miratuar **mekanizma kombëtarë sigurie** që synojnë rritjen e **bashkëpunimit ndërmjet shtetit dhe aktorëve të medias.**²⁴³ Megjithatë, **shumica e këtyre mekanizmave nuk e adresojnë shprehimisht dhunën në rrjet.** Modelet e bashkëpunimit ndryshojnë dukshëm nga njëri shtet në tjetrin, nga një memorandum mirëkuptimi në Itali, te një plan veprimi në Danimarkë, e deri te një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet policisë dhe gazetarëve në Kroaci.²⁴⁴ Edhe struktura e bashkëpunimit ndryshon varësisht nga shteti. Në Serbi dhe, në mënyrë të ngjashme, në Bosnjë dhe Hercegovinë, është krijuar një sistem personash kontakti, përfshirë juristë të specializuar në fushën e mediave, përfaqësues të organeve të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit, për t'i mbështetur gazetarët

241 V. Vilck dhe E. Vialle, *Nuk ka justifikim për abuzim*. PEN Amerika (2021), <https://pen.org/report/no-excuse-for-abuse/>

242 Intervistat. *Siguria në rrezik: Si të shpëtohet programi i partnerëve të besuar të Meta-s.* (2023), <https://internews.org/resource/safety-at-stake-how-to-save-metas-trusted-partner-program/>

243 Reagimi i shpejtë për lirinë e medias, Evropë: Katalogu i përditësuar për mbrojtjen e gazetarëve, <https://www.article19.org/resources/europe-directory-to-protect-journalists/>

244 Komisioni Evropian, *Studim mbi zbatimin në praktikë nga shtetet anëtare të Rekomandimit për mbrojtjen, sigurinë dhe fuqizimin e gazetarëve - Raporti përfundimtar*. Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian (2024), f 65.

që janë shënjestër e ngacmimeve në rrjet.²⁴⁵ Një sistem i ngjashëm në Holandë siguron ofrim të mbështetjes, përfshirë kanale bashkëpunimi me gjyqësorin dhe organet e zbatimit të ligjit.²⁴⁶ Një nismë holandeze, *PersVeilig*, e ka zyrtarizuar bashkëpunimin ndërmjet shtetit dhe mediave për mbrojtjen e gazetarëve, përfshirë në mjedisin në rrjet, nëpërmjet nënshkrimit kolektiv të një protokollit për sigurinë e medias. Kjo nismë ka marrë së fundmi fonde të konsiderueshme për ta zgjeruar punën në tërë BE-në.²⁴⁷ Sipas një studimi të Komisionit Evropian mbi mekanizmat e sigurisë në shtetet e BE-së, vetëm gjashtë shtete (Danimarka, Franca, Gjermania, Irlanda, Italia dhe Holanda) kanë krijuar struktura formale për angazhim me platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë (dy prej tyre janë vetëm në mënyrë joformale), gjë që vë në pah boshllëkun e madh në përpjekjet për të mbrojtur sigurinë në rrjet të gazetarëve.²⁴⁸ Për më tepër, **asnjëra nga këto nisma sigurie nuk e lufton sistematikisht abuzimin (në rrjet) me bazë gjinore.**²⁴⁹

Rol vendimtar në monitorimin e rreziqeve në rrjet ndaj gazetarëve kanë po ashtu edhe aktorët jo shtetërorë, si organizatat e gazetarëve dhe organizatat e shoqërisë civile. Platforma për Sigurinë e Gazetarëve (e udhëhequr nga Këshilli i Evropës)²⁵⁰ dhe Reagimi i Shpejtë për Lirinë e Medias (e drejtuar nga shoqëria civile)²⁵¹ kanë dokumentuar incidente dhe kanë avokuar për masa më të fuqishme mbrojtjeje. Pakoja e instrumenteve për sigurinë e gazetarëve e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias ofron një pasqyrë të instrumenteve dhe nismave kombëtare në mbarë rajonin e OSBE-së.²⁵² Shumë organizata

245 Neni 19, *Mbrojtja e gazetarëve në Serbi, mësimet nga grupi i përhershëm punues për sigurinë e gazetarëve (Stalna radna grupa za bezbednost novinara)*, Reagimi i shpejtë për lirinë e medias (2023), <https://www.article19.org/resources/europe-directory-to-protect-journalists/>

246 Neni 19, *Mbrojtja e gazetarëve në Holandë, mësimet nga PersVeilig (Siguria e medias)*. Reagimi i shpejtë për lirinë e medias (2023), https://www.article19.org/wp-content/uploads/2023/11/A19-MFRR-Briefing_Netherlands_FINAL.pdf

247 R. Ó Fathaigh, "Qeveria holandeze zbaton masa shtesë për sigurinë e gazetarëve" Në *vrojtimet ligjore të IRIS-it të Observatorit Evropian Audiovizual* (2025), <https://merlin.obs.coe.int/article/10215>

248 Komisioni Evropian, *Studim mbi zbatimin në praktikë nga shtetet anëtare të Rekomandimit për mbrojtjen, sigurinë dhe fuqizimin e gazetarëve - Raporti përfundimtar*. Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian (2004), fq.65.

249 Po aty, fq.44.

250 Këshilli i Evropës. (pa datë). Platforma për të promovuar mbrojtjen e gazetarëve dhe sigurinë e gazetarëve, <https://fom.coe.int/en/accueil>

251 Reagimi i shpejtë për lirinë e medias, <https://www.mfrr.eu/monitor/>

252 Pakoja e mjeteve e OSBE-së për sigurinë e gazetarëve, <https://osce-soj.glide.page/dl/54886d>

të shoqërisë civile kanë bërë thirrje që përpjekjet për monitorim të përplotësohen me një gamë më të larmishme dhe gjithëpërfshirëse të ndërhyrjeve shtetërore, si dhe mbështetje të përshtatur sipas përvojave të vetë gazetarëve. Kjo mbështetje duhet të përfshijë edhe kontributet e grave gazetare dhe të personave nga radhët e komuniteteve të nënpërfaqësuar ose historikisht të marginalizuara, të cilët, ndonëse e përjetojnë në mënyrë disproporcionale ndikimin e dhunës në rrjet, shpesh mbeten jashtë diskutimeve.²⁵³

Përpjekjet për të promovuar sigurinë e gazetarëve në rrjet janë të ndërvarura — përgjegjësia e secilit aktor ndërlidhet me përgjegjësinë e të tjerëve dhe vendimtare për arritjen e rezultateve kuptimplote dhe për zgjidhjen efektive të rasteve. Ndërhyrjet dhe masat për adresimin e sigurisë së gazetarëve nga një perspektivë gjithëpërfshirëse mbështeten kryesisht në ndërhyrje shtetërore, të cilat duhet të përkrahen dhe mbështeten nga një ekosistem aktorësh.²⁵⁴ **Siguria e gazetarëve është po aq pasojë e modeleve të biznesit të platformave, infrastrukturës dhe mungesës së llogaridhënies, sa është edhe çështje e rendit ligjor dhe e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga shtetet.**

²⁵³ Për shembull, Koalicioni kundër Dhunës Në rrjet, <https://onlineviolenceresponsehub.org/about-the-coalition-against-online-violence>

²⁵⁴ M. Husovec, "Duke u ngritur mbi përgjegjësinë: Akti për shërbimet digjitale si plan për gjeneratën e dytë të rregullave botërore të rrjetit," Në *Revistën e së drejtës për teknologjinë Berkeley*, Vëll.38, Nr.3 (2023), fq.621–652, https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=4598426

7.2 Masat zbutëse që synojnë rritjen e sigurisë së gazetarëve në periudhën afatshkurtër

Siguria e gazetarëve është përgjegjësi e përbashkët dhe kërkon angazhim të mirëfilltë shumëpalësh, si dhe bashkëpunimin ndërkuftar. Shtetet, si garantues përfundimtarë të të drejtave të njeriut, dhe platformat, si mundësuese kryesore të dhunës në rrjet, disponojnë një gamë të gjerë instrumentesh dhe ndërhyrjesh të mundshme.

Siguria e gazetarëve (përfshirë dhunën në rrjet ndaj tyre) është problematikë që shpesh shkon në korrelacion me regresin **demokratik, polarizimin politik ose trazirat shoqërore,** gjë që nxjerr në pah cenimin e lirisë së medias në mjedise në rrjet që mundësojnë përhapjen me lehtësi të urrejtjes.²⁵⁵ Efektet janë posaçërisht të dukshme në kontekste ku institucionet demokratike janë të brishta ose ku sundimi i ligjit është i dobët.²⁵⁶ Për këtë arsye, **masat e politikave dhe ndërhyrjet shtetërore duhet ta trajtojnë dhunën në rrjet në raport të drejtpërdrejtë me kërcënime tjera të ndërthurura të sigurisë,** siç janë dhuna fizike dhe ajo ligjore. Kjo dhunë përfshin ndalimin arbitrar, ndjekjen penale, legjislacionin

²⁵⁵ UNESCO, *Klima e frikësimit: Trendet botërore të dhunës në rrjet ndaj gazetarëve*. Punim hulumtues për diskutim (2021), fq.13

²⁵⁶ Në mënyrë të ngjashme, vrasjet e gazetarëve mund të shoqërohen me nivelin e lartë të korrupsionit në shtete. M. Žuffová dhe R. Carlini, "Siguria e gazetarëve në Evropë: Rreziqet dhe praktikatat më të mira për t'i trajtuar ato" Në *Punimin kërkimor të Qendrës Robert Schuman për Studime të Avancuara* Nr.RSCAS 2021/43 (2021), fq.1; C. Tenove dhe të tjerë, *Jo vetëm fjalë - Si sulmet ndaj reputacionit dëmtojnë gazetarët dhe minojnë lirinë e shtypit*. Qendra Botërore e Raportimit (2023)

kufizues, paditë strategjike kundër gazetarëve (SLAPP) dhe kapjen e medias. Vetëm përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, që njeh ndërthurjen e këtyre kërcënimeve, mund të sigurohet që kanalet e mbrojtjes dhe zgjidhjet për kërcënimet e sigurisë të jenë efektive dhe të qëndrueshme.

Veçoritë e sigurisë

Shtetet duhet t'i inkurajojnë dhe t'u krijojnë stimuj platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë dhe zhvilluesve të IA që të **dizajnojnë veçori të reja sigurie, dhe t'i avancojnë ato ekzistuese**, që ofrojnë masa parandaluese, proaktive dhe reaguese. Këto masa duhet të shoqërohen me **garanci kundër keqpërdorimit** për censurë dhe për dëme të tjera digjitale, përfshirë sigurimin e mbrojtjes në mjedise mediatike kufizuese.²⁵⁷ Kjo mund të arrihet përmes angazhimit të vazhdueshëm, në përputhje me standardet ndërkombëtare të lirisë së shprehjes, dhe të lehtësuar nga procese gjithëpërfshirëse shumëpalëshe, idealisht në nivel ndërkombëtar. Shtetet duhet t'i marrin në konsideratë treguesit e dhunës në rrjet ndaj mediave dhe karakteristikat e përbashkëta të rasteve serioze e rreziqeve të përshkallëzimit ndaj të cilëve duhet reaguar menjëherë (p.sh. kërcënimet me vdekje).²⁵⁸

Veçoritë e sigurisë duhet të zhvillohen duke marrë parasysh ndërveprimin e të gjitha dimensioneve të sigurisë, e jo duke i trajtuar ato si të izoluar (nëpërmjet një prizmi gjithëpërfshirëse dhe ndërthurës), duke i dhënë përparësi pjesëmarrjes së të gjitha palëve të interesit, ndërveprueshmërisë ndërmjet sistemeve të ndryshme teknologjike dhe standardeve teknologjike me qasje të hapur. Këto masa duhet të ofrojnë veçori parandaluese, proaktive dhe reaktive:

- **Veçoritë parandaluese** duhet të përfshijnë vegla për vlerësim të rrezikut në kohë reale dhe rrjedha të të dhënave në platformat e rrjeteve sociale, mekanizma paralajmërimi të hershëm dhe protokolle për situata krizash;

²⁵⁷ J. Hendrix dhe të tjerë, "Çka është e sigurt? Analizë e aplikacioneve të popullarizuara të mesazheve", *Politikat e teknologjisë së medias* (2023), <https://cdn.sanity.io/files/3tzzh18d/productio/n/249bacf0c26005325181333271be32e92024e0e5.pdf>

²⁵⁸ Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, *Udhëzime për monitorimin e dhunës në rrjet ndaj gazetarëve*. (Tetor 2023), <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/553951>

- **Veçoritë proaktive** duhet të përfshijnë vegla për identifikim të rrezikut, vegla për kontroll dhe zbutje të rrezikut, si dhe forma të tjera të kontrollit të shtuar nga përdoruesit, si procese më të forta vërtetimi për të parandaluar komprometimin e llogarive dhe mekanizma për mbrojtjen e komunikimeve të ndjeshme (p.sh., “modalitet i posaçëm sigurie për gazetarët”).
- **Veçoritë reaktive** përfshijnë rritjen e efikasitetit të veçorive ekzistuese të sigurisë dhe mekanizmave të korrigjimit, panele të posaçme dokumentimi dhe sigurie,²⁵⁹ veçori të koordinuara për mbështetje nga palë të treta vëzhguese që u mundësojnë personave që nuk janë shënjestër e drejtpërdrejtë të ndërhyjnë në rastet e dhunës në rrjet ndaj gazetarëve dhe të ofrojnë qasje të lehtë në linja ndihmëse për personat e prekur, linja telefonike të dedikuara me ekipe të qasshme sipas rajonit/shtetit, dhe kanale përshkallëzimi, përfshirë përmes përfaqësimit në të gjitha juridiksionet;²⁶⁰

Integrimi i sigurisë në dizajn

Shtetet duhet t’u kërkojnë platformave në rrjet të dëshmojnë, me prova të qarta, se **dizajni dhe zhvillimi i veçorive të tyre të sigurisë përputhen me parimet e “sigurisë së integruar në dizajn”**. Termi “siguri e integruar në dizajn” i referohet një qasjeje proaktive ndaj dizajnit dhe zhvillimit të platformave dhe produkteve, ku siguria e përdoruesve përbën konsideratë qendrore që nga fillimi, nëpërmjet arkitekturës së platformës, politikave dhe proceseve që minimizojnë rrezikun dhe dëmin ndaj përdoruesve nga kërcënime si ngacmimi në rrjet, fushatat e shpifjes dhe shfrytëzimi. Ky detyrim duhet të zbatohet nëpërmjet auditimeve formale, të rregullta dhe të pavarura të dizajnit, si dhe mekanizmave të pajtueshmërisë.

²⁵⁹ Për shembull, PEN America rekomandoi që kompanitë e mëdha të teknologjisë të vendosin të ashtuquajturat ‘mburoja’ për të filtruar drejtpërdrejt fushatat e koordinuara të shpifjes dhe ngacmimit e shumta ku një gazetar sulmohet në mesazhe të drejtpërdrejta, tema diskutimi dhe media sociale njëkohësisht dhe nga një grup i madh njerëzish, shihni <https://pen.org/report/treating-online-abuse-like-spam>.

²⁶⁰ V. Vilks dhe E. Vialle, *Nuk ka justifikim për abuzim*. PEN Amerika (2021)

Qasja e sigurisë së integruar në dizajn mund të realizohet përmes:

- **Përfshirjes së përdoruesve të veçorive të sigurisë** në zhvillimin e tyre, për t'i kuptuar dhe adresuar nevojat e tyre,²⁶¹ përfshirë edhe detyrimin që në fazën e paraprosjektimit të veglave dhe masave të sigurisë të ketë **pjesëmarrje kuptimplotë**²⁶², të drejtpërdrejtë dhe të informuar të gazetarëve, aktorëve të medias dhe personave tjerë të prekur nga dhuna në rrjet;
- Sigurimit të **mbikëqyrje nga njeriu** në çdo etapë të zhvillimit të tyre, vënies në përdorim dhe zbatimit të produkteve dhe politikave që lidhen me sigurinë,²⁶³ në mënyrë që të prodhohen rezultate të drejta dhe të ndjeshme ndaj kontekstit. Përfshirja e njeriut duhet të shërbejë si garanci procedurale e vlerësimit dhe balancimit të faktorëve të ndryshëm nga perspektiva e të drejtave të njeriut;²⁶⁴
- Kërkesës për **vlerësime paraprake, të rregullta**, të pavarura dhe të fokusuara **të ndikimit në të drejtat e njeriut**, që shqyrtojnë shprehimisht efektet e produkteve dhe politikave të sigurisë të gazetarët, punonjësit e mediave dhe mediat, përfshirë në kuptimin e rreziqeve të veçanta në aspektin gjinor,²⁶⁵ si dhe ndikimin më të gjerë në lirinë e medias;

²⁶¹ L. Schirch, "Argumentet për administrimin e Skicat të teknologjisë pro-sociale". Në *Rishikimi i politikave të rrjetit*, Universiteti i Notre Dame, Shkolla Keough për çështje botërore (mars 2025), <https://policyreview.info/articles/news/prosocial-tech-design-governance>

²⁶² "Pjesëmarrja kuptimplotë" shkon përtej konsultimit formal ose përfshirjes simbolike. Ajo përfshin angazhim të hershëm dhe të vazhdueshëm me ndikim të konsiderueshëm, që bëhet në mënyrë të sigurt dhe pa frikë nga hakmarrjet. Gjithashtu kërkon qasshmëri, përfshirje dhe mekanizma për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

²⁶³ Kjo është avokuar prej vitësh nga mediat dhe komuniteti i të drejtave digjitale. Shihni Parimet e Santa Clarës mbi Transparencën dhe Llogaridhënien në Moderimin e Përmbytjes, <https://santaclaraprinciples.org/>

²⁶⁴ E. Vargas Penagos, "Platformat në grep? Kërkesat e BE-së dhe të të drejtave të njeriut për përfshirjen e njeriut në moderimin e përmbytjes". *Forumi i Kembrixhit mbi Inteligjencën Artificiale: Ligji dhe Qeverisja* (2025), fq.16, <https://www.cambridge.org/core/journals/cambridge-forum-on-AI-law-and-governance/article/platforms-on-the-hook-eu-and-human-rights-requirements-for-human-involvement-in-content-moderation/63AB46C3687985F39187F923FA9F6341#>

²⁶⁵ L. Slachmijlder dhe S. Bonilla, *Parandalimi me anë të Skicat: Udhërrëfyes për Luftimin e Dhunës me Bazë Gjinore të Mundësuar nga Teknologjia (DHBGJMT) në burim*. Këshilli për Teknologjinë dhe Kohezionin Social (Mars 2025), <https://www.integrityinstitute.org/research/pwojclz543oq3n9uk7ro644y0kcm>

- Forcimit të mjeteve ekzistuese të sigurisë dhe vënies në zbatim të masave të reja, sipas provave, për të adresuar në mënyrë efektive format **e reja dhe kontekstuale** të dhunës në rrjet, duke siguruar që veçoritë e sigurisë të jenë të përshtatshme për kontekste të ndryshme, meqë nuk ka zgjidhje universale për të gjitha rastet; dhe
- Vendosjes së detyrimit që sistemet e rekomandimit të skicohen duke pasur si bërthamë **promovimin e përmbajtjes së sigurt, të larmishme dhe në interes publik** dhe minimizimin e përmbajtjes së lidhur me dhunën në rrjet.

Ndërhyrjet legjislative dhe të politikave

Shtetet duhet ta zbatojnë vendimin e Këshillit Ministror të OSBE-së mbi sigurinë e gazetarëve.²⁶⁶ Në përputhje me standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, **ndërhyrjet legjislative dhe të politikave** për sigurinë e gazetarëve **duhet të parashohin dispozita të posaçme që ofrojnë mbrojtje të shtuar për gazetarët**. Shtetet duhet të shmangin miratimin e dispozitave penale që mund të keqpërdoren për ta kufizuar lirinë e shprehjes. Ndërhyrjet legjislative dhe të politikave që lidhen me sigurinë e gazetarëve duhet të **hartohen në konsultim me të gjitha palët përkatëse të interesit** dhe të mbështeten në vlerësime paraprake dhe të rregullta të ndikimit në të drejtat e njeriut që adresojnë rreziqet specifike ndaj lirisë së medias dhe sigurojnë që masat për zbutjen e rrezikut të jenë efektive dhe vazhdojnë të mbeten të tilla. Shtetet duhet:

- **Të sigurojnë që dispozitat penale të zbatohen** edhe në kontekstin në rrjet dhe të mbulojnë shprehimisht dhunën në rrjet, përfshirë dhunën me bazë gjinore të mundësuar nga teknologjia, si dhe të marrin në konsideratë statusin e personit të shënjestruar si gazetar/e;
- **T'i përshtatin procedurat e sistemit të drejtësisë penale për të siguruar hetimin** në kohë dhe efektiv të dhunës në rrjet, përfshirë përmes bashkëpunimit të strukturuar dhe transparent me platformat

²⁶⁶ Vendimi i Këshillit Ministror të OSBE-së Nr.3/18 mbi sigurinë e gazetarëve, MC.DEC/3/18, <https://www.osce.org/chairpersonship/406538>

digjitale. Ky bashkëpunim duhet të rregullohet me protokolle të qarta, t'i nënshtrohet mbikëqyrjes së pavarur dhe të rishikohet rregullisht;

- Të shqyrtojnë krijimin e një **mekanizmi të pavarur në përbërje të aktorëve nga sektori i medias**, që të shërbejë si trup këshillëdhënës në hartimin, zbatimin dhe realizimin e ndërhyrjeve legjislative dhe të politikave që lidhen me sigurinë e gazetarëve;
- **Të monitorojnë dhunën në rrjet** ndaj gazetarëve dhe t'u kërkojnë platformave të ofrojnë cilësime më të avancuara të privatësisë, si dhe të ofrojnë të dhëna mbi sigurinë, përfshirë të dhëna të grupuara sipas gjinisë, shtetit, formës së sulmit, epilogut të rastit, autorëve dhe elementeve të tjera përkatëse;
- Të krijojnë një **fond të posaçëm solidariteti** për t'i mbështetur gazetarët dhe punonjësit e medias që janë shënjestër e dhunës në rrjet, duke ofruar kompensim si për dëmet socio-ekonomike ashtu edhe për ato psikologjike; dhe
- Të ofrojnë **mbështetje financiare** për aktorët dhe organizatat mediatike që veprojnë si palë të treta vëzhguese, dhe që u ofrojnë ndihmë gazetarëve që përballen me dhunë në rrjet, duke siguruar që autonomia dhe integriteti i tyre të mos komprometohen.

Rregullimi **në zhvillim i platformave në BE mund të shërbejë si katalizator** për hartimin dhe zbatimin e masave kombëtare legjislative dhe të politikave që i japin përparësi sigurisë së gazetarëve. Shtetet duhet:

- T'i zgjerojnë **detyrimet e transparencës së platformave për t'i adresuar shprehimisht rreziqet që lidhen me sigurinë**, përfshirë të dhëna të grupuara sipas shtetit, formës të sulmit, të dhëna mbi epilogun e rastit, autorët etj.;
- Të aplikojnë **vlerësime periodike të detyrueshme të ndikimit të rreziqeve sistemike në lirinë e medias**; dhe

- Të krijojnë **mekanizma të posaçëm ankimi** për trajtimin e ankesave për siguri që parashtrohen nga gazetarët.

Çdo **ndërhyrje ligjore** që synon adresimin e dhunës në rrjet ndaj gazetarëve **duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe parimet e rendit ligjor**. Ajo duhet të përfshijë mekanizma të fuqishëm kontrolli dhe balancimi reciprok për të parandaluar keqpërdorimin e pushtetit dhe për të garantuar mekanizma të qashtëm dhe efektivë të korrigjimit. Pa këto garanci, ndërhyrje të tilla legjislative dhe të politikave nuk duhet të miratohen.

Modele gjithëpërfshirëse dhe kuptimplote shumëpalëshe të sigurisë

Shtetet duhet t'i **intensifikojnë përpjekjet dhe burimet për forcimin e sigurisë në rrjet në suazat e punës së forumeve shumëpalëshe** në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Po ashtu, shtetet duhet ta forcojnë bashkëpunimin e bazuar në të drejtat e njeriut me aktorët ndërkombëtarë, për t'i konsoliduar kornizat e përbashkëta të llogaridhënies dhe për të siguruar që platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë të mbahen përgjegjëse për ndikimin e tyre në sigurinë e gazetarëve. Në veçanti, shtetet duhet:

- T'i zgjerojnë **mekanizmat ekzistues të sigurisë dhe të krijojnë mekanizma të rinj sigurie që bashkojnë aktorët shtetërorë** (përfshirë prokurorinë dhe organet e zbatimit të ligjit), **organizatat mediatike** (si shoqatat e gazetarëve dhe këshillat e medias së shkruar), **mediat** (përfshirë ato më të vogla dhe rajonale), si dhe **gazetarët individualë**. Financimi, rregullat procedurale dhe kornizat e llogaridhënies duhet të hartohen në atë mënyrë që të sigurojnë transparencë dhe bashkëhartim kuptimplotë e aktiv të protokolleve dhe strategjive të sigurisë;
- Të bashkë-hartojnë **protokolle të posaçme sigurie** dhe korniza kombëtare **që adresojnë sigurinë e gazetarëve në mënyrë gjithëpërfshirëse**, me vëmendje të veçantë ndaj qasjeve të ndjeshme ndaj dimensionit gjinor dhe me përfshirjen kuptimplote të gazetarëve, dhe të gazetarëve nga radhët e komuniteteve të nënpërfaqësuar dhe të marginalizuara;

- Të krijojnë **mekanizma financiarë efektivë dhe të qëndrueshëm** për të mbështetur stabilitetin afatgjatë të mekanizmave të sigurisë dhe pjesëmarrjen e medias në dizajnimin e tyre, me fokus të posaçëm në forcimin e kanaleve ekzistuese të përshkallëzimit dhe organizatave partnere të besueshme të angazhuara në mbrojtjen e gazetarëve; dhe
- Të iniciojnë dhe forcojnë mekanizma koordinimi që i **lidhin mekanizmat kombëtarë të sigurisë** dhe strukturat e ngjashme **me përpjekjet ndërkombëtare**, siç është Koalicioni për Sigurinë e Gazetarëve²⁶⁷ ose Koalicioni kundër Dhunës Në rrjet²⁶⁸, dhe të inkurajojnë bashkëpunimin rajonal e botëror me platformat, duke e shfrytëzuar ndikimin kolektiv për të rritur llogaridhënien dhe reagimin ndaj rasteve.

267 https://kq.freepressunlimited.org/themes/safety-of-journalists/networks-and-coalitions/?utm_source=chatgpt.com

268 <https://onlineviolenceresponsehub.org/>

HARPAT

The background features a vertical gradient from dark blue at the top to light teal at the bottom. Overlaid on this are several white, thin contour lines that create a sense of depth and movement, resembling topographic map lines or fluid motion paths. The lines are most prominent in the lower half of the image, where they form a large, abstract shape that could be interpreted as a stylized profile or a landscape feature.

VIJUES

The image features a vertical gradient background transitioning from a light teal at the top to a dark blue at the bottom. Overlaid on this background are several white, thin, irregular lines that form abstract, organic shapes. These shapes resemble stylized profiles of faces or flowing, liquid forms, creating a sense of movement and depth. The overall aesthetic is modern and artistic.

8. Hapat Vijues: Vizioni për të Ardhmen

Duke u mbështetur në analizën e hollësishme të hapësirës së kapur informative dhe në masat zbutëse të nevojshme për adresimin e dëmeve ekzistuese dhe atyre në zhvillim që lidhen me dallimin, stabilitetin financiar dhe vigjilencën e mediave, kjo pjesë ofron udhëzime për kalim nga zbutja drejt transformimit. Ajo shqyrton mënyrat e rikthimit të hapësirës publike të informimit dhe promovimit të një mjedisi mundësues për liri të medias në epokën e algoritmeve dhe IA-së. Kjo pjesë ofron po ashtu edhe udhëzime për reforma strukturore ambicioze për sendërtimin e hapësirave të shëndosha të informimit në rrjet.

8.1 Mënyrë e re të menduari

Ndërkohë që organizatat mediatike dhe gazetarët përballen me presion të jashtëzakonshëm ekonomik, ndërhyrje politike, madje edhe kërcënime fizike, asnjë garanci kuptimplote për lirinë e medias nuk mund të ketë sukses pa u ballafaquar me dhe pa e tejkaluar **kapjen strukturore të ekosistemit digjital të informacionit**. Ky Manual Politikash jep rekomandime për masa zbutëse që synojnë adresimin e sfidave me të cilat përballlet media sa i përket dallimit, qëndrueshmërisë financiare dhe vigjilencës (sigurisë). Megjithatë, këto masa nuk do të jenë të qëndrueshme po nuk u shoqëruan me reagim gjithëpërfshirës dhe me përpjekje të vazhdueshme për të adresuar një nga shkaqet rrënjësore të shumë prej këtyre sfidave: përqendrimin e tepruar të pushtetit në ekosistemin e informacionit.

Prandaj, **vizioni afatgjatë** duhet të shtrihet tej kapërcimit të varësive të mediave dhe të synojë sendërtimin e një media (dhe tregu mediatik)

të pavarur dhe pluraliste, që mundëson debat demokratik dhe qëndrueshmëri shoqërore. Për të siguruar që asnjë aktor të **mos ushtrojë pushtet dominues (efektiv) mbi informacionin, pluralizmi** duhet të garantohet si në rrafshin e larmisë së opinioneve dhe ideve, ashtu edhe në rrafshin e shumëllojshmërisë së ofruesve të shërbimeve mediatike dhe atë të infrastrukturës dhe pronësisë së mediave. Duke i mbajtur parasysh mangësitë më të thella që lidhen me përqendrimin e pushtetit, potencialin për manipulim, dhe modelet dalëse, ndërhyrjet shtetërore duhet mbështeten në korniza qeverisjeje që e forcojnë, e jo mbysin, debatin demokratik dhe synojnë çlirimin e hapësirës së informimit nga pushteti i përqendruar dhe nga kapja strukturore. **Krijimi i një ekosistemi të shëndetshëm të informacionit — pluralist, të lirë dhe të sigurt — nënkupton jo vetëm zbutjen e dëmeve aktuale, por edhe transformimin e ekosistemit përmes ndryshimeve strukturore dhe investimeve të vazhdueshme e afatgjata në infrastrukturën digjitale të orientuar kah interesi publik.** Për ta arritur këtë nevojitet një qasje shumëpalëshe, shumëdimensionale, kuptimplotë dhe gjithëpërfshirëse: **shtetet duhet t’i përmbushin detyrimet e tyre pozitive** për mbrojtjen e lirisë së medias dhe të sigurojnë që kompanitë teknologjike t’i ushtrojnë përgjegjësitë e tyre, njësoj siç pritet nga gjithë aktorët e tjerë që formojnë rrjedhën dhe vlerën e informacionit.²⁶⁹ **Mediat, ndërkaq, duhet të bëjnë zgjedhje teknologjike të përgjegjshme,** të eksplorojnë alternativa dhe të zhvillojnë modele biznesi të pavarura e të qëndrueshme, si dhe oferta informacioni të besueshëm dhe tërheqës për ta rifituar audiencën, njësoj siç edhe **qytetarët duhet të vazhdojnë së kërkuari dhe mbështeturi gazetarinë në interes publik.**

Debatet bashkëkohore mbi IA dhe transformimin digjital të sektorit të medias dhe telekomunikimit zakonisht kuadrohet në terma rreziku, risie, rëndësisë së shpejtësisë, shkallës dhe dominimit të kompanive të mëdha të teknologjisë, kompani që konsiderohen tepër të mëdha

²⁶⁹ Anketa e vitit 2025 mbi mënyrën se si qytetarët e konceptojnë qeverisjen e IA, e realizuar në gjashtë shtete (Brazil, Danimarkë, Japoni, Holandë, Afrikë e Jugut dhe SHBA), arrin në përfundimin se qytetarët dëshirojnë që IA të rregullohet dhe që qeveritë të luajnë rol në përcaktimin se kur IA është e sigurt ose e pasigurt (në vend se ky vendim t’u lihet vetëm kompanive teknologjike). Të anketuarit nga të gjitha shtetet që kanë qenë pjesë e kësaj ankete kanë evidentuar si prioritetin më të rëndësishëm të drejtat e njeriut, pasuar nga mirëqenia ekonomike dhe siguria kombëtare. Shihni S. Morosoli dhe të tjerë, “Studim ndërkombëtar krahasues mbi IA-në dhe gazetarinë” (qershor 2025, <https://www.techpolicy.press/governments-want-to-ease-AI-regulation-for-innovation-but-do-citizens-agree/>).

për t'u rregulluar por dhe tejet të rëndësishme për t'u anashkaluar. Akademikët, shoqëria civile dhe politikëbërësit kanë arsye të forta për t'u shqetësuar për shkallën në të cilën një grusht kompanish teknologjike dirigjojnë formësimin e teknologjive, shërbimeve dhe infrastrukturës së komunikimit nga e cila varen shoqëritë moderne, si dhe për mënyrën në të cilën zhvillimet e reja teknologjike, si IA dhe IA prodhuese, po e konsolidojnë edhe më tej pushtetin ekzistues ekonomik dhe politik.

Po sikur...

- Në vend se të vareshin nga shërbimet e një grusht kompanish jashtëzakonisht të fuqishme të IA, mediat të kishin mundësi të zgjidhnin mes një game të gjerë ofruesish të specializuar të IA dhe infrastrukturës, që konkurrojnë në kuptim të pajtimit me vlerat profesionale, cilësisë së të dhënave për trajnim dhe respektimit të të drejtave themelore të përdoruesve?
- Në vend se të përpiqeshin të arrinin audiencën përmes platformave të rrjeteve sociale, mediat ta shfrytëzonin potencialin e IA dhe të teknologjisë digjitale për të krijuar forma të reja e tërheqëse informimi dhe për të arritur grupe audiencash që tradicionalisht kanë qenë të vështira për t'u arritur?
- Në vend se të shkurtonin financimin për risi mediatik dhe mediat e shërbimit publik, shtetet të investonin në inovacionin mediatik, në zhvillimin e infrastrukturave publike, të ndërveprueshme dhe të përbashkuara (të decentralizuara, por të ndërlidhura), si dhe risi e mediave lokale e rajonale?
- Në vend se të konkurronin dhe të konsolidoheshin, organizatat mediatike, si ato të mëdha ashtu edhe të voglat, të mund të shkëmbenin njohuri, të dhëna, përvoja dhe teknologji, duke e shndërruar solidaritetin dhe bashkëpunimin në vlera të reja themelore profesionale?

- Në vend të të qenit vetëm “spektatorë” dhe marrës pasivë, publiku të trajtohen si partnerë bashkëpunues në projekte inovative mediatike dhe si pjesë e një cikli konstruktiv reagimi, që rrit besimin dhe gatishmërinë për të paguar për gazetari të pavarur?
- Në vend se ta ndërtonin modelin e tyre të biznesit thuajse tërësisht rreth platformave të rrjeteve sociale dhe reklamuesve, financuesit (por edhe vetë mediat) ta kuptonin se shërbimet e informacionit të cilësisë së lartë dhe të udhëhequra nga vlerat sjellin, përtej potencialit ekonomik, vlerë shumë më të madhe për audiencën?
- Në vend se menaxhimi i rreziqeve të sistemeve algoritmike të lihej kryesisht në mëshirën e vullnetit të kompanive të teknologjisë, ose vetëm kapaciteteve të rregullatorëve për të zbatuar detyrimet ligjore që i obligojnë ta bëjnë këtë, politikëbërësit dhe shoqëria të mbështeteshin në një ekosistem përplotësues dhe dinamik kundërpushtetesh, duke i fuqizuar verifikuesit e fakteve, gazetarët, shoqërinë civile, përdoruesit dhe akademikët përmes të drejtave konkrete për informacion, të drejtës për të mos u pajtuar dhe mbështetjes institucionale?

Si shoqëri, **duhet të jemi më ambiciozë për të ardhmen tonë digjitale**, jo të kufizohemi vetëm te çështja se si t’i minimizojmë rreziqet që u kanosen vlerave demokratike, lirisë së medias dhe pluralizmit. **Mungesa e pushtetit monopolist nuk prodhon me automatizëm ekosistem mediatik progresiv**, të larmishëm dhe të pavarur. Përparimi teknologjik nuk është i barasvlershëm me krijimin e vlerës për njerëzit. Inovacioni mund të nënkuptojë edhe risi shoqëror. Teknologjia s’ka pse të jetë gjigante për të qenë e vlefshme ose risi, as nuk është e domosdoshme të mbështetemi te kompanitë e mëdha teknologjike për të vendosur se cilat vlera duhet vënë në plan të parë. Për më tepër, të drejtat themelore të njeriut nuk janë thjesht standarde minimale të sigurisë që presim të respektohen nga zhvilluesit e teknologjisë, por janë edhe **aspiratë dhe gur themele konceptuale** të llojit të shoqërisë në të cilën dëshirojmë të jetojmë. Në këtë frymë, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë zotuar të “shfrytëzojnë çdo mundësi që ofrojnë

mjetet moderne të komunikimit [...] për të rritur përhapjen më të lirë dhe më të gjerë të informacionit të të gjitha llojeve”.²⁷⁰

Adresimi i pabarazive të mëdha të pushtetit, si dhe i varësive informative dhe strukturore që aktualisht e karakterizojnë ekosistemin mediatik, është një ndër sfidat qendrore për rregullatorët dhe politikëbërësit.

Për llogaridhënie më demokratike dhe për të parandaluar përqendrimin e pushtetit ekonomik, teknologjik ose politik, nevojiten korniza rregulluese. Edhe kur korniza të tilla ekzistojnë, krijimi i kushteve për zbatim e tyre efektiv është i vështirë për shkak të stimujve ekonomikë, asimetrive të informacionit, presionit politik, dhe rritjes së popullizmit dhe regjimeve autokratike. Për këtë arsye, dhe si çështje po aq e rëndësishme, shtetet duhet të investojnë edhe në kapacitetin e tyre për të qeverisur, duke ulur varësinë e tyre teknologjike dhe duke investuar në një rrjet të fuqishëm llogaridhënieje të përbërë nga rregullatorë, akademikë, shoqëri civile dhe aktorë të ndryshëm shoqërorë.

Për ta jetësuar potencialin e plotë të teknologjisë dhe të lirisë së medias, nevojitet edhe një vizion pozitiv për llojin e shoqërisë digjitale të cilën dëshirojmë ta ndërtojmë dhe për rolin e teknologjisë në shërbim të këtij vizioni. Pa një vizion të qartë se si duam të duket një e ardhme e dëshirueshme e medias në epokën e IA dhe teknologjive digjitale, nuk është e mundur as të identifikohen rreziqet potenciale që i kanosen një të ardhmeje të tillë, as të krijohen kushtet për një ekosistem mediatik të shëndoshë dhe të qëndrueshëm. Një vizion më gjithëpërfshirës njih gjithashtu dhe potencialin e IA dhe të teknologjive digjitale për t'i shërbyer realizimit të të drejtave të njeriut. IA mbështetet në premisën se ekosistemi mediatik është më i gjerë se platformat dhe organizatat mediatike dhe përfshin një sërë aktorësh të tjerë që, së bashku, përcaktojnë kushtet për realizimin e të drejtave të njeriut, përfshirë reklamuesit, verifikuesit e fakteve, studiuesit, shoqërinë civile, punonjësit e të dhënave, krijuesit e përmbajtjes, ndërmarrjet rishtazi të themeluara, zhvilluesit e teknologjisë, ofruesit e aplikacioneve etj.

270 Dokumenti i Stambollit (1999), <https://www.osce.org/mc/39569>

Prandaj, zotimi ndaj “lirisë së medias si kusht themelor për shoqëri pluraliste dhe demokratike”²⁷¹ duhet të shtrihet përtej menaxhimit të rrezikut dhe rregullimit të kompanive të mëdha të teknologjisë, dhe të nxisë zhvillimin e teknologjive që u ndihmojnë mediave dhe audiencave të përparojnë, të mbrojnë aktorët e ndryshëm në ekosistem dhe të promovojë në mënyrë aktive zhvillimin dhe zbatimin e përgjegjshëm të IA.

8.2 Konsiderata për ndërhyrje nga shteti

Sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të gjitha shtetet duhet t’i **respektojnë, mbrojnë dhe realizojnë të drejtat e njeriut**. Ky detyrim duhet gjithashtu të nënkuptojë që shtetet, si garantues përfundimtarë të pluralizmit, duhet të **krijojnë në mënyrë aktive një mjedis mundësues për lirinë e medias**.²⁷²

Shumë shtete e kanë pranuar faktin se, ndonëse platformat kanë bërë përpjekje vullnetare dhe vetërregulluese, këto përpjekje kanë qenë të kufizuara dhe shpeshherë në diskrecion të vetë platformave. **Ndërhyrja shtetërore është e nevojshme për të siguruar pluralizëm në vend të përqendrimit të pushtetit në sisteme të mbyllura**. Mirëpo, ndonëse ndërhyrja shtetërore është e domosdoshme, ajo **nuk është detyrë e lehtë dhe bart rreziqe të qenësishme të kapjes**, sidomos nga interesat politike. Masat që synojnë kufizimin e pushtetit të kompanive të mëdha të teknologjisë nuk duhet të rezultojnë me forcim të kontrollit shtetëror mbi hapësirat e informacionit. Rastet e ndërhyrjes politike në politikat e dallimit, të zbatuara nga regjime autoritare, ose janë dizajnuar shprehimisht për t’i favorizuar mediat e afërta me shtetin, ose e kanë minuar diversitetin në praktikë, duke mos e garantuar në shkallë të mjaftueshme pavarësinë politike të rregullatorit që i zbaton këto politika. Në kontekste të ekosistemeve

271 Dokumenti përmblyllës nga takimi i tretë pasues, Dokumenti i Vjenës (1986), <https://www.osce.org/mc/40881>

272 Deklarata e përbashkët e vitit 2023 e katër mandatarëve ndërkombëtarë të fjalës së lirë mbi lirinë e medias dhe demokracinë e përkufizon “pluralizmin mediatik” si bashkekzistencë të aktorëve të shumtë, ku përfshihen media publike, private dhe të komunitetit, si dhe përmbajtje të larmishme e gjithëpërfshirëse në dhe përmes mediave, shihni osce.org/files/f/documents/3/2/542676.pdf.

mediatike të kapura²⁷³, politikat që lidhen me dallimin, por edhe me kompensimin ose reklamimin, mund të përdoren, dhe janë përdorur, për ta minuar në mënyrë aktive gazetarinë e pavarur.

Prandaj, politikat që synojnë mbrojtjen e lirisë së medias duhet të hartohen me kujdes dhe të shoqërohen me mekanizma të fuqishëm kontrolli e balancimi reciprok të konceptuar për ta kufizuar kapjen politike. Politikat për lirinë e medias duhet të hartohen përmes proceseve gjithëpërfshirëse, transparente dhe kuptimplota shumëpalëshe, si dhe t'i nënshtrohen shqyrtimit të pavarur gjyqësor dhe proceseve demokratike. Garancitë ligjore dhe institucionale duhet të sigurojnë që çdo autoritet rregullator që zbaton politika për lirinë e medias ose bashkëpunon me platformat digjitale të jetë i strukturuar si i pavarur, i mbrojtur nga interesat politike dhe ekonomike, dhe të ketë mekanizma shqyrtimi të jashtëm. **Për të parandaluar abuzimin ose ndërhyrjen politike, hartimi dhe shkalla e ndërhyrjes shtetërore duhet të përshtatet me kujdes sipas garancive demokratike dhe të rendit ligjor që ekzistojnë.** Aty ku garancitë e rendit ligjor janë të kufizuara (në ligj ose në praktikë) ose ku ekziston rreziku i regresit demokratik, këto garanci duhet të jenë veçanërisht të forta. **Përfundimisht, çdo politikë mediatike duhet të synojë realizimin e parimeve themelore të pluralizmit, pavarësisë dhe lirisë.**

Ky parakusht vlen edhe për situatat kur **rregullimet ekzistuese kopjohen në kontekste të tjera.** Implikimet e rregullimit të platformave në BE, veçanërisht i ashtuquajturit “efekt i përhapjes së ASHD-së” ose “efekt i Brukselit”, tashmë janë subjekt i diskutimeve të gjera në mbarë Evropën Lindore, përfshirë Ballkanin Perëndimor²⁷⁴. Shqetësimet po rriten se, në kontekste të sundimit të dobët të ligjit ose të kapjes së medias, në rrethana ku trupat rregulluese janë të ndikuara politikisht,

273 “Kapja e medias” i referohet një forme dështimi të qeverisjes, në të cilën media i avancon interesat komerciale ose politike të një aktori shtetëror ose jo-shtetëror që kontrollon mjedisin e informacionit, në vend se t’i mbajë grupet e fuqishme përgjegjëse dhe të raportojë në interes të publikut.

274 B. Kostic dhe A. Toskic, *Drejt zbatimit të realizueshëm të Aktit për shërbime digjitale në Ballkanin Perëndimor*. Partners Serbia (2024), <https://www.partners-serbia.org/public/news/dsa-wb-new.pdf>; S. Bajceta, “Ekosistemi digjital i Ballkanit Perëndimor: nga boshllëku rregullator te qasje sistemike.” *Share Foundation* (20 tetor 2024), <https://sharefoundation.info/en/digital-ecosystem-of-the-western-balkans-from-regulatory-gap-to-systemic-approach/>, Shihni gjithashtu: C. S. Wahlqvist, “Vlerësimi i rrezikut si praktikë për frenimin e dezinformimit? Avokuesit në vendet kandidatë të BE-së e mbështesin ende këtë qasje.” *IMS* (27 maj 2025), <https://www.mediasupport.org/blogpost/risk-assessment-a-good-practice-for-curbing-disinformation-eu-candidate-advocates-still-say-yes/>.

tregjet mediatike janë të pazhvilluara ose prania e platformave në rajon është e ulët, përafrimi mund ta rrezikojë lirinë e medias, në vend se ta forcojë atë.²⁷⁵ Prandaj, është jetike që gjatë hartimit dhe miratimit të çdo politike (për liri) të medias të merren parasysh konteksti dhe kapacitetet, si dhe të vendosen **garanci të fuqishme që parandalojnë si keqpërdorimin e qëllimshëm, ashtu edhe pasojat e paqëllimshme që minojnë vetë objektivat që synohen të arrihen.**

Shtetet duhet të bëjnë kujdes edhe nga **kapja private dhe kontrolli i përqendruar** mbi infrastrukturën nga e cilat varet funksionimi i mediave. Përvoja ka treguar se vetërregullimi i platformave është i pamjaftueshëm për ta mbrojtur lirinë e medias. Platformat mund të disponojnë me ekspertizë të vlefshme lidhur me mënyrën se si funksionojnë sistemet e tyre dhe si mund të ndikohen nga politikat mediatike,²⁷⁶ por informacioni që ato ofrojnë nuk duhet të merret si i mirëqenë, përkundrazi duhet të krahasohet me burime të pavarura nga shoqëria civile, institucionet akademike dhe vetë mediat. Roli i platformave në zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e lirisë së medias duhet të kufizohet. Krahas kësaj, duhet të merret parasysh edhe rreziku që organizatat e mëdha dhe të fuqishme mediatike të ushtrojnë ndikim në politikat (për lirinë) e medias. Politikat që funksionojnë për mediat e mëdha nuk janë doemos të përshtatshme për të garantuar sigurinë, stabilitetin financiar, dallimin dhe lirinë e mediave më të vogla, lokale ose të margjinalizuara. Sidoqoftë, **pluralizmi duhet të garantohet si element kyç i lirisë së medias.**

Me pak fjalë, nuk ekziston një zgjidhje e lehtë universale për uljen e varësive strukturore në periudhën afatshkurtër. Për më tepër, ndërhyrjet me politika që synojnë ribalancimin e pushtetit në ekosistemin aktual të informacionit mund t'i **përforcojnë pa dashje varësitë ekzistuese,** meqë mund ta forcojnë pushtetin e platformave mbi shpërndarjen e përmbajtjes, stabilitetin financiar të mediave dhe sigurinë e gazetarëve.

275 Po aty.

276 M. Wijermars, "Ligji rus për sistemet e agregimit të lajmeve: Kush kontrollon rrjedhën, kontrollon lajmet?" në *Journalism Vëll.22* Numri 12 (shkurt 2021), fq.1-17, <https://journals.sagepub.com/doi/full/10.1177/1464884921990917>; A. Kuczerawy dhe J. Quintais, *Politikat e përmbajtjes së detyrueshme: Trajtimi i veçantë dhe liria e shprehjes në platformat në rrjet: Përvoja evropiane*. Instituti për të Drejtën e Informimit (2024); E. Mazzoli, "Vështrim krahasues mbi rregullimin e theksimit të përmbajtjes dhe implikimeve për pluralizmin e mediave. Dokument pune." Në *Konferenca e 49-të hulumtuese mbi politikën e komunikimit, informimit dhe rrjetit* (gusht 2021) https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3898474

Duke i pasur parasysh këto **dinamika të pushtetit** dhe **ndërvarësinë mes** dallimit, qëndrueshmërisë financiare dhe vigjilencës së mediave, çdo ndërhyrje rregulluese duhet të paraprihet nga një proces i kujdesshëm hulumtimi dhe nga vlerësime gjithëpërfshirëse të rrezikut dhe ndikimit.

Në hartimin e çdo ndërhyrjeje që synon ribalancimin e pushtetit dhe rikthimin e pluralizmit mediatik dhe të integritetit të informacionit, shtetet duhet t'i marrin parasysh **parimet kryesore** në vijim:

Për të kuptuar si mund të mbrohet liria e medias përballë transformimeve të shpejta dhe rrënjësore të ekosistemit të informacionit, **transparenca** lidhur me aktorët, teknologjitë dhe funksionimin e sistemeve të informacionit është thelbësore. Transparenca duhet të përfshijë informacione mbi algoritmet, kushtet e shërbimit dhe të dhëna kyçe (p.sh. mbi kërkesat për moderim, largimet e përmbajtjes etj.). Të dhënat që ofrohen duhet të jenë të grupuara për të siguruar qartësi se ku dhe në ç'mënyrë preken gazetarët dhe përmbajtja gazetareske. Po ashtu, nevojiten të dhëna specifike për median lidhur me dhunën në rrjet, siç janë të dhënat që u mundësojnë gazetarëve të vlerësojnë rreziqet, të planifikojnë protokolle sigurie para publikimit, të ndajnë barrën e mbrojtjes dhe të vlerësojnë efikasitetin e moderimit të përmbajtjes.²⁷⁷ Duhet të jetë e mundur që funksionimi i platformave të kompanive të mëdha të vlerësohet me hulumtime të pavarura nga rregullatorët, shoqëria civile dhe vetë mediat. Megjithatë, pavarësisht përparimeve rregullatore në fushën e transparencës, veçanërisht përmes ASHD-së, ka pasur kundërshtime të mëdha ndaj qasjes së studiuesve në të dhëna.²⁷⁸ Për përparim të mirëfilltë, është e nevojshme të hapen edhe të dhënat mbi angazhimin, audiencën, shtrirjen, reklamimin dhe sistemet e matjes, në një mënyrë që garanton kushte të barabarta në tregun digjital.

Efektiviteti i çdo ndërhyrjeje shtetërore varet përfundimisht nga **zbatimi** i saj. Për të siguruar efektivitet, politikat duhet të parashohin gjoha domethënëse për mosrespektim dhe obligime korigjuese, megjithatë këto masa nuk duhet të interpretohen si diskrecion i pakufizuar

277 Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, *Udhëzime për monitorimin e dhunës në rrjet ndaj gazetareske*. (tetor 2023)

278 Shihni, për shembull, <https://dsa-observatory.eu/2025/05/23/researchers-on-data-access-and-preparing-for-dsa-article-404>.

për qeveritë. Përkundrazi, kornizat rregulluese duhet të zbatohen brenda suazave të një sistemi demokratik me ndarje pushtetesh. Politikat mund të zbatohen përmes skemave të vetërregullimit ose bashkë rregullimit, por duhet të mbeten nën mbikëqyrjen e institucioneve publike të pavarura, përfshirë avokatët e popullit dhe institucionet e të drejtave të njeriut. Për të siguruar **llogaridhënie**, çdo plan rregullues duhet të ketë mekanizma të qartë të mbikëqyrjes demokratike, zbatimit dhe ekzekutimit. Pushteti duhet të shpërndahet dhe t'i nënshtrohet kontrollit e balancimit, në përputhje me parimet demokratike.

Mekanizmat e mbikëqyrjes duhet të jenë të **pavarur**,²⁷⁹ të pajisur me burime të mjaftueshme dhe me ekspertizën dhe autoritetin e nevojshëm ligjor. Për të siguruar vazhdimësi, efekte dhe legjitimitet, mbikëqyrja duhet të ndërtohet e të bazohet mbi **proceset pjesëmarrëse**, e institucionalizuar, që përfshijnë gamë të gjerë aktorësh. Vetëm përmes një mbikëqyrjeje të tillë të gjithanshme dhe strukturave gjithëpërfshirëse të qeverisjes mund të sigurohet që ndërhyrjet t'i shërbejnë vërtet interesit publik dhe të mbrojnë nga kapja ose tejkalimi i kompetencave. **Kapaciteti institucional** është vendimtar për ruajtjen e llogaridhënies (përfshirë përshtatjen e ndërhyrjeve me mandatet dhe burimet e institucioneve lokale). Në mjedise me kapacitet të kufizuar institucional, ose në tregje dhe komunitete gjuhësore më të vogla, mbështetja dhe bashkëpunimi i përshtatur sipas kontekstit janë veçanërisht të rëndësishme, përfshirë për mbrojtjen e gazetarëve.²⁸⁰

Personat e kontaktit të caktuar nga platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë për juridiksionet përkatëse duhet të jenë **fizikisht të pranishëm** për të siguruar llogaridhënie. Megjithatë, përvoja ka treguar se afërsia midis platformave dhe autoriteteve shtetërore mund të kontribuojë në raste të caktuara në tkurrjen e hapësirës qytetare dhe mediatike, nëse mungojnë transparenca dhe mbikëqyrja, ose nëse vetë personeli i platformës që punon në fushën e besimit dhe sigurisë u ekspozohet kërcënimeve. Prandaj, çdo bashkëpunim me platformat, qoftë përmes përfaqësuesve ndërlidhës për shtete

279 UNESCO, Udhëzuesi për qeverisjen e platformave digjitale (2023), <https://www.unesco.org/en/articles/guidelines-governance-digital-platforms>

280 C. Arun, *Fytyrat e Facebook*. Forumi i Harvardit për Shqyrtim të së Drejtës 236, <https://harvardlawreview.org/forum/no-volume/facebooks-faces/>

përkatëse, organeve të zbatimit të ligjit apo kanaleve të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar, duhet të bazohet në modele të fuqishme transparence, pavarësie institucionale dhe mbikëqyrjeje demokratike.

Veprimi kolektiv mund të shërbejë si instrument strategjik i rëndësishëm, goftë për të forcuar fuqinë negociuese të medias, për të rritur stabilitetin e lajmeve, për të siguruar masa specifike të dallimit dhe sigurisë në nivel shtetëror, apo për të koordinuar përpjekje shumëpalëshe. **Solidariteti** është veçanërisht i rëndësishëm për rritjen e ndikimit të aktorëve dhe shteteve më të vogla apo të nënpërfaqësuar, me qëllim mbrojtjen e pluralizmit. Gjatë hartimit të politikave, shtetet më të vogla shpeshherë përballen me sfida shtesë, përfshirë në replikimin e kornizave ligjore, për shkak të kufizimeve në burime, kapacitete zbatimi dhe fuqisë negociuese në raport me kompanitë e mëdha të teknologjisë. Bashkëpunimi dhe aleancat rajonale ose shumëpalëshe,²⁸¹ si dhe mbështetja në standardet botërore, mund të luajnë rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

Ndërkohë që dominimi i platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë mbi infrastrukturën e informacionit ka pasoja të veçanta negative për median, **pushteti i përqendruar prek edhe individët dhe shoqërinë në tërësi**. Prandaj, një sërë reformash strukturore dhe ndërhyrjesh politike që synojnë minimizimin dhe zbutjen e përqendrimit e pushtetit, edhe kur nuk janë përkatësisht të orientuara te media, do ta përmirësonin ndjeshëm dallimin stabilitetin financiarë dhe sigurinë e gazetarisë në interes të publikut. Për shembull, “siguria e integruar në dizajn” si qasje universale do t’i ulte rreziqet për të gjithë përdoruesit, përfshirë gazetarët që përballen me dhunë joproporcionale në rrjet. Ndërhyrjet që synojnë rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së sistemeve rekomanduese, përgjegjësisë për rreziqet sistemike ndaj diskursit qytetar dhe rritjen e larmisë së përmbajtjes do të sillnin dobi jo vetëm për gazetarinë, por edhe për integritetin dhe cilësinë e gjithmbarshme të hapësirës së informacionit. Po kështu, ndërhyrjet që synojnë kufizimin e dizajnit që krijon varësi nga sistemet

²⁸¹ Qasja që po shqyrtohet është shfrytëzimi i dialogëve ekzistues midis autoriteteve të BE-së, koordinatorëve të shërbimeve digjitale dhe platformave shumë të mëdha në rrjet duke përfshirë përfaqësues nga vendet kandidatë të BE-së, për shembull brenda kornizës së Procesit të Berlinit, shihni <https://www.berlinprocess.de>.

rekomanduese,²⁸² ose të përdorimit të të dhënave të ndjeshme personale për qëllime reklamimi, do të zvogëlonin mundësitë e përgjithshme për dominim dhe pasojat negative në ekosistemin e informacionit.

282 BE-ja ka bërë të ditur qëllimin për të adresuar “Skica që krijon varësi të produkteve digjitale dhe profilizimit në rrjet”, duke iu referuar karakteristikave dhe algoritmeve që janë projektuar për të maksimizuar angazhimin e përdoruesit dhe për të prodhuar ndërvpreuese, edhe nëse ato zvogëlojnë mirëqenien e përdoruesit duke shfrytëzuar shkaktarët psikologjikë dhe duke i dhënë përparësi postimeve përçarëse ose të ngarkuara emocionalisht, dhe “praktikave joetike dhe komerciale të lidhura me modele të errëta”, përmes një Akti për Drejtësi Digjitale, shihni <https://www.digital-fairness-act.com>.

8.3 Ndryshimet dhe investimet strukture të nevojshme për të lëvizur përtej ekosistemit aktual të informacionit

Një strategji politike dhe rregulluese që synon vetëm zbutjen e aspekteve negative që lidhen me dallimin, stabilitetin financiar ose vigjilencën e medias rrezikon t'u lërë **platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë pushtet të konsiderueshëm**. Ekziston një kufi deri ku mund të "rregullohen" platformat dhe deri ku mund të përshtatet ekosistemi aktual i informimit në rrjet për t'i përmbushur detyrimet për liri të medias.

Shumë nga ndërhyrjet e trajtuara në këtë Manual Politikash do vazhdonin t'ua linin në diskrecion platformave të kompanive të mëdha të teknologjisë vendimmarrjen mbi mënyrën se si ta përshtatin infrastrukturën e tyre për t'i përmbushur kërkesat e reja rregulluese. Edhe nëse zbatimi publik, paditë private ose kërcënimet ndaj reputacionit do t'i shtynin platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë ta respektonin rregullimin përkatës në tërësi, për zbatim do të nevojiteshin kapacitete dhe burime të konsiderueshme, që nuk janë domosdoshmërisht të qasshme për shtetet më të vogla, e aq më pak për organizatat më të vogla mediatike, gazetarët individualë apo profesionistët e pavarur, të cilët janë më të cenueshëm ndaj varësisë nga infrastruktura e kompanive të mëdha të teknologjisë. Për më tepër, zbatimi publik varet edhe nga vullneti politik dhe nga pavarësia e rregullatorëve që kanë për detyrë ta mbrojnë lirinë e medias.

Prandaj, ky Manual Politikash arrin në përfundimin se për ta sendërtuar një media digjitale të pavarur dhe pluraliste është e nevojshme të mendohet në mënyrë më ambicioze për **krijimin e infrastrukturave të reja, alternative dhe të orientuara kah interesi publik**. Momenti gjeopolitik aktual ofron një mundësi unike për ta bërë këtë gjë. Nga njëra anë, ka rritje të vetëdijesimit për faktin se stimujt ekonomikë dhe politikë të kompanive të mëdha të teknologjisë janë në thelb në kundërshti me lirinë e medias, dhe se varësia nga infrastrukturat e tyre i vendos mediat në pozitë të pasigurt, me pasoja serioze për debatin demokratik.²⁸³

Nga ana tjetër, po rritet gatishmëria e disa shteteve dhe e BE-së për të investuar në infrastrukturë alternative ndaj asaj që aktualisht ofrohet nga kompanitë e mëdha të teknologjisë, si dhe për të ndërmarrë nisma për autonomi dhe sovranitet digjital.²⁸⁴ **Ky kombinim mund të shërbejë si pikënisje për ndërtimin e një ekosistemi të shëndetshëm të informimit në rrjet**, që siguron infrastrukturën në interes publik që i nevojitet medias për të funksionuar, pa u mbështetur te kompanitë e mëdha të teknologjisë. Fokusimi në infrastrukturë në interes publik u jep politikëbërësve mundësinë jo vetëm për t'i zbutur kërcënimet ndaj lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes, por edhe për të krijuar një mjedis që i mbështet aktivisht këto liri dhe parimet kryesore të transparencës, kujdesit të duhur dhe llogaridhënies. Në fakt, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë zotuar t'i shfrytëzojnë veglat digjitale për të promovuar shpërndarjen sa më të lirë dhe më të gjerë të informacionit të të gjitha llojeve.²⁸⁵

Një strategji e tillë duhet ta **shfrytëzojë maksimalisht inovacionin dhe teknologjinë në shërbim të interesit publik**. Në raste të caktuara, sidomos kur bëhet fjalë për zhvillimet e fundit në fushën e IA-së, debatet politike mbi teknologjinë priten të përqendrohen në përfitimet financiare nga inovacioni. Ky është një objektivi i rëndësishëm, edhe për mediat dhe stabilitetin e tyre financiare. Megjithatë, një strategji që mbështetet së tepërmi te shfrytëzimi i rrjedhave ekzistuese të të ardhurave për përf-

²⁸³ V. Pickard, "Ristrukturimi i infrastrukturave demokratike: Qasje politikash ndaj krizës në gazetari." Te *Digital Journalism*, Vëll.8, Nr.6 (2020), fq.704-19, <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/21670811.2020.1733433>

²⁸⁴ "Sovraniteti digjital" është etiketuar si imperativ demokratik, shihni, për shembull, <https://www.techpolicy.press/europes-digital-sovereignty-is-a-democratic-imperative>.

²⁸⁵ Dokumenti përmbyllës nga takimi i tretë pasues, Dokumenti i Vjenës (1986), <https://www.osce.org/mc/40881>

itime ekonomike afatshkurtra mund të mos arrijë që t'i fuqizojë mediat në afat të gjatë, si për t'iu përgjigjur preferencave të audiencës, ashtu edhe për ta garantuar pavarësinë e tyre. Investimet duhet të përqendrohen te aftësitë dhe kapacitetet e mediave për të forcuar marrëdhëniet e drejtpërdrejta me audiencën, për të hartuar strategji të të dhënave në përputhje me standardet e mbrojtjes së privatësisë, për t'i rritur të ardhurat vetjake dhe për të shtuar presionin ndaj dështimeve aktuale të tregut. Investimet duhet të orientohen kah inovacioni me natyrë antimonopoliste, që fuqizon individët, promovon tregje dinamike dhe i shërben interesit publik. Për liri të medias, infrastruktura teknologjike në dispozicion të mediave duhet të mbështesë vlerat themelore editoriale, siç është aftësia për të ofruar informacion të besueshëm për segmente të ndryshme të popullsisë dhe për ta ushtruar rolin mbikëqyrës. Nuk ekziston ndonjë qasje universale e saktë për informimin e publikut, përkundrazi, infrastruktura në interes publik që mbron lirinë e medias duhet të mundësojë zhvillimin e teknologjive që mbështesin një gamë të gjerë vlerash për redaksinë dhe shpërndarjen, të përshtatura për nevojat e mediave, popullatave dhe konteksteve të ndryshme.

Infrastrukturë alternative në shërbim të interesit publik

Zhvillimi i një infrastrukture alternative për ekosistemin e informacionit në rrjet, që është e orientuar kah interesi publik, nuk është detyrë e lehtë.

Vlerat afatgjata dhe shpesh abstrakte, si decentralizimi i pushtetit dhe larmia, nganjëherë mbeten në hije përballë objektivave afatshkurtra dhe lehtësisht të matshme në dizajne teknologjike. Sidoqoftë, këto vlera afatgjata janë vendimtare që infrastruktura në shërbim të interesit publik të ofrojë një alternativë të mirëfilltë dhe të dallueshme karshi opsioneve aktuale të avancuara nga kompanitë e mëdha të teknologjisë.

Çdo qasje politike ose rregullatore që synon zhvillimin e infrastrukturës në interes publik duhet të mbështetet në parimin e decentralizimit të pushtetit dhe të kufizojë mënyrat përmes së cilave operatorët e infrastrukturës publike krijojnë, rikrijojnë ose abuzojnë me varësinë e medias. Kjo vlen veçanërisht në situatat kur aktorët shtetërorë luajnë rol në këtë mes. Ndonëse mbështetja shtetërore është mundësuese dhe e rëndësishme, përfshirja e shteteve sjell rreziqe të reja të ndërhyrjes politike. Për t'i zbutur këto shqetësime, duhet të nxirren mësimet nga

debatet mbi shërbimet publike dhe infrastrukturat e tjera, përfshirë sektorin e transmetuesve publikë, ku janë konsoliduar elementë të fuqishëm të pavarësisë dhe decentralizimit. Situata me të cilën përballen aktualisht mediat, të varura dhe të ngujuara në shërbime të ofruara nga një ofrues i vetëm, duhet të shmanget. Në vend të kësaj, nevojitet një fokus i fortë në ndërveprueshmërinë e aspekteve të ndryshme të infrastrukturës. Shtetet duhet po ashtu t'i theksojnë vlerat dhe përfitimet e kodit me burim të hapur dhe të ofruesve lokalë.

Parimet në vijim zbusin rreziqet e krijimit të veglave të reja që mund të shfrytëzohen për kapje:

Shturja e komponentëve dhe garantimi i ndërveprueshmërisë

Shtetet duhet ta bëjnë të obligueshme ndërveprueshmërinë ndërmjet aspekteve të ndryshme të infrastrukturës teknologjike nga e cila varen mediat, për të mundësuar zhvillimin e ofertave alternative dhe për të ulur rrezikun që mediat të bëhen të varura nga një ofrues i vetëm teknologjik. Për të garantuar ndërveprueshmërinë dhe lëvizjen e të dhënave, shtetet duhet ta përplotësojnë dhe sigurojnë zbatimin e plotë të përpjekjeve ekzistuese rregulluese në këtë fushë.

Ribalancimi i pushtetit në treg

Shtetet duhet të shqyrtojnë mundësinë e shpërbërjes së kompanive teknologjike të integruara vertikalisht (p.sh. ato që operojnë njëkohësisht në reklamim, shpërndarje dhe pritje të përmbajtjes) **për t'i adresuar pabarazitë sistemike dhe për të rivendosur ndarjen strukturore që nxitë konkurrencë më të shëndoshë.** Për shembull, në sektorin e teknologjisë së reklamimit kjo do të nënkuptonte parandalimin e kompanive që të dhënat e mbledhura në një fushë t'i shfrytëzojnë për të dominuar në një tjetër. Duhet të shqyrtohen rregullat ekzistuese të antitrustit dhe konkurrencës. Çdo ndërhyrje politike në industrinë e informacionit dhe reklamimit duhet t'i adresojë pabarazitë ekzistuese të pushtetit, për të krijuar një mjedis ku shërbimet digjitale të orientuara drejt interesit publik të mund të zhvillohen suksesshëm.

Investimi në infrastrukturë digjitale në shërbim të interesit publik

Infrastruktura në shërbim të interesit publik mund të financohet publikisht dhe duhet të largohet nga sistemet e mbyllura. Në këtë drejtim, shtetet duhet të hulumtojnë dhe të mbështesin një sërë mundësish që mediat t'i eksplorojnë. Për shembull, mësimet e nxjerra nga përvoja në fusha të tjera, përfshirë shërbimet publike dhe infrastrukturën kritike, mund të çojnë në investime dhe bashkë Skica **të shërbimeve "cloud"** me burim të hapur dhe të ndërveprueshme, veglave **të sigurisë dhe/ose sistemeve rekomanduese që në vend të fitimeve** i japin përparësi interesit publik dhe fokusohen në qasje për të gjithë, transparencë dhe përgjegjësi shoqërore, si edhe përshtatshmëri dhe përdorim. Shtetet duhet **të mbështesin** nisma **të orientuara** kah komuniteti e jo kah angazhimi, dhe të sigurojnë garanci kundër ndikimit të papërshtatshëm politik dhe ndikimeve tjera. Lehtësirat tatimore, stimujt dhe fondet publike që **në plan të parë vendosin pavarësinë dhe pluralitetin** mund të mbështesin, zhvillojnë dhe zgjerojnë infrastrukturën digjitale në interes publik dhe të krijojnë stimujt për kompani dhe media që i japin përparësi interesit publik.

Media të shërbimit publik në shërbim të ndërtimit të hapësirave publike digjitale

Shtetet duhet të shqyrtojnë se në ç'mënyrë mund t'i zgjerojnë investimet ekzistuese të mediave të shërbimit publik në zhvillimin e teknologjive të përgjegjshme dhe/ose sistemeve ndërvepruese të rekomandimit të përmbajtjes. Nëse janë financiarisht të qëndrueshme dhe gëzojnë pavarësi për redaksinë, mediat e shërbimit publik mund të luajnë rol kyç **në zhvillimin e veglave teknologjike ose komponentëve të infrastrukturës digjitale që janë të kushtueshme dhe mund të ofrojnë** kapacitete në këtë drejtim. Me mbështetje nga financimi publik, ato mund të konsiderohen si partnerë publikë, duke siguruar që teknologjitë dhe burimet e tjera teknologjike (si setet e të dhënave) **të bëhen gjerësisht të** qasshme. Politikat e prokurimit të mediave të shërbimit publik duhet të mbështesin infrastrukturën që nuk kontrollohet nga kompanitë e mëdha të teknologjisë.

Konsideratat e sigurisë

Infrastruktura në shërbim të interesit publik duhet t'i njohë përvojat e ndryshme dhe rreziqet e ndërthurura me të cilat përballen gazetarët, veçanërisht gratë dhe personat nga radhët e komuniteteve **të nënpërfaqësuar, dhe ta trajtojë sigurinë si çështje strukturore të** ndërlidhur me të drejtat, llogaridhënien dhe pushtetin. **Barra e mbrojtjes së gazetarëve duhet të zhvendoset nga individi përmes vendosjes së një përgjegjësie të përbashkët mes platformave, shteteve, institucioneve** mediatike dhe shoqërisë civile. Shtetet duhet të promovojnë një kulturë solidariteti, ku siguria, ashtu edhe qëndrueshmëria financiare e mediave, trajtohen si obligim kolektiv dhe jo si kosto apo barrë individuale. Kjo mund të arrihet duke iniciuar dhe forcuar solidaritetin **nëpërmjet mekanizmave të koordinimit dhe** duke maksimizuar ndikimin kolektiv për të rritur llogaridhënien dhe reagimin.

Investimi i përgjithshëm për lirinë e medias

Shtetet duhet të mbështesin një mjedis informimi në rrjet **që** u mundëson mediave të ndërtojnë raporte **të drejtpërdrejta** me audiencën. Kjo duhet të jetë pjesë e politikave më të gjera për (lirinë e) medias dhe të lidhet me subvencione, politika fiskale, lehtësira tatimore etj. Përveç investimit në infrastrukturë, shtetet duhet të mbështesin edhe ofertën dhe kërkesën për media në shërbim të interesit publik, përfshirë përmes edukimit mediatik dhe edukimit për lirinë e medias.

Shtojcë

Përmbledhje e shembujve kryesorë të analizuar në këtë Manual Politikash, sipas shteteve

Kjo listë jo shteruese e ndërhyrjeve rregulluese të hartuara për të mbrojtur lirinë e medias në epokën e kompanive të mëdha të teknologjisë dhe inteligjencës artificiale, renditë disa nga iniciativat rregulluese kombëtare dhe rajonale të shqyrtuara në këtë Manual. Mësimet e nxjerra nga analiza e këtyre shembujve ligjorë — si dhe nga kodet e sjelljes të bëra vullnetarisht, qasjet vetërregulluese dhe jurisprudenca që nuk përfshihen në këtë listë — përbëjnë bazën e rekomandimeve të paraqitura në Manual.

Shteti	Legjislacioni	Aspekti përkatës	Viti i miratimit	Referencat në analizë
Austri	Taksa digjitale për reklamim	Vendosja e një takse digjitale për reklamimin në rrjet, të ardhurat e së cilës janë ndarë pjesërisht për mbështetjen e gazetarisë	2020	Shihni fq. 111
Australi	Kodi i mediave të lajmeve për negociim në mirëbesim	Krijimi i një kornize negociimi që detyron platformat e kompanive të mëdha të teknologjisë të kompensojnë në mënyrë të drejtë median për përmbajtjen e shpërndarë; e plotësuar në vitin 2024 me shtysën për negociimin e lajmeve me qëllim të futjes së një takse digjitale nëse nuk arrihen marrëveshje kompensimi	2021	Shihni fq. 103-104

Kanada	Akti për lajmet në rrjet	Vendosja e një kornize negociimi për të siguruar që platformat dominuese të kompensojnë mediat në mënyrë të drejtë për shpërndarje të përmbajtjes së saj	2023	Shihni fq. 104-105
BE	Direktiva për të drejtat autoriale	Vendosja e të drejtave të përafërta për shtëpitë botuese	2020	Shihni fq. 101
	Akti për shërbimet digjitale	Detyrimi i platformave për t'i vlerësuar rreziqet dhe zbatuar masat zbutëse, përfshirë garantimin e lirisë së medias dhe masat e sigurisë		Shihni fq. 80, 89, 92, dhe 129-130
	Akti evropian për lirinë e medias	Vendosja e privilegjit për median (mbrojtje e caktuar nga heqja e përmbajtjes) për organizatat mediatike që vetëdeklarohen, si dhe masave të sigurisë	2024	Shihni fq. 71-83 dhe 130
Gjermani	Traktati ndërmjet landeve gjermane për median	Detyrimi për mosdiskriminim për përmbajtje gazetareske në platformat digjitale	2020	Shihni fq. 70 dhe 77
Mbretëria e Bashkuar	Akti për sigurinë në rrjet	Vendosja e kufizimeve në moderimin e përmbajtjes gazetareske dhe mbrojtje për sigurinë e gazetarëve	2023	Shihni fq. 70-71

Shënime

A series of 20 horizontal dotted lines for writing notes.

Ky botim u krye falë kontributeve financiare nga Zvicra, Finlanda, Holanda, Gjermania, Franca, Norvegjia, Irlanda dhe Suedia.



TOWARDS HEALTHY
ONLINE INFORMATION
SPACES